



LIGJVËNËSIT SHQIPTARË

(1912-2017)

DHE FIRMËTARËT E AKTIT TË PAVARËSISË





LIGJVËNËSIT SHQIPTARË

(1912-2017)

DHE FIRMËTARËT
E AKTIT TË PAVARËSISË

Tiranë, 2018

Ribotim i përditësuar
Përditësoi materialin: Marita Lamani, Bahir Avdiko
Redaktor: Bahir Avdiko

© **Kuvendi i Shqipërisë**

ISBN: 978-9928-166-76-0



Përmbajtja

Parathënie	7
Tiparet kryesore të institucionit të parlamentit në Shqipëri	9
Viti 1912: Kuvendi Kombëtar i Vlorës	15
Delegatët e Kuvendit të Vlorës	15
Firmëtarët e Aktit të Pavarësisë	17
Asambleja Kombëtare me fuqi ligjvënëse në Shqipëri	53
Viti 1920: Këshilli Kombëtar (Senati)	55
Viti 1921: Këshilli Kombëtar (një dhomë)	61
Viti 1924: Kuvendi Kushtetues (një dhomë)	69
Viti 1925: Legjislatura I e Republikës Shqiptare (dy dhoma)	75
Viti 1928: Asambleja Konstituente (një dhomë)	83
Viti 1932: Parlamenti (një dhomë)	91
Viti 1937: Parlamenti (një dhomë)	95
Viti 1939: Asambleja Kushtetuese	99
Viti 1940: Këshilli i Epërm Fashist Korporativ	103
Viti 1943: Kuvendi Kombëtar	109
Viti 1944: Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar	117
Viti 1945: Asambleja Kushtetuese më 16 mars 1946 kthehet në Kuvend Popullor	121
Viti 1950: Kuvendi Popullor	133
Viti 1954: Kuvendi Popullor	139
Viti 1958: Kuvendi Popullor	145
Viti 1962: Kuvendi Popullor	151
Viti 1966: Kuvendi Popullor	159
Viti 1970: Kuvendi Popullor	167
Viti 1974: Kuvendi Popullor	175
Viti 1978: Kuvendi Popullor	185
Viti 1982: Kuvendi Popullor	193
Viti 1987: Kuvendi Popullor	199
Viti 1991: Kuvendi Popullor	205
Viti 1992: Kuvendi Popullor	215
Viti 1996: Kuvendi Popullor	223
Viti 1997: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	229
Viti 2001: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	239
Viti 2005: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	249
Viti 2009: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	257
Viti 2013: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	263
Lista emërore e deputetëve	275
Bibliografia	445



LIGJVËNËSIT SHQIPTARË (1912-2017)



Parathënie

Në këtë botim të përditësuar për ligjvënësit shqiptarë për periudhën më shumë se njëshekullore 1912–2017 janë mbledhur, sistemuar dhe renditur kronologjikisht të dhënat më të rëndësishme të jetës parlamentare të vendit: legjislaturat dhe kohëzgjatja e tyre, deputetët dhe grupimet e tyre politike, emërtimet e organit ligjvënës në përputhje me ndryshimet politike që kanë ndodhur nga një kohë në tjetrën.

Historia është e prirur të mbajë shënimet e veta për gjithçka të rëndësishme që ndodh në jetën e një populli. Por ajo është po aq e vështirë për t'u vetëparaqitur, për të mos thënë se historia në brendësinë e saj ka edhe një prirje të çuditshme për ta fshehur vetveten.

Ky libër është një sprovë për të nxjerrë shënimet fillestare të një historie: galerinë e atyre protagonistëve që jo në kuptimin idiomatik, por në kuptimin juridik kanë bërë ligjin në këtë vend.

Për të zgjedhurit në organin ligjvënës është folur vazhdimisht, në çdo kohë ata kanë qenë në qendër të vëmendjes së publikut, ndonjëherë edhe janë përfolur, me shkas e pa shkas, por deri tani nuk kemi një pasqyrim të plotë të parlamentarizmit në Shqipëri që nga krijimi i shtetit shqiptar më 1912. Mbetet detyrë e përhershme e historianëve që të studiojnë në mënyrë të plotë e të thelluar zhvillimet parlamentare në vend. Në këtë botim të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës së Kuvendit të Shqipërisë bëhen përpjekje që, duke e plotësuar me të dhëna të reja dhe emra të tjerë ligjvënësish, të ndërtohet rrjedha historike e legjislatrave të organit ligjvënës në Shqipëri që nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës i 28 nëntorit 1912 e deri në ditët tona. Përveçse për të informuar, ky botim shërben edhe si një homazh për të gjithë ata që shqiptarët për më shumë se një shekull i votuan, u dhanë zërin e vet, i bënë përfaqësues të tyre në organin më të lartë

ligjvënës. Se sa qytetarët kanë arritur të zgjedhin përfaqësuesit më të denjë të tyre, këtë e ka treguar dhe do ta tregojë gjithmonë cilësia e përfaqësimit të tyre në organin ligjvënës, që është një detyrim i secilit prej të zgjedhurve karshi tyre. Përmes këtij libri, ndonëse me informacion telegrafik, mund të shihen baticat dhe zbaticat parlamentare, ngritjet dhe rëniet, apogjeu dhe kriza, vota dhe arma, fjala dhe konflikti. Në të dhënat e këtij libri gjendet historia e kalimeve të vështira të pushtetit nga një formë qeverisjeje në tjetrën, nga republika e pashpallur në republikën e ligjshme, nga republika në mbretëri, nga mbretëria në protektorat dhe nga protektorati në regjencë “me pavarësi relative”, nga kjo e fundit në republikën parlamentare, që u zgjodh prej shqiptarëve prej gati tri dekada më parë.

Të dhënat që përmban ky libër nuk janë përzgjedhur, ato janë ruajtur ashtu siç janë pasqyruar në secilën legjislaturë. Këto të dhëna janë përshkruar në mënyrë fotografike dhe me baraslargësi politike ndaj të gjithë faktorëve që kanë ndikuar në jetën shqiptare. Kjo mënyrë paraqitjeje na bën të kuptojmë se nuk është aq e vështirë që të qëndrojmë përkrah njëri-tjetrit, ashtu sikurse kanë qëndruar dhe qëndrojnë për vite me radhë edhe ata që duken më të papajtueshmit. Në galerinë e ligjvënësve shqiptarë – dhe jo vetëm atyre shqiptarë – ka pasur raste kur ka ndodhur që kundërshtari të nxjerrë armën në vend të fjalës, pa u zgjatur me “atentatet” verbale, që vërtet janë të shumta. Por, në fund të fundit, historia me mospërfilljen e saj, si e pafundme që është, të gjallëve, duke përfshirë edhe ata që quhen të zgjedhur, ua ruan vendin pranë e pranë. Dhe këtë nuk mund ta ndryshojë njeri. Në këtë botim janë së bashku oksidentaliste e anadollakë, mbretërorë e republikanë, liberalë e konservatorë, rebelë e të bindur, komunistë e atdhetarë pa parti (dikur nuk



njihej idioma “shoqëri civile”, për t’iu larguar antonimit “shoqëri militare”), socialistë e demokratë. Kështu ka vijuar jeta parlamentare qëkurse revolucionarët francezë vendosën të ndaheshin edhe politikisht, edhe fizikisht “pro” dhe “kundër”, në “të majtë” dhe “të djathtë”, por historia i jep vendin e vet gjithsecilit.

Të dhënat e këtij libri dëshmojnë stinët politike me tërë ndryshueshmërinë e tyre në vitet e jetës parlamentare. Ato janë gjithashtu

shprehje e evoluimit të aftësisë së shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organin më të lartë legjislativ. Këto të dhëna na ndihmojnë që të reflektojmë mbi të shkuarën dhe të shohim drejt së ardhmes, të ndërtojmë një shoqëri demokratike funksionale, që bota e qytetëruar gjithnjë e më shpesh e quan “demokraci autentike”, “demokraci të drejtpërdrejtë”, “demokraci të vetëvendosjes”.

Tiparet kryesore të institucionit të parlamentit në Shqipëri

Nga Prof. asoc. dr. Afrim KRASNIQI,
Instituti i Studimeve Politike

Sistemi parlamentar dhe institucioni i parlamentit në Shqipëri kanë një histori po aq komplekse sa dhe vetë sistemi politik dhe ai qeverisës. Tërësia e studimeve dhe analizave krahasuese pranojnë se, pavarësisht regjimeve dhe ndryshimeve të thella në sistemin qeverisës, roli i parlamentit dhe kompetencat e tij formale mbetën brenda së njëjtës kornizë. Çdo vendim me rëndësi politike e kombëtare, qoftë vendim për ndryshimin e formës së regjimit, për caktimin e formës për zgjedhjen e kryetarit të shtetit, për bashkimin apo ndarjen me shtete të tjera është bërë përmes legjimitetit parlamentar. Studiuesi Omari thotë se *“në Kushtetutën e Shqipërisë nuk ka ndonjë përkufizim për rolin dhe funksionin e parlamentit, dhe as për pozitën që ai ka në raport me organet e tjera kushtetuese”*¹.

Në kushtetutat e viteve 1946 dhe 1976 parlamenti cilësohej *“organi më i lartë përfaqësues dhe i pushtetit shtetëror”*, një përkufizim i huazuar nga praktika e Revolucionit Francez, gjatë të cilit Asambleja Kombëtare u pa si *shprehje autentike e vullnetit të popullit dhe burim i formimit të institucioneve të tjera kushtetuese të shtetit*. Koncepti i unitetit të pushteteve ishte tipar i shoqërive dhe modeleve shtetërore komuniste, jodemokratike. Në periudhën demokratike koncepti i unitetit zëvendësohet nga koncepti i ndarjes dhe balancës së pushteteve.

Përbërja e parlamentit në vitet 1912–2013

Në tërësi në 100 vjetët e fundit janë praktikuar tri forma të ndryshme të parlamentarizmit:

1. Forma e *Kuvendit* ose *Kongresit Kombëtar*.

Kjo formë e parlamentit thirrej në raste urgjente, me delegatë që përfaqësonin krahina të ndryshme. Detyra kryesore e tij ishte vendimmarrja e shpejtë për çështje që kishin të bënin me ekzistencën e shtetit shqiptar. Të tillë mund të konsiderohen Kuvendi i Vlorës më 1912, Kongresi i Durrësit më 1918, Kongresi i Lushnjës më 1920 etj. Siç dihet, vendimet e këtyre mbledhjeve i dhanë formë dhe përmbajtje vetë shtetit shqiptar. Vendimet e këtyre formave të organizimit parlamentar kanë qenë të njëjta edhe për faktin se secila prej tyre ka krijuar qeveri, institucionin e Kryetarit të Shtetit dhe institucione përfaqësuese në emër të shtetit shqiptar.

2. Forma e dytë parlamentare është ajo e *Asamblesë Kushtetuese*. Detyra kryesore e saj ishte ndryshimi i kushtetutës dhe i statutit shtetëror si dhe përcaktimi i formës së regjimit dhe të qeverisjes. Të tilla mund të konsiderohen Asambleja Kombëtare e viteve 1924–1925, Asambleja Kombëtare e vitit 1928, Asambleja Kombëtare e vitit 1943 dhe Asambleja Kombëtare e vitit 1946. Një formë e tillë ishte edhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, një strukturë e krijuar nga Fuqitë e Mëdha më 1913–1914 me përgjegjësinë që pas miratimit të Statutit të shndërrohej në Asamble Kombëtare. Çdo formë e Asamblesë pas hartimit të Statutit Themelor të shtetit shqiptar ose të kushtetutës është shkruar ose shndërruar në parlament.

3. Formë tjetër është funksionimi në *variantin klasik të parlamentit*: si pushtet legjitim legjislativ, me përgjegjësi të përcaktuara

¹. Luan Omari, “Sistemi parlamentar”, Tiranë, 2004.



kushtetuese e politike. Të tillë janë: parlamenti i dalë nga zgjedhjet e vitit 1921, parlamenti i vitit 1923, ai i vitit 1925, parlamentet e periudhës së monarkisë dhe Republikës Popullore e sidomos legjislaturat parlamentare të viteve 1991–2009. Pavarësisht problemeve politike (prania ose jo e opozitës) apo rolit të institucionit në jetën politike (fiktiviteti gjatë periudhës komuniste), në tërësi kjo formë e parlamentarizmit bën dallim nga dy format e para dhe ka qenë më jetëgjatë se secila prej tyre.

Në aktivitetin dhe rolin e tyre legjislativ e politik të gjitha format e parlamenteve kanë dallime të dukshme mes tyre, por edhe tipare të përbashkëta. Kështu, nisur nga legjitimiteti dhe burimi i zgjedhjes dhe funksionimit të parlamentit kemi pasur:

1. *Parlamente të dala nga zgjedhjet* (1921–1939 dhe 1946–2013). Pavarësisht problemeve zgjedhore dhe natyrës e formës së organizimit të tyre, formalisht ose jo ato janë zhvilluar dhe parlamenti i dalë prej tyre ka pasur një legjitimitet të dukshëm në krahasim me format e tjera. Disa prej këtyre parlamenteve janë produkt i zgjedhjeve konkurruese, të tjera nga zgjedhje fiktive. Në çdo rast zgjedhet janë bërë në mënyrë periodike: çdo 2, 4 ose 5 vjet.

2. *Parlamente të pavotuara*. Të tilla janë parlamentet e periudhës së krijimit të shtetit (1912, 1914, 1918, 1920) dhe parlamentet e periudhës së pushtimit italian e gjerman. Një pjesë e tyre përbëheshin nga deputetë dhe përfaqësues të deleguar nga bashkitë, krahinat apo prefekturat e ndryshme të vendit, disa delegatë përfaqësonin pa votim komunitetet fetare dhe institucione të tjera të pranuar me kompromis (p.sh. “Vatra” më 1920), kurse në rastin e parlamenteve të kohës së pushtimit italian e gjerman delegatët, për shkak të funksioneve, ishin drejtuesit lokalë e qendrorë të Partisë Fashiste ose prijësit lokalë të krahinave, sidomos bajraktarët e Veriut.

3. *Parlamente të imponuara nga fuqi të huaja politike në dy periudha kohore*: gjatë administrimit të vendit nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit dhe gjatë pushtimit italian e gjerman (1914, 1939–1944-). Në të tria rastet formula e përbërjes së parlamentit, e zgjedhjes dhe e raporteve të deputetëve me pushtetet politike e kushtetuese në vend u bazua

në modelet e imponuara nga jashtë. Deputetët patën role simbolike, jeta parlamentare ishte formale dhe axhenda politike e parlamenteve në çdo rast përcaktohej nga faktori i huaj.

4. *Parlamente të zgjedhura nga vetë shqiptarët*, ku hyjnë modelet e periudhave të tjera politike. Dallimet midis këtyre modeleve kanë të bëjnë me formën e zgjedhjes: më 1920–1924 me zgjedhje indirekte me sistem dyshkallësh, në periudhën e monarkisë me imponimin e kandidatëve të qeverisë, në periudhën e komunizmit më shumë se zgjedhje kishte emërim të deputetëve, kurse në periudhën e demokracisë procesi është karakterizuar nga konkurrenca politike dhe nominale e kandidatëve për deputetë.

5. *Parlament me një dhomë*. Ky ka qenë modeli dominues gjatë gjithë periudhës së funksionimit të sistemit parlamentar në Shqipëri. Përrjashtim bëjnë vetëm vitet e republikës në prag të kalimit në monarki. Faktori kryesor që çoi në vendimin për krijimin e një sistemi parlamentar vetëm me një dhomë ishte karakteri unitar dhe monokombëtar i shtetit, pa epërsitë e dukshme numerike të një kombësie.

6. *Parlament me dy dhoma*. Ky model i sistemit parlamentar u aplikua vetëm gjatë viteve 1925–1928. Disa studiues e konsiderojnë parlament dydhomësh edhe modelin parlamentar të aplikuar pas krijimit të Pleqësisë më 1912. Në vitet 1929–1939 vendin e Senatit e zuri Këshilli i Shtetit, një organ me kompetenca të mëdha në hartimin e legjislativacionit dhe ndjekjen e zbatimit të tij. Në periudhën pas vitit 1990 ka pasur disa nisma për krijimin e sistemit dydhomësh, madje në variantin e parë kushtetues të vitit 1998 u përcaktua zgjedhja e Senatit, modalitetet e përbërjes dhe të funksionimit të tij, por më pas u hoq dorë dhe u la varianti i parlamentit njëdhomësh.

7. *Parlamente që kanë rrëzuar apo krijuar regjime e forma të reja qeverisëse*. Të tilla janë pothuajse shumica e parlamenteve të periudhave 1912–1928 dhe 1939–1946 dhe parlamenti i vitit 1991. Ato kanë votuar ndryshimin e formës së regjimit (monarki, republikë dhe përsëri monarki dhe republikë), si dhe kanë eksperimentuar modele drejtimi individual apo kolektiv të shtetit.

8. *Parlamente që nuk kanë rrëzuar apo krijuar*



regjime e forma të reja qeverisëse janë parlamentet e periudhave të tjera. Edhe parlamenti i vitit 1991, i cili përbën të parin parlament të periudhës demokratike, konfirmoi sistemin republikan dhe ruajti vazhdimësinë e këtij sistemi të përcaktuar në vitin 1946. Një votim për formën e regjimit në vitin 1997 bëri bashkë partitë kryesore politike kundër një grupi minimal partish të vogla mbështetëse të monarkisë.

9. *Parlamente që pranojnë dhe zbatojnë parimin e ndarjes së pushteteve, në kuptimin që deputetët nuk mund të bëjnë pjesë njëherësh në një pushtet tjetër. Të tilla janë parlamentet e periudhës së demokracisë, të monarkistë dhe parlamentet e viteve 1920. Koncepti është zgjeruar edhe me ndarje të tjera brenda sistemit qeverisës. Për shembull, në parlamentin e viteve 1991–1997 deputeti mund të ishte edhe kryetar bashkie, por pas vitit 1998 u sanksionua papajtueshmëria midis dy funksioneve.*

11. *Parlamente që pranojnë të ndajnë bashkëdrejtimin edhe të pushteteve të tjera. Kështu, parlamenti i periudhës komuniste kishte njëherësh deputetë që drejtonin edhe pushtetet e tjera, përfshirë pushtetin gjyqësor, ekzekutiv dhe atë të kryetarit kolektiv të shtetit.*

12. *Parlamente që përfaqësojnë kombin shqiptar. Të tilla kanë qenë parlamentet e periudhës së parë të krimit dhe funksionimit të shtetit shqiptar (1912–1925), gjatë së cilës Kosova ishte pjesë politike e shtetit shqiptar dhe përfaqësohej rregullisht në parlament. Ky parim përfaqësues u zbatua edhe në rastet e parlamenteve fiktive të periudhës së pushtimit italian e gjerman në vitet 1939–1944.*

13. *Parlamente që përfaqësojnë shtetin shqiptar. Janë parlamentet e çdo periudhe tjetër (1925–1939, 1944 e në vijim), zgjedhjet për të cilat u zhvilluan vetëm në shtetin shqiptar, në kufijtë e tij zyrtarë të miratuar në vitin 1913 nga Fuqitë e Mëdha.*

14. *Parlamente të zgjedhura drejtpërdrejt nga qytetarët. Ky model parlamentar është aplikuar vetëm për periudha të shkurtra kohore. Në kuptimin statistikor parlamente me zgjedhje direkte nga qytetarët janë ai i vitit 1945 dhe ai i vitit 1991. Në periudhën e viteve '20 parlamenti zgjidhej me zgjedhës të dytë, pra indirekt. Gjatë periudhës së pushtimit italian dhe gjerman*

modeli i zgjedhjeve indirekte apo i kooptimit të disa funksionarëve të lartë mbeti formulë zyrtare e zgjedhjeve. Në periudhën e monarkisë dhe të komunizmit zgjedhja në tërësi ishte fiktive, pasi lista zyrtare e kandidatëve shpallej nga qeveria dhe jo nga qytetarët apo partitë politike konkurruese. Gjatë viteve 1992–2005 zgjedhja e deputetëve është bërë me modelin e përzier: një pjesë direkt nga qytetarët dhe një pjesë nga listat shumemërore të partive. Me sistemin e ri zgjedhor, atë proporcional rajonal, kalohet në zgjedhje indirekte prej qytetarëve të të gjithë deputetëve.

15. *Parlamente me angazhim të plotë dhe të pjeshëm të deputetëve. Gjatë periudhës së pushtimit gjerman dhe periudhës komuniste deputetët nuk kishin funksione me kohë të plotë. Ata ushtronin funksione të tjera dhe një pjesë të vogël të kohës ia kushtonin punës si parlamentar, sidomos kjo gjatë periudhës komuniste. Si për ironi, edhe deputetët e parlamentit të parë pluralist (1991–1992) kishin funksione parlamentare me kohë të reduktuar dhe si funksione bazë bazë kishin funksionet në profesionet e tyre të mëparshme. Nga viti 1992 e këtej funksioni i deputetit është me kohë të plotë dhe përjashtues për çdo funksion tjetër paralel.*

Në aspektin statistikor parlamentet e viteve 1912–1944 nuk patën *asnjë femër deputete*, kurse më 1945 për herë të parë femrat patën të drejtë vote dhe katër femra u zgjodhën deputete.

Një tipar tjetër statistikor lidhet me *numrin e deputetëve*. Numri më i vogël i deputetëve u përket viteve të para të krijimit dhe funksionimit të shtetit shqiptar (18, 37 dhe 57 deputetë), kurse numri më i madh u përket viteve të fundit të sistemit komunist (250 dhe 264 deputetë).

Aktualisht sistemi parlamentar është vendosur me Kushtetutën e vitit 1998. Me këtë Kushtetutë sistemi parlamentar në Shqipëri mori një mbështetje të fortë, pasi ajo u hartua dhe u miratua vetëm një vit pas referendumit popullor për formën e regjimit, në të cilin republika arriti të fitonte me një diferencë të vogël ndaj monarkisë kushtetuese. Studiuesit që kanë trajtuar ecurinë dhe problemet e parlamentarizmit në vendin tonë, kanë vënë në pah një sërë tiparësh dhe karakteristikash. Më kryesoret janë:



a. *Nga viti 1991 e në vazhdim modeli parlamentar qeverisës ka mbetur thuajse i pandryshuar.* Kemi pasur një pushtet ekzekutiv dhe President të zgjedhur nga parlamenti, një tregues force dhe përgjegjësie të parlamentit, të cilën nuk e kanë shumica e shteteve rajonale dhe europiane. Sistemi parlamentar ka funksionuar përmes mazhorancave të qëndrueshme qeverisëse dhe kabineteve qeveritare, që kanë krijuar raporte bashkëpunimi me çdo parlament. Kjo është arsyeja kryesore që asnjë legjislaturë parlamentare nuk ka pasur sukses në nisma për mocione mosbesimi për qeverinë. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 dhe krijimin e modelit të mocionit të mobesimit konstruktiv pozita reale kushtetuese e parlamentit është drejt dobësimit, sidomos në funksionin e tij bazë: ushtrimin e kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv.

b. *Sistemi parlamentar shqiptar bazohet në ekzistencën dhe funksionimin e një sistemi shumëpartiak e të qëndrueshëm.* Që në zgjedhjet e vitit 1991, kur numri i subjekteve politike në parlament ishte vetëm tri, ky numër është rritur dhe në legjislaturat e viteve 2000 kemi pasur gjithnjë 12–13 parti konkurruese parlamentare. Me sistemin e ri proporcional lokal numri i partive është reduktuar, disa prej tyre kanë siguruar mandate përmes përfshirjes së liderëve të tyre politikë në listat e sigurta elektorale të partive të mëdha. Përgjegjësinë kryesore për funksionimin e sistemit parlamentar e kanë dy partitë e mëdha politike: Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, të cilat janë edhe partitë e vetme politike me përfaqësim të përhershëm në parlament dhe me potencial të madh qeverisës.

c. *Sistemi parlamentar i viteve të tranzicionit demokratik, në dallim nga çdo periudhë tjetër parlamentare (duke përfshirur vitet 1922–1924), ka krijuar një rivalitet efektiv me veprime juridike e politike midis mazhorancës dhe opozitës.* Ky tipar shfaqet në dy forma: në ekzistencën e një opozite të modelit konstruktiv, bashkëpunuese për çështje të rëndësishme, siç janë reformat e nevojshme dhe procesi i integritetit (1991, 2002–2015); një opozitë destruktive, penguese e nismave të qeverisë dhe bojkotuese të proceseve kryesore politike parlamentare (opozita e viteve 1992–2001 dhe periudha të shkurtra më 2009 dhe 2013).

Ashpërsia e veprimit opozitar është shoqëruar edhe me të kundërtën: me ashpërsinë e veprimeve ndaj opozitës. Të gjithë liderët historikë të opozitës parlamentare të viteve 1921–1924, 1946 dhe 1992–2005 në periudha të ndryshme janë arrestuar apo dënuar deri me vendime ekstreme.

ç. *Sistemi parlamentar dhe vetë institucioni i parlamentit gjithnjë ka reflektuar pjesën më agresive të fjalorit politik e për rrjedhojë dobësi të theksuara në formimin demokratik dhe aftësinë për dialog e bashkëpunim.* Duke e konsideruar opozitën kundërshtarë të sistemit dhe të modelit shtetëror dhe jo pjesë të rëndësishme të tij, marrëdhëniet midis mazhorancës dhe opozitës kanë qenë gjithnjë të acaruar. Të vetmet raste të bashkëpunimit të qëndrueshëm në hartimin e legjislacionit dhe në përmbushjen me nivelin e duhur të përgjegjësisë parlamentare kanë qenë rastet e ndërhyrjes direkte dhe këshillës detyruese të faktorit ndërkombëtar. Kështu ka ndodhur në vitet 1991, 1997, 2002 dhe çdo vit tjetër më pas.

d. *Sistemi parlamentar është ndeshur gjithnjë me problemet e besimit dhe të legjitimitetit.* Të vetmet zgjedhje të pakontestuar në historinë demokratike të Shqipërisë mbeten zgjedhjet e vitit 1921 dhe ato të vitit 1992. Çdo proces tjetër zgjedhor, ndonjëherë me të drejtë, është kontestuar nga njëra palë. Kontestimi është shoqëruar edhe me veprime jashtëparlamentare ose me politikë bllokuese e demaskuese në parlament dhe debate publike, duke ndikuar dukshëm në rënien e besimit publik dhe në zgjatjen tej mase të procesit të maturimit të institucioneve përfaqësuese, sidomos të Kuvendit.

e. *Në tërësi parlamentarizmi në Shqipëri nuk u bë garant i ruajtjes dhe forcimit të parimit kushtetues të ndarjes dhe balancës së pushteteve.* Kjo ndodhi edhe për shkak të pasojave që la pas mentaliteti dhe modeli i vjetër i partisë-shtet. Çdo mazhorancë parlamentare ka synuar marrjen e kontrollit politik të institucioneve kushtetuese. Pushteti i parë i sistemit qeverisës, ai parlamentar, ka qenë gjithnjë në rivalitet për më shumë ndikim e kompetenca kontrolli, sidomos mbi pushtetin e tretë dhe të katërt: gjyqësorin dhe medien. Gjatë



periudhës së tranzicionit jeta parlamentare është ndikuar dukshëm nga disa kompetenca kushtetuese që lidhen direkt ose indirekt me të: në vitin 1992 sistemi qeverisës eksperimentoi me disa kompetenca të natyrës së republikës gjysmëparlamentare, në vitin 1998 u krijua një sistem i pastër parlamentar, ndërsa në vitin 2008 balanca u dëmtua, pasu iu dha më shumë rol pushtetit ekzekutiv.

f. *Parlamentarizmi tenton të krijojë ndarje dhe balancë midis pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv.* Parlamenti zgjedh dhe shkarkon qeverinë dhe jo e anasjellta. Praktikisht gjatë këtyre viteve është konstatuar tendenca në rritje e qeverive për të mënjanuar apo kontrolluar veprimtarinë parlamentare. Të gjitha zgjidhjet e rëndësishme politike janë gjetur jashtë parlamentit, asnjë mocion parlamentar nuk është votuar me sukses, asnjë qeveri nuk është rrëzuar në parlament dhe me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 rrëzimi i kryeministrit me mocion penalizon direkt parlamentin, duke e kaluar vendin në zgjedhje të reja. Ky dominim i pushtetit ekzekutiv mbi atë legjislativ ka cenuar balancën midis pushteteve dhe rritje të ndjeshme të rolit të partive politike mbi

institucionet e rëndësishme kushtetuese, siç është edhe parlamenti.

g. *Sistemi parlamentar dhe vetë parlamenti ndikuan shumë në krijimin e elitave politike.* Një dallim thelbësor në këtë drejtim midis parlamenteve të viteve 1921–1925 dhe atij të viteve 1991 e në vijim është fakti se në rastin e parë deputetë u zgjodhën pothuajse të njëjtët persona, duke krijuar në njëfarë mënyrë një elitë politike të qëndrueshme. Në rastin e dytë kemi një përqindje të lartë të rinovimit të parlamentit, me një mesatare 40 për qind në çdo katër vjet. Kjo ka sjellë prurje të reja në politikë, por njëherësh edhe pamundësinë e krijimit të një elite të qëndrueshme politike, si dhe zëvendësimin e saj nga hyrje-daljet në politikë të një numri të madh individësh pa interesa afatgjatë dhe aftësi të dukshme politike. Në listën e 10 deputetëve me më shumë mandate parlamentare më shumë se gjysma e tyre kanë ndryshuar parti politike gjatë mandatit ose midis mandateve, duke iu përshtatur edhe eksperimentit me sistemin zgjedhor: kalimin nga sistemi mazhoritar i pastër në sistem të përzier dhe aktualisht me sistem proporcional me lista të mbyllura.



LIGJVËNËSIT SHQIPTARË (1912-2017)



VITI 1912

Sistemi parlamentar në Shqipëri fillon me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Kuvendi i Vlorës (28 nëntor–7 dhjetor 1912), në të cilin morën pjesë delegatë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, përfaqësonte vullnetin e gjithë kombit. Vendimet e tij kishin vlerën e vendimeve kushtetuese. Në mbledhjen e parë, sipas rregullave dhe praktikave të demokracisë perëndimore, Kuvendi u mor me verifikimin e mandateve të delegatëve. Pas verifikimit të mandateve Kuvendi shpalli pavarësinë e Shqipërisë dhe zgjodhi Ismail

Qemalin kryetar të Qeverisë së Përkohshme. Pra, shteti i pavarur shqiptar u krijua si një shtet me sistem parlamentar, ku rolin e parlamentit e kryente Kuvendi kombëtar, ndërsa funksionet ekzekutive i kryente Qeveria e Përkohshme. Gjithsesi, Kuvendi Kombëtar i Vlorës ishte vetëm embrioni i një parlamenti të vërtetë, sepse në rrethanat e jashtëzakonshme të asaj kohe ai nuk mund të mblidhej rregullisht dhe të kryente funksionet e organit legjislativ, funksione të cilat i kryente Qeveria².



Foto e sarajit të Xhemil bej Vlorës, ku u mbajt Kuvendi i Vlorës

Delegatët e Kuvendit të Vlorës³

Berati:

1. Babë Dudë KARBUNARA
2. Dhimitër TUTULANI
3. Hajredin CAKRANI
4. Iliaz VRIONI
5. Sami VRIONI
6. Xhelal KOPRENCKA

Çamëria:

1. Aziz Tahir AJDONATI
2. Rexhep DEMI
3. Veli GËRRA

4. Vesel MARGËLLIÇI

Dibra:

1. Sherif LANGU⁴
2. Vehbi AGOLLI

Durrësi:

1. Abaz ÇELKUPA
2. Jahja BALLHYSA
3. Mustafa HANXHIU
4. Nikollë KAÇORRI

². Luan Omari, “Sistemi parlamentar”, Tiranë, 2000, f. 153–154.

³. Kastriot Dervishi, “Historia e shtetit shqiptar 1912–2005”, Tiranë, 2006, f. 20.

⁴. Njohur si delegat më 30 nëntor 1912.



Delegatët e Kuvendit të Vlorës pas themelimit të qeverisë me në krye Ismail Qemalin

Elbasani:

1. Lef NOSI
2. Mithat FRASHËRI
3. Qemal KARAOSMANI
4. Shefqet DAIU

Gramshi dhe Tomorica:

1. Ismail QEMALI

Gjirokastra:

1. Aziz EFENDIU
2. Elmaz BOÇE
3. Hysen EFENDIU (HOXHA)
4. Jan PAPHADHOPULLI
5. Myfit LIBOHOVA
6. Petro POGA
7. Veli bej KËLCYRA

Ipeku (Gjakovë, Plavë e Guci):

1. Bedri PEJANI
2. Mithat FRASHËRI
3. Qerim BEGOLLI
4. Rexhep MITROVICA
5. Sali GJUKA

Kavaja:

1. Abdi TOPTANI

Korça:

1. Pandeli CALE
2. Spiro ILO
3. Thanas FLOQI

Kosova:

1. Dervish IPEKU
2. Hajdin DRAGA
3. Isa BOLETINI
4. Mehmet DËRALLA

Kruja:

1. Abdi TOPTANI
2. Mustafa KRUIJA

Lushnja:

1. Ferit VOKOPOLA
2. Nebi SEFA
3. Qemal MULLAI

Mati:

1. Ahmet ZOGU
2. Kurt AGA
3. Riza BEU

Ohri dhe Struga:

1. Dervish HIMA
2. Hamdi OHRI
3. Dr. H. MYRTEZAI (Myrteza ALI STRUGA)
4. Mustafa BARUTÇIU
5. Nuri SOJLIU
6. Zyhdi OHRI

Peqini:

1. Dervish BIÇAKÇIU
2. Mahmut KAZIU

Përmeti:

1. Mithat FRASHËRI
2. Syrja VLORA
3. Veli KËLCYRA

Pogradeci:

1. Hajdar BLLOSHMI⁵

Shijaku:

1. Shahin EFENDIU
2. Xhemal DELIALLISI
3. Ymer DELIALLISI

Shkodra:

1. Luigj GURAKUQI

Tepelena:

1. Aristidh RUCI
2. Feim MEZHGORANI
3. Kristo MEKSI
4. Mufit LIBOHOVA

Tirana:

1. Abdi TOPTANI
2. Murat TOPTANI

Vlora:

1. Aristidh RUCI
2. Eqerem bej VLORA
3. Ismail QEMALI
4. Jani MINGA
5. Qazim KOKOSHI
6. Zihni Abas KANINA

Kolonia e Bukureshtit:

1. Dhimitër ZOGRAFI
2. Dhimitër MBORJA
3. Dhimitër BERATI
4. Dhimitër ILO

⁵. Nuk mori pjesë për shkak të pushtimit serb.

Në Vlorë më 15/28 të Gjeshtës së tretë 1329/1912.

Pas falëvet që tha L. Kuyetari Ismail Kemal
Beu, me të cilat tregoi reaktimin e madh në
të cilin udhohet sht. Shqipëria, të gjithë delegatët
dë të me një të venduan që Shqipëria me
sot të bëhet në vëlltë, e liri e e mosvarome.

Imamkumij Hacani
 H. Karabasa
 Elmogoc
 v. h. koca
 A. K. Preri
 Abd. Abas Devese
 Mehmet Raouf
 Cefijti Dje
 Zihni Abas Kamina
 X. b. k. i. s.

Hajredin
 Bekri
 Aemal
 elbasani
 Shashijon Salih Gjuka
 Ibrahim Hamzani
 Dimitri Logoziti
 Murad Topkani
 Pandi Beq
 Dur Duraku
 Bani Refik
 Spiro Gjo
 Thana V. G. Gjo
 D. H. Mustafa
 Mustafa Arim Kruga
 M. Teris Dobrotsky
 N. S. f. l. e. j. a.
 Zihni Ohri

Firmëtarët e Deklaratës së Pavarësisë

Periodha e luftërave dhe e përpjekjeve të shqiptarëve për të përgatitur ardhjen e ditës së madhe të pavarësisë është ndër më të shkëlqyerat e historisë sonë, më vendimtarja. Dita e 28 nëntorit nuk ishte e papritur apo pasojë e një rastësie historike, por konkluzion i një kalvari të gjatë përpjekjesh e aspiratash lirie. Duke filluar me Rilindjen, ishte hera e parë që kishim një elitë intelektuale me ndërgjegje të lartë kombëtare. Kjo elitë punoi në mënyrë të

jashtëzakonshme për zgjimin e vetëdijes kombëtare të masave popullore dhe përhapjen e arsimit shqip. Filloi të bashkërendohej lufta parlamentare e përfaqësuesve shqiptarë në parlamentin turk me luftën e masave popullore, u krijuan klube e shoqëri patriotike brenda e jashtë vendit, të cilat luajtën një rol të jashtëzakonshëm në rritjen e entuziazmit patriotik dhe në mbrujtjen e forcimit e ndjenjës së unitetit kombëtar. Nën drejtimin apo




përkrahjen e tyre nisën të botoheshin gazeta, brenda e jashtë vendit, në të cilat shpreheshin qartë aspiratat e lirisë e të pavarësisë së shqiptarëve. Ishin të shumtë atdhetarët që punuan me mish e me shpirt për propagandimin e ideve kombëtare. Nga gjiri i kësaj elite të shquar atdhetare do të dilnin më pas edhe firmëtarët e Deklaratës së Pavarësisë më 28 nëntor 1912.

Gjatë kohës së diktaturës emrat e një pjese të këtyre firmëtarëve, si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi etj., janë përkujtuar e përmendur vazhdimisht me nderim, kurse pjesa më e madhe e tyre u dënuan me heshtje si të mos kishin ekzistuar kurrë, pavarësisht veprimtarisë së jashtëzakonshme atdhetare dhe flijimit të jetës së tyre në shërbim të idealeve të larta kombëtare.

1. ISMAIL QEMAL BEJ VLORA (1844–1919)

Udhëheqësi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, arkitekti dhe themeluesi i shtetit të pavarur shqiptar, kryeministri i parë i Shqipërisë, Hero i Popullit. Lindi në Vlorë më 24 janar 1844 në një nga familjet më të mëdha e me tradita të Shqipërisë së Jugut. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, më pas ndoqi mësimet në shkollën plotore turke në Selanik dhe në vitin 1858 u regjistrua në gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Më 1860 nisi punën si përkthyes në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Stamboll, ndërkohë ndoqi studimet e larta në degën e shkencave juridike. Në vitet 1862–1864 shërbeu në administratën e vilajetit të Janinës, më pas u transferua në Tërhallë (Thesali) e përsëri në Stamboll. Në vitin 1864, së bashku me Jani Vreton, Kostandin Kristoforidhin, Hasan Tahsinin, Sami Frashërin e Pashko Vasën, mori pjesë në mbledhjen e parë për caktimin e alfabetit të përbashkët të shqipes dhe formimin e një shoqërie kulturore shqiptare. Në vitin 1866 u emërua kryesekretar i korrespondencës në Rusçuk (Bullgari), më pas u ngarkua me një varg detyrash në administratën shtetërore. Në vitin 1877 Porta e Lartë e akuzoi si kundërshtar të politikës së sulltanit Abdyl Hamiti II dhe përkrahës të pikëpamjeve liberale të reformatorit Mithat pasha dhe u internua për 7 vjet në Anadoll. Pas kthimit nga internimi në vitin 1884 e deri në vitin 1900, ngaqë çmohej për aftësitë e tij, u emërua përsëri në disa detyra të larta shtetërore. Divergjencat me Portën e Lartë u thelluan më tepër kur i paraqiti sulltanit një promemorie, ku i parashtronte një program reformash, të cilat duhej të ishin të përgjithshme e t’u siguronin shtetasve më shumë të drejta dhe liri. Ai mendonte se në vend të regjimit absolutist të sulltanëve në Perandorinë Osmane duhej të vendosej një monarki kushtetuese parlamentare e



ngjashme me atë të disa vendeve të Europës. Për t’u shpëtuar ndjekjeve të sulltanit, në maj 1900 arratiset dhe bashkë me djemtë e tij shkon në Athinë e prej andej në disa vende të Europës, ku zhvilloi një veprimtari të dendur politike për njohjen e

kombit shqiptar dhe të drejtave të tij. Në vazhden e idealeve të Rilindjes Kombëtare, nëpër intervista dhe në shkrimet e botuara në shtypin shqiptar dhe organet e huaja shpalli botërisht programin e tij për autonominë e Shqipërisë. Në dhjetor të vitit 1908 vuri kandidaturën për deputet në sanxhakun e Beratit dhe zuri vend në parlamentin turk, ku së bashku me atdhetarë të tjerë u vu në mbrojtje të interesave të kombit shqiptar. U dallua si organizator i kryengritjeve kundërosmane të viteve 1910–1911. Së bashku me Luigj Gurakuqin e patriotë të tjerë hartoi Memorandumin e Greçës të qershorit 1911 dhe në fund të atij viti iu vu punës për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912. Në prag të luftërave ballkanike shkoi në Stamboll për t’i kërkuar qeverisë osmane t’u jepte shqiptarëve autonominë. Pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, që kishte për qëllim copëtimin e tokave shqiptare, së bashku me Luigj Gurakuqin ndërmori një aksion të ri politik për shpalljen e autonomisë së Shqipërisë. Në fillim të nëntorit 1912, i shoqëruar nga Luigj Gurakuqi, shkoi në Bukuresht, ku gjeti përkrahjen e të gjitha organizatave patriotike të atjeshme për shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Turqia. Mbledhja e kolonisë shqiptare të Bukureshtit (5 maj 1912), e kryesuar prej tij dhe Luigj Gurakuqit, nuk përcaktoi qartë nëse do të kërkohej pavarësia e Shqipërisë, kjo do të përcaktohej nga zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve dhe nga




qëndrimi që do të mbanin kundrejt çështjes shqiptare Fuqitë e Mëdha. Për këtë qëllim shkoi në Vjenë, ku siguroi përkrahjen e personaliteteve politike austro-hungareze dhe të përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare. Më 19 nëntor 1912 njoftoi bashkatdhetarët nga Triestia se menjëherë sapa të mbërrinte në Shqipëri do të mbledhej një kuvend kombëtar, i cili do të shpallte pavarësinë e Shqipërisë. Ndonëse kishte menduar që flamuri kombëtar të ngrihej më 22 nëntor në qytetin e lashtë të Durrësit, për shkak të gjendjes së nderë që mbretëronte në qytet, po atë ditë lajmëroi telegrafisht të gjitha qytetet që delegatët të niseshin për në qytetin e Vlorës. Më 25 nëntor mbërrin në Vlorë dhe merr masa për organizimin e forcave të armatosura. Për shkak të përparimit të ushtrive serbe gjendja në Shqipëri po bëhej gjithnjë e më kritike, çka i detyroi delegatët mbrëmjen e 27 nëntorit të vendosnin thirrjen e Kuvendit Kombëtar të nesërmen, ndonëse nuk kishin arritur ende përfaqësuesit e disa krahinave. Më 28 nëntor 1912, në orën 14:00, u

hap në Vlorë Kuvendi Kombëtar. Ismail Qemali lexoi para delegatëve Deklaratën e shpalljes së Pavarësisë dhe ngriti flamurin kombëtar. Kuvendi e zgjodhi kryetar të Qeverisë së Përkohshme dhe ministër të Punëve të Jashtme. Në janar 1914 Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit e implikoi në të ashtuquajturin komplot të Beqir Grebenesë, gjë që e detyroi që më 22 janar 1914 të jepte dorëheqjen dhe të shkrinte kabinetin. Pushteti kaloi në duar të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Vetë Qemali u largua nga Shqipëria. Megjithatë, ai mbeti përherë aktiv. Ndërsa ndiqte me interes zhvillimet në vend, ai ndërmori udhëtime në kancelaritë kryesore të Europës për të thënë atë që duhej për Shqipërinë dhe shqiptarët. Vdiq në Peruxhia të Italisë në rrethana misterioze, të cilat, nisur dhe nga fjalët e tij të fundit “më hëngër në besë”, shtojnë dyshimin për një vrasje. Eshtrat e Ismail Qemalit ndodhen në Vlorë. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

2. ABAS DILAVER ÇELKUPA (1855–1926)

Lindi në qytetin e Durrësit më 4 prill të vitit 1850. Mësimet e para dhe mejtepin i kreu në qytetin e tij të lindjes. Në mënyrë autodidakte arriti të mësonte dy gjuhë të huaja: italisht dhe frëngjisht. Për njëzet e shtatë vjet rresht ai shërbeu si nëpunës në administratën osmane të qytetit. Në vitin 1895 në shtëpinë e tij qëndroi për ca kohë Murat Toptani, i cili qe vënë në shërbim të përhapjes së gjuhës shqipe si mësues shëtitës. Pjesëmarrja në qarqet atdhetare i krijoi mundësinë të njihej me personalitete të tjera të kohës, por njohja dhe bashkëpunimi i ngushtë me dom Nikollë Kaçorrin, një ndër luftëtarët më të flaktë të pavarësisë shqiptare, i cili ishte jo vetëm njeri me vetëdije shumë të lartë kombëtare, por edhe veprimtar tepër i gjallë e organizator i shkëlqyer, pati rëndësi të dorës së parë për të.

Me krijimin e shoqërisë patriotike “Bashkimi” në Durrës në vitin 1908, Abas Çelkupa u bë një nga organizatorët e një lëvizjeje që synonte ringjalljen e ndjenjës kombëtare për të



kundërshtuar politikën xhonturke. Duke qenë edhe një nga anëtarët e pleqësisë së këtij klubi, ai punoi me përkushtim të lartë për përhapjen e ideve kombëtare në Durrës, në fshatrat përreth e kudo që ishte nevoja. Më vonë, nën orientimin dhe nxitjen e dom Nikollë Kaçorrit,

kjo shoqëri e ndryshoi emrin dhe u quajt “Vllaznia”. Abas Çelkupa ishte tashmë një nga veprimtarët më të shquar të kësaj shoqërie dhe emri i tij ishte i njohur në të gjitha qarqet atdhetare, brenda e jashtë vendit. Ai lexonte vazhdimisht gazetën “Drita” të Bukureshtit dhe kishte korrespondencë të vazhdueshme me patriotët shqiptarë që jetonin dhe vepronin atje. Kur dom Nikollë Kaçorri u arrestua (në vitin 1910), Abas Çelkupa së bashku me atdhetarë të tjerë protestuan pranë autoriteteve osmane për lirimin e tij. Në kryengritjen e vitit 1912 emri i tij radhitej mes figurave kryesore të parisë së


Durrësit, të cilët ndihmuan dhe mbështetën kryengritjet që kishin shpërthyer në Krujë, në Mat, në Shqipërinë e Mesme e të Veriut. Në nëntor të vitit 1912 Abas Çelkupa së bashku me Nikollë Kaçorrin e atdhetarë të tjerë durrsakë organizuan ceremoninë e pritjes së Ismail Qemalit. Në shenjë nderimi dhe vlerësimi për veprimtarinë e tij të paepur në shërbim të çështjes kombëtare, u zgjodh përfaqësues i Durrësit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Kështu, për meritat e tij të padiskutueshme, Abas Çelkupës iu dha rasti historik që të ishte një nga firmëtarët e Deklaratës së Pavarësisë më 28 nëntor 1912, të cilën e nënshkroi me siglën "Abas Dilaver". Por veprimtaria e Abas Çelkupës në shërbim të atdheut nuk u ndërpre deri në fund të jetës së tij. Gjatë periudhës së qeverisë së Vlorës, duke qenë se kishte shumë përvojë në çështjet administrative, ai punoi me tërë fuqinë

dhe përkushtimin e tij për organizimin e administratës dhe vendosjen e rregullit e të qetësisë. Në vitet 1914–1916, duke qenë se ishte kundërshtar i papajtueshëm i politikës përçarëse të Esat pashë Toptanit, Abas Çelkupa u detyrua të shpërngulej me gjithë familjen në Ulqin, për t'u vendosur më pas në Shkodër, ku bashkëpunoi me Luigj Gurakuqin e atdhetarë të tjerë. Në vitet 1916–1918 u vendos në Krujë. Edhe pse në moshë të shtyrë, ai u bë një nga mbështetësit e flaktë të revolucionit të qershorit të vitit 1924. Pas një jete të tërë të vënë në shërbim të pavarësisë së Shqipërisë dhe idealeve të larta kombëtare, patrioti Abas Çelkupa ndërroi jetë në marsin e vitit 1926, në moshën 78-vjeçare. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

3. ABDI TOPTANI (1864–1942)

Veprimtar i Rilindjes Kombëtare dhe i periudhës së Pavarësisë. Lindi në Tiranë në vitin 1864. Mësimet e para i mori në mejtepin e qytetit, më pas përfundoi gjimnazin në Stamboll. Pas kthimit në atdhe më 1895, i ushqyer që në rini me idetë kombëtare, ndryshe nga kushëri i tij i parë Esat pashë Toptani, me të cilin kishte divergjencë politike, Abdi Toptani u përfshi në lëvizjen patriotike që në fillimet e saj. Vite më vonë u njoh me Sami Frashërin dhe Shahin Kolonjën, me të cilët pati bashkëpunim të ngushtë. Në vitet e para të shek. XX së bashku me Murat Toptanin punuan për përhapjen e gjuhës shqipe me alfabetin latin.

Në vitin 1902 ishte një ndër organizatorët e kryengritjes së armatosur të malësorëve të Shëngjergjit e Shupalit kundër dhunës së administratës osmane. Në vitin 1905 e gjejmë në Korçë, ku së bashku me mikun e tij Orhan bej Pojani marrin pjesë në kryengritjen kundër pushtimit osman. Udhëhoqi forcat kryengritëse në rrethin e Krujës gjatë kryengritjes kundërosmane në verën e vitit 1912. Ka bashkëpunuar ngushtë me Hasan Prishtinën, Nikollë Kaçorrin dhe Mustafa Krujën për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të



vitit 1912.

Në nëntor 1912 priti në Durrës Ismail Qemalin dhe së bashku me vëllian e tij, Murat Toptanin, e shoqëruan atë deri në Vlorë. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Abdi". Më 4 dhjetor 1912 Qeveria e

Përkohshme e Vlorës e zgjodhi ministër të Financave, detyrë që e mbajti deri në tetor 1913. Në qeverinë e Princ Vidit caktohet ministër i Bujqësisë (28 maj–3 shtator 1914). Në vitin 1915 u detyrua të largohet nga atdheu dhe shkoi në Zvicër, ku së bashku me atdhetarë të tjerë ndërmorën nismën për krijimin e gazetës "Albania". Përfaqësoi Tiranën në Kongresin e Lushnjës më 1920. Duke qenë një ndër aktivistët kryesorë të tij, u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë. Përkrahu kryengritjen e marsit të vitit 1922 të udhëhequr nga Bajram Curri kundër politikës së Ahmet Zogut. Pas dështimit të kryengritjes u dënua me vdekje, por për shkak të protestave të elementëve atdhetarë Zogu nuk e zbatoi vendimin.

Viti 1915 Abdi Toptanin e gjen jashtë atdheut,



në organizimet patriotike të shqiptarëve në Zvicër. Po prej andej kthehet shumë shpejt në Shqipëri për t'u bërë pjesë e aktiviteteve politike të vendit. Vdiq në Tiranë në vitin 1942, vitin e festimit të 30-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë.

4. ARISTIDH RUCI (1875–1950)

Lindi në Sheper të Zagorisë më 11 mars 1875, ku mori dhe mësimet e para. Më pas shkoi në Janinë, ku përfundoi gjimnazin "Zosimea". Në vitin 1896 shkoi në Stamboll, ku punoi për dy vjet në një dyqan lëndësh ndërtimi. Siç do të pohonte që në gjallje të tij, në Stamboll u njoh me Naim Frashërin, Shahin Kolonjën, njohje që ndikuan shumë në formimin e tij atdhetar. Në vitet 1899–1904 shkoi përsëri në Janinë, ku punoi në tregun e drithit të qytetit. Kishte korrespondencë me atdhetarët e Bukureshtit, të Misirit e të Bostonit. Ndërkohë u njoh me Osman Haxhiun, i cili e mori të punonte si ekonomist në çifligun e tij në fshatin Picar. Në vitin 1906 u vendos në qytetin e Vlorës, ku qëndroi deri në fund të jetës. U mor me tregti dhe u bë një ndër tregtarët më të njohur të qytetit. Ndërkohë u mor me veprimtari kombëtare dhe bashkëpunoi me personalitetet më të spikatura të Vlorës e më gjerë. Më 1908 u bë anëtar i klubit patriotik "Labëria", që synonte rritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe. Shumë shpejt u bë një ndër veprimtarët më aktivë të këtij klubi. Ai financoi blerje armësh për çetat patriotike dhe përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe. Po atë vit së bashku me Todi Lubonjarin çelën fshehtas një kurs për mësimin e gjuhës shqipe. Në korrik të vitit 1911 ishte një nga organizatorët e Kuvendit të Drashovicës dhe pjesëmarrës në Kuvendin e Sinjës. Të dy kuvendet shprehën mbështetjen për Memorandumin e Greçës. Në nëntorin e vitit 1912 mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si përfaqësues i Tepelenës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "A. Ruci". Me krijimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës veprimtaria e tij vijoi me të njëjtin përkushtim atdhetar. Me kërkesë të Ismail Qemalit ndihmoi në strukturimin dhe organizimin e administratës në Fier, Vlorë, Tepelenë, Gjirokastrës e Delvinë. Gjatë viteve 1918–1920 u përfshi në veprimtari të dendur kombëtare kundër pushtuesve italianë dhe u bë një

Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekret nr. 7574, datë 26.06.2012, së bashku me firmëtarët e tjerë të Deklaratës së Pavarësisë.




ndër veprimtarët më të spikatur të komitetit "Mbrojtja Kombëtare", që u mor me organizimin e Luftës së Vlorës më 1920, luftë në të cilën mori pjesë së bashku me luftëtarët e tjerë. Më pas u zgjodh anëtar i komisionit që u caktua për organizimin e shoqërisë patriotike "Përlindja Kombëtare"

dhe hartimin e rregullores së saj, së bashku me Jani Mingën, dom Markun, Vesel e Sezai Çomon. Në vitet 1920–1924 u përfshi në lëvizjen demokratike të kohës dhe u anëtarësua në federatën "Atdheu" dhe shoqërinë "Bashkimi". Bashkëpunoi me Fan S. Nolin, Halim Xhelon, Avni Rustemin e Jani Mingën. Atdhetar i flaktë, njeri që idealin e madh e të vetëm kishte interesat e atdheut, ai demaskoi politikën shoviniste greke në lidhje me krahinat e Himarës e të Gjirokastrës dhe punoi pa u lodhur për ngritjen e vetëdijes kombëtare. Luajti një rol të rëndësishëm për zhvillimin e arsimit në qytetin e Vlorës. Në vitin 1937 u zgjodh anëtar i kryesisë së Bankës Kombëtare Shqiptare, ndërsa në prill të vitit 1939 ishte një ndër iniciatorët e krijimit të degës së Kryqit të Kuq për Vlorën. Për veprimtarinë e tij patriotike pushtuesit fashistë e arrestuan dhe e internuan në Itali. Pas marrjes së pushtetit nga komunistët Aristidh Ruci, ky burrë i ndershëm e bujar, i mençur e i guximshëm, modeli i atdhetarit dhe i njeriut të vërtetë, jo vetëm nuk u vlerësua, por u arrestua dhe u burgos si tregtar. Si burrë i vërtetë që ishte, siç kishte vepruar gjatë tërë jetës së tij, ai e pranoi me dinjitet fatin e tij. Ndërroi jetë në prill të vitit 1950 në Vlorë, në qytetin ku 38 vjet më parë së bashku me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin dhe burra të tjerë të mëdhenj të këtij kombi kish bërë të mundur përmbushjen e idealit shekullor të pavarësisë kombëtare. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

5. BEDRI PEJANI

(1885–1946)

Veprimtar i lëvizjes për bashkim e çlirim kombëtar. Lindi më 10 tetor 1885 në Pejë. Kreu studimet e larta për histori në Universitetin e Stambollit. U mor me publicistikë. Ishte njohës i mirë i çështjes kombëtare shqiptare dhe i problemeve të Ballkanit. Qysh në rininë e tij u rreshtua përkrah personaliteteve të njohura të Lëvizjes Kombëtare. Delegat në Kongresin e Dytë të Manastirit (1910), në diskutimin e tij mbështeti propozimin e Dervish Himës për botimin e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Në vitet 1911–1912 mbështeti kryengritjen antiosmane në Kosovë dhe bashkëpunoi me Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Idriz Seferin e atdhetarë të tjerë. Mori pjesë në në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si përfaqësues i Plavës, Gucisë, Gjakovës e Pejës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Bedri Pejan”. Kuvendi Kombëtar e zgjodhi anëtar të Pleqësisë. Në vitet e Luftës së Parë Botërore Bedri Pojani punoi për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë dhe përdorimin në shkolla të alfabetit latin. Pas Luftës së Parë Botërore kundërshtoi politikën serbomalazeze për shkombëtarizimin e viseve shqiptare. Ishte një nga themeluesit e komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (1 maj 1918) dhe sekretar i tij. Në vitet 1920–1924 u vu në krye të forcave demokratike për mbrojtjen e interesave kombëtarë të popullit shqiptar.



Mbështeti qeverinë e Fan Nolit më 1924 dhe pas dështimit të saj emigroi në Vjenë, Berlin e Paris, por nuk e ndërpreu asnjëherë veprimtarinë politike e atdhetare. Veprimtar i shquar i KONARE-së (Komiteti Nacional Revolucionar). Ishte kundërshtar i pushtimit fashist të Shqipërisë më 1939. Pushtuesit fashistë e internuan në Porto-Romano (Durrës). Në vitin 1941 u kthye përsëri në Kosovë dhe për disa kohë jetoi e veproi në qarkun e Mitrovicës, në zonën gjermane të pushtimit. Në shtator 1943 ishte një nga nismëtarët kryesorë për krijimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Në mbledhjen e dytë të Lidhjes, që u mbajt më 17–21 janar 1944, u zgjodh kryetar i saj në vend të Rexhep Mitrovicës, të cilin Këshilli i Lartë i Regjencës e ngarkoi me detyrën e kryeministrit dhe të ministrit të Kulturës Popullore. Qëndroi në krye të Lidhjes së Dytë të Prizrenit deri në maj 1944. Pas Luftës së Dytë Botërore u arrestua në Shqipëri dhe iu dorëzua autoriteteve jugosllave, që e dënuan me vdekje. U lirua si njeri që kishte qenë i lidhur me KOMINTERN-in. Vdiq më 6 korrik 1946. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

6. DOM NIKOLLË KAÇORRI

(1862–1917)

Klerik atdhetar dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare. Lindi në fshatin Krejë-Lurë të Dibrës në vitin 1862. Babai i tij ishte katolik, ndërsa nëna myslimane, gjë që tregon tolerancën fetare të familjes. Pasi përfundoi shkollën katolike në Shkodër, ndoqi studimet e larta për teologji në Itali. Pas studimeve u shugurua prift. Në vitin 1893 u emërua famullitar në kishën katolike të Durrësit, ku shërbeu për 20 vjet. Me fillimin e detyrës si prift shërbeu edhe si mësues në shkollën fillore që çelën austro-hungarezët në këtë qytet. Për veprimtari të frytshme kishtarë



Papa i asaj kohe e nderoi me Kryqin e Artë “Për Kishë dhe Papë”. Emërohet ipeshkv. Në vitet 1899–1905 bashkëpunon me at Shtjefën Gjeçovin. Nën ndikimin e tij filloi të mblidhte këngë popullore të Shqipërisë së Mesme, Shqipërisë së Veriut dhe Kosovës, të cilat i përmbledhi në një vëllimth me titullin *Canti albanesi popolari* (“Këngë popullore shqiptare”). Ndhmoi kryengritjen kundërosmane të Kurbinit



në vitet 1905–1907. Pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit (1908) dhe në Kongresin e Elbasanit (1909). Në vitin 1909 u bë nismëtar i themelimit të klubit patriotik “Bashkimi” në Durrës, pranë të cilit çeli kursin për mësimin e gjuhës shqipe. Në vitet 1911–1912 u angazhua në organizimin e kryengritjes në Durrës e rrethinat e tij. Bashkëpunoi me lëvizjen kryengritëse në rrethet katolike të Kosovës, të Malësisë së Mbishkodrës dhe të zonës së Mirditës. Për veprimtarinë e tij patriotike u arrestua nga autoritetet turke dhe u dënua me burgim. Më 28 nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Kaçorri”. Kuvendi e zgjodhi nënkryetar të Qeverisë së Përkohshme të kryesuar nga Ismail Qemali, ku luajti një rol të rëndësishëm në ngritjen e administratës shqiptare. Duke pasur parasysh faktin se Ismail Qemali qe edhe ministër i Jashtëm dhe ishte i detyruar ta kalonte kohën më të madhe jashtë Shqipërisë, mund të thuhet se dom Nikollë Kaçorri luante *de facto* rolin e kryeministrit të vendit. Pas rënies së qeverisë së Ismail Qemalit në janar të vitit 1914 u vendos në Durrës.

Kur qeveria e Ismail Qemalit dështoi, dom

Nikollë Kaçorri së bashku me Luigj Gurakuqin, Mustafa Krujën, Fahri Gjilanin e Themistokli Gërmenjin themeloi lidhjen “Për Atdheun e për Thronin”, që synonte shpëtimin e atdheut nga situatat e ndryshme antikombëtare që gëlonin asokohe. Me shpërthimin e kryengritjes së Shqipërisë së Mesme të kryesuar nga Haxhi Qamili, që do t’i digjte shtëpinë dhe do t’i shkatërronte bibliotekën e tij personale, ndër më të pasurat në Shqipëri në atë kohë, emigroi jashtë atdheut. U vendos në Vjenë, ku vazhdoi veprimtarinë e tij politike dhe patriotike. Vdiq në moshën 55-vjeçare më 29 maj 1917. Në vitet e regjimit komunist figura e dom Nikollë Kaçorrit pothuajse u harrua fare. Vetëm në vitin 1962, me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, u nderua me Urdhrin “Për Veprimtari Patriotike të Klasit të Dytë”, një medalje që nuk e justifikonte aspak kontributin e tij për pavarësinë e atdheut, së cilës ai i kushtoi gjithë jetën. Në vitin 2007 u dekorua me Urdhrin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”. Në vitin 1912 eshtrat e dom Nikollë Kaçorrit u sollën në atdhe. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

7. DHIMITËR BERATI

(1888–1970)

Veprimtar politik, diplomat i rangut të lartë, publicist. Lindi në Korçë më 15 tetot 1886. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas ndoqi studimet në shkencat politike e juridike në Bukuresht dhe në Romë. Në vitet 1904–1905 u përfshi në veprimtarinë patriotike të kolonisë shqiptare të Bukureshtit. Pas vitit 1905 u kthye në Korçë, ku punoi si mësues në shkollën e parë shqipe së bashku me patriotët Thanas Floqi e Thoma Avrami. Anëtar i klubit patriotik “Dituria” të Korçës që në themelimin e tij më 1908. Në vitin 1909 mori pjesë në Kongresin e Elbasanit, kurse më 1910 në Kongresin e Dytë të Manastirit. Në nëntor 1912 bashkësisë shqiptare e Bukureshtit e zgjodhi delegat për në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe ai shoqëroi Ismail Qemalin dhe Luigj Gurakuqin në udhëtimin për në Shqipëri. Nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën



“D. Beratti”. U zgjodh anëtar i Pleqësisë, që e zgjodhi sekretar të saj. Qeveria e Vlorës e ngarkoi me detyrën e sekretarit të shtetit në Ministrinë e Jashtëm, që kryesohej nga Ismail Qemali. Nga gushti i vitit 1913 deri në mars 1914 drejtoi gazetën “Përlindja e Shqipëniës”,

e para fletore zyrtare e shtetit shqiptar. Në vitin 1914, pas dorëheqjes së Ismail Qemalit nga kreu i qeverisë, emigroi në Rumani, ku jetoi gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Ishte sekretar i bashkësisë shqiptare të Rumanisë dhe sekretar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919–1920). Në vitin 1923 ishte drejtor i Zyrës Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtëm dhe anëtar i komisionit ndërkombëtar për kufijtë,

në vitin 1924 u emërua kryekonsull në Sofje dhe në fund të dhjetorit të këtij viti zëvendësoi Xhemil Dinon si i ngarkuar me punë në Paris, duke qenë njëkohësisht i akredituar edhe në Londër. Në vitin 1926 u ngarkua me detyrën e sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe më 1929 përsëri drejtor i Zyrës Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në vitin 1930 u caktua delegat i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Në shenjë mirënjohje për lidhjet me rumunët dhe Rumaninë, ku jetoi jo pak vjet, mbretëria rumune më 1932 e dekoroi me medaljen *“Grand Officer De La Courron Roumania”*. Më 1934 u emërua ministër i Ekonomisë Kombëtare dhe që nga shtatori i atij viti e deri në tetor 1935 drejtoi edhe Ministrinë e Arsimit. Në qeverinë e kryesuar nga Mehdi Frashëri (21 tetor 1935–7 nëntor 1936) ishte ministër i Ekonomisë Kombëtare. Prej dhjetorit 1941 e deri në janar 1943 ishte ministër i Kulturës

Popullore e përkohësisht edhe ministër i Arsimit në qeverinë e Mustafa Krujës (Merlikës). Pas rënies së qeverisë së Rexhep Mitrovicës në qershor 1944 u largua përgjithmonë nga Shqipëria dhe u vendos në Romë. Botoi disa libra me karakter historik dhe politik, si: *“Shqipëria dhe shqiptarët”* (1920), *“Shënime historike”* (1931), *“Qëllimi dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve”*, *“Shqipëria më 1937”*, si dhe mjaft artikuj për historinë, traditat dhe kulturën shqiptare në revistën *“Shenjëzat”*, që botohej në Romë. Në vitin 1969 shkoi në Nju-Jork, ku mori pjesë në kremtimet e shoqërisë *“Vatra”*. Vdiq në Romë në moshën 82-vjeçare më 8 shtator 1970. Është dekoruar me Urdhrin *“Për Veprimtari Patriotike të Klasit të Parë”*, ndërsa me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin *“Nderi i Kombit”* nga Presidenti i Republikës me dekret nr. 7574, datë 26.06.2012, së bashku me firmëtarët e tjerë të Deklaratës së Pavarësisë.

8. DHIMITËR EMANOIL (MBORJA)

(1884–1945)

Atdhetar dhe luftëtar për çështjen e pavarësisë kombëtare. Lindi në fshatin Mborje të Korçës më 1884. Mësimet e para i mori në qytetin e Korçës. Në vitin 1900 babai i tij emigroi në Rumani dhe u vendos në Bukuresht, ku u shkollua Dhimitri. Ai jetoi në Bukuresht në kohën kur shoqëritë shqiptare *“Drita”*, *“Dituria”*, *“Shpresa”*, *“Bashkimi”* e të tjera botonin veprat e rilindësve tanë, abetare, revista e gazeta në gjuhën shqipe për t’u ndezur shqiptarëve zjarrin e atdhedashurisë. Shtëpia e tij në Bukuresht ishte baza ku zhvilloi veprimtarinë patriotike Themistokli Gërmenji, ndërsa në dyqanin e babait ai njohu mjaft atdhetarë të tjerë, nën ndikimin e të cilëve u edukua me idetë kombëtare dhe shpejt u përfshi në veprimtarinë atdhetare të kolonisë shqiptare të atjeshme. Botoi dhe shpërndau në shoqëritë patriotike të Bukureshtit programin e komitetit të fshehtë *“Për Lirinë e Shqipërisë”*. Në vitin 1908 anëtarësohet në shoqërinë patriotike *“Dituria”*. Më 5 nëntor 1912 mori pjesë në mbledhjen që Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi zhvilluan me përfaqësuesit e shoqërive patriotike të Bukureshtit. U zgjodh delegat për në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe



së bashku me delegatët e tjerë shoqëroi Ismail Qemalin në udhëtimin e vështirë për shpalljen e pavarësisë. Më 28 nëntor 1912 nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë mesigjën *“Dh. Emmanuel”* në emër të kolonisë shqiptare të Bukureshtit. Sipas dëshmive të kohës, pas krijimit të Qeverisë

së Përkohshme ai dorëzoi në Ministrinë e Financave 1000 franga ari për arkën e shtetit, të mbledhura si ndihmë nga shqiptarët e Bukureshtit. Në dhjetor të vitit 1912 bashkë me Dhimitër Zografin shkoi në Brindisi e më pas vjen në Korçë. Përfaqësoi koloninë shqiptare të Bukureshtit edhe në Kongresin Shqiptar të Triestes në pranverë të vitit 1913. Më 1914 e shohim në Korçë bashkë me vëllain e vogël, Nuçi Emanoil, në krah të Themistokli Gërmenjit, pas një kërkese që ky i fundit iu bën vëllezërve Emanoil (Mborja). Shtypi i kohës dëshmon se për disa vjet ka punuar mësues në shkollat e këtij qyteti dhe se ka marrë pjesë në Kongresin Arsimor të Lushnjës (gusht 1920). Rreth vitit 1920 lëshoi shtëpinë së tij në Korçë si ambient



mësimor për Liceun Kombëtar. Më 1924 mbështeti lëvizjen demokratike të Fan Nolit. Pas rënies së qeverisë së tij u largua në Rumani dhe për disa vjet nuk u kthye në atdhe. Nuk pati simpati për regjimin komunist që u vendos në Shqipëri, ndoshta kjo mund të jetë dhe arsyeja që, ashtu si shumë firmëtarë të tjerë të Deklaratës së Pavarësisë, u la në harresë. Vdiq në Bukuresht në vitin 1945. Më 27 nëntor 1992, me dekret të

Presidentit të Republikës nr. 372, nderohet me Urdhrin “Për Veprimtari Patriotike të Klasit të Parë” me motivacionin: “Atdhetar i dalluar i lëvizjes kombëtare, që ka dhënë një kontribut të madh për forcimin e shtetit të pavarur shqiptar”, ndërsa me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

9. DHIMITËR TUTULANI

(1875–1937)

Dhimitër Tutulani (19 mars 1875-1937), i njohur ndryshe si *Taq Tutulani* ose *Dhimitraq Tutulani*, lindi në Berat më 19 mars të vitit 1875, ku rreth dy shekuj më parë ishin vendosur paraardhësit e tij, si shumë familje të tjera të larguara nga Voskopoja pas shkatërrimit të qytetit të akademisë dhe të kulturës mesjetare.

Vitet e fëmijërisë së Dhimitër Tutulani ishin vitet kur çështja kombëtare kishte nisur të vlonte me ëndrrat dhe dëshirat patriotike për një Shqipëri të pavarur. Pasi mori mësimet e para në Berat, ai vazhdoi gjimnazin “Zosimea” në Janinë, ku mësoi disa gjuhë europiane, ndërsa studimet e larta i kreu në Athinë për jurisprudencë, të cilat i dhanë mundësinë të njihet me idetë që ngritën Rilindjen europiane, iluminizmin dhe humanizmin, që u paraprinë lëvizjeve të mëdha për liri në vendet e Ballkanit. Ai u kthye në vendlindje dhe çeli zyrën e avokatisë.

Dhimitër Tutulani u bashkua me qarqet intelektuale më të spikatura në ato vite në Berat, si Babë Dudë Karbunara, Sulo Resuli, Llambi Goxhomani, Jorgji Manushi, Nyzhet Vrioni etj. I përfshirë në këtë mjedis patriotësh, Dhimitër Tutulani mori pjesë në lëvizjet patriotike antiosmane, zhvilluar në 10-vjeçarën e parë të shekullit XX, sidomos në vitet 1908–1912. Më 22 dhjetor 1908 mori pjesë në krijimin e klubit patriotik “Bashkimi” të qytetit të Beratit, një qendër kulturore ku mblidheshin qytetarë nga shtesa të ndryshme sociale, të cilët nën pektun e kulturës zhvillonin aktivitete për formatimin e një lëvizjeje të gjerë patriotike.

Në vitin 1908 mbështeti Kongresin e Manastirit për çeljen e shkollave shqipe dhe në vitin 1911 memorandumit e Gerçës. Një vit më




vonë ai u përfshi në kryengritjet antiosmane të zonës Berat–Mallakastër–Vlorë dhe mori pjesë në Kuvendin e Sinjës, që u mbledh më 23 korrik 1912 dhe doli me kërkesa politike. Ishte ky kontribut i spikatur në çështjen kombëtare që e çoi Taq Tutulani në Kuvendin

e Vlorës më 12 nëntor 1912 së bashku me mësuesin patriot Jorgji (Dudë) Karbunara dhe Iliaz Vrionin, ku ai firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Dh. Tout.”.

Vetëm 6 vjet më pas ai u zgjodh delegat i Beratit në Kongresin e Durrësit, që u mbajt më 25–27 dhjetor 1918, në përpjekje për formimin e qeverisë shqiptare në çastet kur territori rrezikohej më shumë se kurrë. Kongresi i Durrësit zgjodhi Qeverinë e Përkohshme dhe një prej votuesve ishte dhe firmëtar i Pavarësisë Dhimitër Tutulani. Dy vjet më vonë mori pjesë si delegat në Kongresin e Lushnjës dhe ndihmoi qeverinë e Sulejman Delvinës për konsolidimin e saj. Në vitet 1922–1924 përkrahu politikën e Fan Nolit dhe qeverinë e tij dhe më 1925-n u zgjodh kryetar i bashkisë së Beratit. Më shumë se 35 vjet të jetës së tij Dhimitër Tutulani ia kushtoi Kishës Autoqefale Shqiptare, konsolidimit të saj, çka e tregon edhe korrespondenca që pati me Fan Nolin, Visarion Xhuvanin, Foqion Postolin, Tol Arapin etj. Vdiq në Berat në vitin 1937. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

10. DHIMITËR ZOGRAFI (1878–1947)

Veprimtar i periudhës së Pavarësisë. Lindi në Korçë në vitin 1878. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Athinë, ku ndoqi dhe studimet e larta në degën e drejtësisë. Në fund të shekullit XIX së bashku me vëllezërit emigroi në Rumani, ku u përfshi në veprimtarinë e shoqërive patriotike “Drita” dhe “Dituria” të shqiptarëve të atjeshëm. Në dhjetor 1906 mori pjesë në themelimin e shoqërisë “Bashkimi”⁶ të Bukureshtit. Po atë vit shkoi në Egjipt, ku u takua me shoqërinë patriotike të shqiptarëve të atjeshëm. Në vitet 1911–1912 mbështeti kryengritjet kundërosmane të Kosovës. Ishte një nga organizatorët e mbledhjes së Bukureshtit më 5 nëntor 1912 me Ismail Qemalin dhe Luigj Gurakuqin. Shqiptarët e Bukureshtit e zgjodhën delegat për në Kuvendin Kombëtar, që do shpallte pavarësinë e Shqipërisë. Bashkë me delegatët e tjerë shoqëroi Ismail Qemalin në udhëtimin historik nga Bukureshti për në Vlorë. Më 28 nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin Kombëtar




dhe nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Dimitri Zografi”. U zgjodh anëtar i Pleqësisë. Në dhjetor 1912 u kthye në Korçë, prej nga u largua më 1917. Përshëndeti ardhjen e Princ Vidit (mars 1914) dhe shprehu hapur kundërshtimin ndaj politikës përçarëse së Esat Toptanit. Në vitet 1914–1917 pati korrespondencë të gjerë me Ismail Qemalin, që në ato vite ndodhej në Paris. Kundërshtoi vendimet e padrejta të Konferencës së Paqes të Parisit në kurriz të popullit shqiptar dhe firmosi notëprotestat drejtuar kryesisë së saj në qershor 1919. Për një kohë të gjatë ushtroi profesionin e avokatit në Bukuresht. Vdiq në vitin 1945. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

11. ELMAS BOCE (1850–1925)

Atdhetari Elmas Boce lindi në qytetin e Gjirokastrës në vitin 1850. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmen e vijoi në gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Nën ndikimin e vëllezërve Frashëri dhe të patriotëve të tjerë u përfshi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare që në moshë të re. Në mënyrë të veçantë ai u ndikua nga atdhetari i madh Abdyl Frashëri, me të cilin takohej e bisedonte dhe mbajti korrespondencë të rregullt. Në korrik 1889 mori pjesë në organizimin e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në qytetin e Gjirokastrës.

Në shtator të vitit 1908 ai shkoi në Janinë së bashku me atdhetarin e shquar Bajo Topulli. Në fjalimin që mbajti në një tubim të organizuar atje, ai kërkoi liritë dhe të drejtat kombëtare. Elmas Boce shfrytëzoi çdo mundësi që kishte për t’i ardhur në ndihmë atdheut të tij dhe çështjes kombëtare. Duke e ditur se arsimit ishte shtylla më e fortë ku mund të mbështetet e ardhmja dhe



përparimi i vendit, ai e shndërroi në shkollë shtëpinë e tij që t’u mësonte gjuhën amtare djemve e vashave gjirokastrite. Ai ua mësonte shqipen të gjithë atyre që e dëshironin një gjë të tillë e në të njëjtën kohë bënte dhe punë bindëse me ata që nuk e kuptonin rëndësinë që kishte leximi e këndimi i gjuhës amtare. Mbështetës i flaktë i komitetit “Për Lirin’ e Shqipërisë”, Elmas Boce kishte korrespondencë të rregullt me atdhetarët e kolonive shqiptare të Bukureshtit, Kajros dhe

⁶. Shoqëritë patriotike “Dituria”, “Drita” dhe “Shpresa” shpallën shkrirjen e tyre në një shoqëri të vetme me emrin “Bashkimi”. Kryetar i komitetit të shoqërisë u zgjodh Thoma Çami, ndërsa zëvendës Kristo Meksi dhe Pandeli Evangjeli.



Stambollit. Ai ishte anëtar i këshillit të shoqërisë "Drita" dhe dha ndihmesën të vyer në hapjen e shkollës shqipe "Liria" në Gjirokastër. Një prej shumë fakteve që dëshmojnë se veprimtaria e tij në shërbim të arsimit e të çështjes kombëtare ishte shumë e konsiderueshme është urrejtja që kishin ndaj tij pushtuesit osmanë dhe shovinistët grekë, të cilët ngritën disa herë kurthe për ta vrarë këtë patriot të shquar. Më 1909 ishte një ndër veprimtarët e shquar të shoqërisë kulturore "Kandile". Ai ndihmoi grupin amator të kësaj shoqërie për të vënë në skenë dramën "Besa". Më 1911 përkrahu Kuvendin dhe Memorandumin e Greçës dhe u bë mbështetës i kryengritjes antiosmane të vitit 1912. Pas thirrjes së Ismail Qemalit që nga çdo krahinë shqiptare të zgjidheshin personalitetet që do të merrnin pjesë në Kuvendin historik të Vlorës, duke qenë se kishte merita të veçanta si atdhetar e mësues i shquar, Elmas Boce zgjidhet njëzëri përfaqësues i Gjirokastrës. Kështu, veprimtaria atdhetare e tij

kurorëzohet në mënyrë të shkëlqyer e plotësisht të meritueshme: ai firmos Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Elmas Boce" dhe sheh me mallëngjim valëvitjen e flamurit të Skënderbeut pas shekujsh të tërë robërie. Në vitin 1913 mori pjesë në tubimin dhe protestat e organizuara në qytetin e Vlorës kundër barbarizmave të shovinistëve grekë, që ndërkohë po digjnin e rrënonin viset jugore të vendit. Më 1915 emigroi në Itali. Kur u kthye, ashtu si shumë atdhetarë të tjerë, fillimisht u vendos në qytetin e Shkodrës. Më vonë, me tërheqjen e trupave Austro-Hungareze, u vendos në rrethinat e Lushnjës. Edhe aty e vazhdoi veprimtarinë e tij në shërbim të atdheut, duke u përqendruar në përhapjen e arsimit. Elmas Boce ndërroi jetë më 10 tetor të vitit 1925 dhe u varros në Metan të Lushnjës. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

12. FERIT VOKOPOLA (1887–1969)

Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, një figurë e mirëfilltë patriotike, që kontribuoi në çështjen e pavarësisë së vendit dhe ndërtimin e shtetit të ri shqiptar. Ishte politikan, ekonomist, teolog, poet, filozof dhe eseist. Lindi më 18 gusht 1887 në fshatin Vokopolë të Beratit, një lidhëse mes zonës së Beratit, Skraparit dhe Përmetit. Në fillim të shek. XIX familja e tij u vendos në Berat, ku ai mori mësimet e para në mejtepin dhe shkollën ruzhdije të qytetit. Arsimin e mesëm e vijoi në Stamboll, ku përfundoi edhe studimet universitare për drejtësi dhe ekonomi. Pas mbarimit të shkollës për disa vite jetoi në Berat, ku ushtroi profesionin e avokatit. Në nëntor të vitit 1912 u zgjodh delegat i Lushnjës në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe mori pjesë në të gjitha mbledhjet e tij. Nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "M. Ferit Vokopola". Qeveria e Vlorës e ngarkoi me detyrën e organizimit dhe furnizimit të ushtrisë kombëtare në zonën e Myzeqesë, gjatë ushtrimit të së cilës bashkëpunoi ngushtë me ministrin e Luftës Mehmet pashë Dërralla dhe Azis pashë Vrionin. Me fillimin e botimit të gazetës "Përlindja e



Shqipëniës", ishte një nga korrespondentët e rregullt të saj dhe botoi mjaft artikuj për situatën politike, për bujqësinë, tregtinë etj. Në qeverinë e Princ Vidit shërbeu në detyrën e kryesekretarit në Ministrinë e Industrisë dhe Minierave. Në janar 1920 ishte një nga

organizatorët e Kongresit të Lushnjës, ku mori pjesë si përfaqësues i prefekturës së Beratit, Lushnjës dhe Skraparit. Ai mbajti fjalën e hapjes dhe u zgjodh sekretar për mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit. I frymëzuar nga kjo ngjarje historike ai shkroi vjershën "Himni i Kongresit të Lushnjës", që është botuar në librin e tij "Symbyllazi me ëndërrime". Punoi në sekretarinë e Kryeministrisë nga viti 1920 deri në vitin 1923, kur nis veprimtarinë e tij parlamentare, që nuk do të ndërpritet deri në vitin 1939. Në zgjedhjet e dhjetorit 1923 u zgjodh deputet i Beratit, rizgjidhet në maj 1925, gusht 1928, nëntor 1932, janar 1937 dhe prill 1939. Ai ishte shumë aktiv e i përkushtuar në jetën

parlamentare dhe ka dhënë një ndihmesë të çmuar, në mënyrë të veçantë në fushën legjislative. Me nismën e tij dhe të disa deputetëve të tjerë u hartua dhe u miratua Kodi Civil i asaj kohe, që ishte një hap shumë i rëndësishëm në udhën e përparimit e të zhvillimit të vendit. Gjatë periudhës së monarkisë (1928–1939) kreu detyra të rëndësishme, deri ministër i Bujqësisë. Përveç veprimtarisë parlamentare dhe politike ai nuk reshti së punuari edhe në fusha të tjera. Gjatë periudhës 1920–1928 ishte një nga nismëtarët kryesorë për themelimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe dha kontribut të ndjeshëm për ngritjen e Medresesë së Përgjithshme të Tiranës. Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia në 1939 ai u tërhoq nga jeta politike dhe administrata shtetërore dhe

iu kushtuar krejtësisht aktivitetit fetar. Në këtë kohë ai themeloi në Tiranë organizatën fetare “Drita Hyjnore”, që pati si organ të vetin revistën “Njeriu”, e cila doli rregullisht nga korriku 1942 deri në qershor 1944. I bindur në pikëpamjet e tij, Ferit Vokopola ishte ndër të parët në Shqipëri që iu përkushtua përkthimit në shqip të Kuranit nga osmanishtja e vjetër, të cilin e përfundoi pas një pune këmbëngulëse 10-vjeçare. Pushteti komunist e burgosi për dhjetë vjet. Pasi doli nga burgu, disa kohë ndenji pa punë. Pesë vjetët e fundit të jetës, meqë zotëronte disa gjuhë orientale, i ofruan punë në Institutin e Historisë si përkthyes nga osmanishtja. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

13. HAJREDIN CAKRANI (1860–1942)

Lindi në Cakran të Fierit më 1860 në një familje me autoritet në Mallakastër e Myzeqe. Mësimet e para i mori në vendlindje, shkollën e mesme e kreu në gjimnazin “Zosimea” të Janinës, ndërsa më pas shkoi në Stamboll, ku përfundoi Akademinë Ushtarake. Pas përfundimit të studimeve shërbeu si ushtarak në vilajetin e Janinës, në Boleu e Stamboll. Për disa vjet punoi në administratën turke në prefekturën e Beratit. Në klubin patriotik të Beratit ai bashkëpunoi ngushtë me mjaft figura të njohura, si Azis pashë Vrionin, Iliaz Vrionin dhe Sulo Resulin. Përkrahu me entuziazëm Kongresin e Manastirit dhe mbështeti përpjekjet për përhapjen e gjuhës shqipe. Në vitin 1883 ai solli në zonën e Mallakastrës abetaren e parë dhe një sërë botimesh të tjera në shqip të botuara në Bukuresht e Stamboll dhe u përpoq për hapjen e një shkolle shqipe, përpjekje që u bënë realitet në vitin 1908, kur bashkë me vëllain, Bektash Cakranin, çelën në shtëpinë e tyre shkollën shqipe të Cakranit me mësues Thanas Floqin. Në vitet 1908–1909 u lidh e bashkëpunoi me klubin “Labëria” dhe me klubin e atdhetarëve të Filatit në Çamëri. U shkëput nga administrata xhonturke dhe iu përkushtua çështjes kombëtare. Mbështeti Memorandumin e Greçës




(qershor 1911) dhe mori pjesë në kuvendin ndërkrahinor të Drashovicës (korrik 1911). Në vitin 1912 përkrahu lëvizjen antiturke në Vlorë, Berat, Mallakastër e Kurvelesh. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i Mallakastrës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë

me siglën “Hajredin Cakrani”. Kuvendi Kombëtar e zgjodhi anëtar të Pleqësisë. Në vitet 1913–1914 ai ishte komandant i forcave që luftonin në zonën e Skraparit për t’i prerë hovin ushtrisë shoviniste greke, që dogji e shkatërroi viset shqiptare. Shoqëroi ministrin e Luftës, Mehmet Pashë Dërrallën, në frontin e luftimeve në Sevaster e Mallakastër. Më 25 dhjetor 1918 ishte delegat i Mallakastrës në Kongresin e Durrësit. Në Luftën e Vlorës, në verën e vitit 1920, ishte një nga organizatorët e çetës së Cakranit dhe luftoi kundër pushtuesve italianë. Në vitet më pas u mor me punët e çifligut të tij. Pushtimin fashist më 1939, edhe pse në moshë të thyer, e priti me armë në dorë. Vdiq në vitin 1940 në vendlindje. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.



14. ILIAZ VRIONI (1882–1932)


Lindi në vitin 1882 në Berat, në familjen e njohur të Vrionëve. Ishte djali i patriotit të shquar Mehmet Ali pashë Vrioni, nënkryetar i Lidhjes së Prizrenit, dhe babai i përkthyesit të njohur Jusuf Vrioni. Mësimet e para i mori në vendlindje, arsimin e mesëm në Janinë, kurse studimet e larta i kreu në Stamboll, ku u diplomua më 1905. U përfshi herët në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe nën ndikimin e Babë Dudë Karbunarës punoi për përhapjen e librave shqip në Berat dhe rrethinat e tij, që i siguronte nga kolonitë shqiptare të Bukureshtit, Stambollit dhe Janinës. Në vitin 1908 ishte një nga themeluesit e klubit patriotik "Bashkimi" në qytetin e Beratit. Në vitet 1909–1911 shërbeu si kryebashkiak i Beratit. Më 28 nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i Beratit dhe nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Iljas Vrijon". Kuvendi Kombëtar e zgjodhi anëtar të Pleqësisë (Senatit). Punoi me përkushtim për ngritjen e administratës së Qeverisë së Përkohshme dhe organizimin e kryengritjeve në Përmet, Skrapar dhe Berat kundër shovinistëve grekë. Në gusht 1914 ishte një nga anëtarët e delegacionit shqiptar që shkoi në Gjermani për t'i dorëzuar kurorën e fronit Princ Vidit. Në vitet 1914–1918 jetoi në Korfuz. U kthye në atdhe më



1919. Ishte përfaqësues i Beratit në Kongresin e Lushnjës (1920). Kryesoi tri nga dhjetë qeveritë që u ndërruan në Shqipëri në vitet 1920–1924 (15 nëntor 1920–16 tetor 1921; 30 maj 1924–10 qershor 1924; 24 dhjetor 1924–5 janar 1925). Në vitet 1921–1922 ishte deputet i prefekturës së Dibrës në parlamentin shqiptar, ndërsa më 1923–1925 deputet i prefekturës së Beratit. Shërbeu disa herë si ministër i Punëve të Jashtme (30 mars–27 maj 1924; 12 shkurt–21 tetor 1927; 11 maj–1 shtator 1928; 5 shtator 1928–13 janar 1929), ministër i Jashtëm dhe zëvendësministër i Drejtësisë (26 tetor 1927–10 maj 1928), ministër fuqiplotë në Francë dhe Britani (1925–1926 dhe 1929–1932). Vdiq në Paris në moshën 50-vjeçare më 17 mars 1932. Për kontributin e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet 1920 është dekoruar me Urdhrin "Oficer i Lartë i Legjionit të Nderit" (*Grand Officier de la Légion d'Honneur*) nga Presidenti i Francës. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

15. JANI MINGA (1872–1947)

Veprimtar i shkollës shqipe, i Rilindjes Kombëtare dhe i lëvizjes demokratike të viteve 1920–1924, Mësues i Popullit. Lindi në fshatin Shënpjetër të Fierit më 1 gusht 1872. Në vitin 1880 familja e tij u vendos në Vlorë. Këtu ai ndoqi mësimet e para, ndërsa më pas ndoqi Shkollën Normale në Qestorat (Gjirokastër) dhe në Çotil (Maqedoni). Studimet e larta i kreu në Athinë për filologji. Është një nga luftëtarët më të paepur për zhvillimin e arsimit dhe çështjes shqiptare gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të 20-të. Dha mësim në shkollat greke të Ardenicës, Dhërmiut, Vlorës dhe Kaninës, ku u mësonte nxënësve fshehurazi edhe gjuhën shqipe. Në vitin 1900 bëhet anëtar i klubit patriotik "Lumi i



Vlorës". Bashkëpunoi me kolonitë shqiptare të Bukureshtit dhe Stambollit dhe në vitin 1908 u takua me Ismail Qemalin në Vlorë. Ishte një ndër nismëtarët e hapjes së shkollës së parë shqipe në Vlorë më 1908, të shkollës shqipe në Kaninë më 1910 dhe të themelimit të klubit patriotik "Labëria" në Vlorë, që do të zhvillonte një veprimtari të dendur kulturore dhe kombëtare. Në korrik 1911 mori pjesë në kuvendin e Drashovicës në mbështetje të Memorandumit të Greçës, ndërsa në shtator të vitit 1912 mori pjesë në konkursin që u organizua

në Janinë për mësues dhe fitoi të drejtën të jepte mësimet e historisë dhe gjeografisë. U emërua në shollën ruzhdie të Beratit, ku bashkëpunoi me mësuesin atdhetar Babë Dudë Karbunara. Në nëntor të atij viti u zgjodh delegat i Vlorës në Kuvendin Kombëtar dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "J. Minga". Qeveria e Vlorës e emëroi drejtor të arsimit për Vlorën, Gjirokastrën, Beratin dhe Durrësin. Ishte një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Luigj Gurakuqit. Në vitet 1918–1919 Jani Minga ishte një ndër organizatorët e manifestimeve më 28 nëntor 1918 dhe 1919 në kujtim të shpalljes së pavarësisë dhe i ceremonisë së varrimit të Ismail Qemalit më 12 shkurt 1919, ku ai dhe Qazim Kokoshi mbajtën nga një fjalim mbresëlënës. U arrestua ngas pushtuesit italianë si një nga organizatorët e Luftës së Vlorës më 1920 dhe u internua në ishullin e Sazanit. Pasi u lirua nga internimi u angazhua në shoqërinë "Përlindja Shqiptare" dhe së bashku me Qazim Kokoshin dhe Aristidh Rucin hartuan statutin e saj. Në vitet 1921–1924 punoi për demokratizimin e jetës së vendit dhe të shkollës me synimin që ajo të ishte kombëtare, laike, e njësuar dhe e detyrueshme për djem dhe vajza; bashkëpunoi ngushtë me personalitete të rëndësishme të kulturës kombëtare, si Shtjefën Gjeçovi, Ali Asllani, Hakim Xhelo etj., dhe u bë anëtar i federatës "Atdheu" të Avni Rustemit, në shoqërinë "Bashkimi", në

shoqëritë e arsimtarëve dhe mori pjesë në kongreset arsimore të viteve 1922 e 1924. U rreshtua përkrah forcave që mbështeten Fan Nolin më 1924. Kur qeveria e Nolit hyri në Tiranë, ai mbajti një fjalim përshëndetës, që la përshtypje tek të pranishmit për aftësitë e tij oratorike. Gjatë viteve 1925–1935 shërbeu si mësues dhe inspektor në qarkun e Gjirokastrës. Në vitin 1932 organizoi një miting në Mashkullorë me klubin e arsimtarëve të këtij qyteti në kujtim të Çerçiz Topullit. Për veprimtarinë e tij patriotike u përdoq bashkë me familjen. Mori pjesë familjarisht në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe dy djemtë e tij u dogjën në krematoriumet e komitit nazist të Mathauzenit. Një kontribut të vyer Jani Minga dha për hartimin e teksteve shkollore. Për nevoja të shkollës shqipe ai botoi "*Abetare kombëtare shqip përgatitore*" (1920), "*Abetare shqip këndimore*" (1921), "*Abetare shqip e rreshtueme pas parimeve të pedagogjisë të pedagogjisë dhe psikologjisë*" (1925), "*Gramatikë e gjuhës shqipe në toskërishte*" (1925) etj. Si drejtor i arsimit të qarkut të Vlorës botoi librin "*Program i zbërthyer i lëndës së mësueme në shkollat fillore 1921–1922*". Jani Minga vdiq në Vlorë më 7 maj 1947. Pas vdekjes iu dha titulli "Mësues i Popullit". Është dekoruar me Urdhrin e Flamurit dhe Urdhrin "Nderi i Kombit" me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë.

16. JORGJI KARBUNARA (BABË DUDË KARBUNARA) (1842–1917)

Atdhetar dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare, Mësues i Popullit. Lindi 5 maj të vitit 1842 në lagjen "Kala" të Beratit në një familje të fisme, që gëzonte respektin dhe admirimin e tërë qytetit. E pagëzuan me emrin "Jorgji", por beratasit e thirrën "Dudë", ndërsa në moshë të thyer për respekt e thirrën "Babë Dudë". Mësimet e para i mori në vendlindje, në një shkollë ku përdorej gjuha greke, pastaj familja e dërgoi në Korfuz në një shkollë dyvjeçare mësuesie, më pas në Trieste (Itali), ku përfundoi gjimnazin klasik. Mori një kulturë të gjerë për kohën. Njihte greqishten e vjetër dhe latinishten, greqishten e re dhe italishten e frëngjishten, njihte mirë kulturën



antike greke dhe atë romake. Pas mbarimit të studimeve u kthye në Berat. Edhe pse i mirarsimuar për kohën, autoritet osmane nuk e pranuan në administratë, ndaj të ardhurat e familjes i nxirrte duke u marrë me tregti. Në vitin 1970 filloi punë si mësues në Shkollën

Unike të Beratit, ku spikati përgatitja e lartë profesionale dhe dashuria e tij për nxënësit. Në vitet 1878–1881 ishte ndër veprimtarët e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Berat. Në vitet që pasuan punoi pa u lodhur për përhapjen e gjuhës shqipe dhe të ideve kombëtare në



shkollat e Beratit dhe fshatrat përreth, në zonën e Shpiragut dhe të Myzeqesë. Në vitin 1891 nisi të propagandonte Ungjillin dhe të psalte në gjuhën amtare, por kjo iu ndalua. Shqiptarizmi i theksuar i tij ra në sy të autoriteteve turke, arsye për të cilën u përdoq prej tyre. Në shtator 1895, pas disa kërcënimeve, i dogjën shtëpinë, bashkë me të edhe librat e tërë katandinë që kishte. Ky akt barbar e goditi rëndë ekonomikisht Babë Dudën, por nuk ia mpaku përkushtimin atdhetar. Në vitin 1898 ai ishte një nga nismëtarët e shoqërisë “Bashkimi” në Berat. Me nismën e kësaj dege po atë vit në lagjen “Goricë” u hap gjimnazi arumun me drejtor patriotin e shquar beratas Llambi Goxhomani (delegat në Kongresin e Lushnjës më 1920 dhe deputet në parlamentin e parë shqiptar më 1921). Për disa vjet pjesë e trupit mësimor të kësaj shkollë ishte edhe Babë Dudë Karbunara. Pas shpalljes së kushtetutës turke më 1908, me mbështetjen e patriotëve të tjerë beratas hapi dy shkolla shqipe, në njërin prej të cilave jepte mësim vetë së bashku me Sulo Resulin. Jorgji Karbunara ishte një ndër themeluesit e klubit “Bashkimi” të Beratit më 1908, në të cilin ai u zgjodh nënkryetar, dhe një nga organizatorët kryesorë të protestës së 28 shkurtit 1910 në qytetin e Beratit në mbrojtje të alfabetit latin. Në vitin 1910 u zgjodh anëtar i këshillit të prefekturës së Beratit dhe punoi për hapjen e shkollave shqipe në këtë prefekturë. Mori pjesë në lëvizjen kombëtare që u zhvillua në Berat gjatë kryengritjeve të viteve 1911–1912. Me nismën e tij në vitin 1911 u formua dega e Komitetit të Shqiptarëve, që vendosi lidhje me

komitetet që vepronin në qytetet dhe krahinat e tjera të Shqipërisë. Dha ndihmesë në thirrjen e Kuvendit të Sinjës më 23 korrik 1912, një nga ngjarjet e rëndësishme që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Beratit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “J. Karbunara”. Gjithashtu u zgjodh anëtar i Pleqësisë. Ndihej aktivisht në mbarëvajtjen e punëve dhe i kreu me përpikëri detyrat e ngarkuara. Bashkëpunoi ngushtë me ministrin e Arsimit Luigj Gurakuqi dhe mësuesin atdhetar Jani Minga. Ishte meritë e Babë Dudë Karbunarës dhe Sali Gjokës hapja e shkollave shqipe në fshatrat Paftal, Sinjë, Vërtop e Sadovicë të Beratit në vitin 1913. Por periudha pas Pavarësisë ishte shumë e vështirë për Babë Dudën. Mësuesi atdhetar në moshë të thyer pati përplasje me mercenarët e Esat pashë Toptanit, të cilët i shkatërruan pasurinë e më në fund e arrestuan dhe e torturuan. Më 17 dhjetor 1917, në moshën 75-vjeçare, Babë Dudë Karbunara i mbylli sytë përgjithmonë. Beratasit e përcollën me nderime për në banesën e fundit. Në vitin 1927 bashkia e Beratit i dha titullin “Nderi i Qytetit”, në vitin 1937 i ngriti një bust në sheshin e qytetit, në vitin 1962 u dekorua me Urdhrin “Për Shërbime të Shquara ndaj Atdheut” të Klasit të Parë dhe në 100-vjetorin e hapjes së shkollës së parë shqipe iu dha titulli “Mësues i Popullit”. Sot emrin e tij e mban një nga shkollat e mesme të përgjithshme të qytetit të Beratit. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

17. LEF NOSI (1873–1946)

Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, studiues. Lindi në qytetin e Elbasanit më 9 prill të vitit 1877 në një familje me tradita patriotike. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmen e përfundoi në Athinë, ku nisi dhe studimet e larta në degën e farmacisë. I ndërpreu ato pas dy vjetësh dhe u kthye në Elbasan. Punoi shumë si autodidakt për të zgjeruar kulturën dhe për të mësuar gjuhët e huaja. Falë përpjekjeve të vazhdueshme arriti të formohej si një nga më të



diturit e kohës. Formimi i thellë intelektual dhe atdhedashuria qenë shtysat e forta që ai të fitonte rolin e merituar të një protagonistit në ngjarjet e stuhishme që pararendën ngritjen e flamurit kombëtar më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Veprimtarinë politike dhe shoqërore e nisi në fillim të viteve të para të shek. XX. U



përfshi në lëvizjen për pavarësi nga Turqia dhe luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e arsimit shqip, që atëherë bëhej ilegalisht. I frymëzuar nga idetë e rilindësve, u bë një ndër veprimtarët e shquar të çështjes kombëtare në qytetin e Elbasanit. Në vitin 1908 përkrahu dhe propagandoi idetë e Kongresit të Manastirit. Në vitin 1909 u zgjodhe kryetar i klubit "Vllaznia" dhe po atë vit themeloi shoqërinë "Afërdita", që luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e arsimit dhe të ideve kombëtare. Ishte një nga figurat kryesore që kontribuan në organizimin dhe zhvillimin e punimeve të Kongresit Arsimor Kombëtar të Elbasanit në tetor të vitit 1909, në të cilin u vendos që më 1 dhjetor 1909 të hapet Shkolla Normale e Elbasanit. Më vonë ai u bë drejtor i kësaj shkolle. Nga 25 marsi i vitit 1910 botoi dhe drejtoi gazetën e parë të qytetit me titullin "Tomorri", ku kishte përkrah Aleksandër Xhuvanin, Luigj Gurakuqin, Simon Shuteriqin, Kristo Dakon. Në këtë gazetë botoi shkrime dhe artikuj të përkthyer nga shtypi evropian, ku pasqyroheshin problemet e kohës dhe interesat kombëtare shqiptare. Dy artikuj të përkthyer nga shtypi i Parisit u bënë shkak që në vitin 1910 xhonturqit ta arrestonin dhe ta dënonin me vdekje. Me ndërhyrjen e patriotëve, dënimi iu kthye në internim në Bursë (Turqi), prej nga lirohet pas ndërhyrjes së autoriteteve shqiptare. Në këtë gazetë, e cila është një provë e rëndësishme e kontributit të forcave intelektuale të kohës në shërbim të kombit shqiptar në fushën e dijes, arsimit e kulturës kombëtare. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i Elbasanit dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Lef Nosi". U zgjodh nënkryetar i Kuvendit Kombëtar. Në Qeverinë e Përkohshme ishte ministër i Postë-Telegrafës, detyrë që e ushtroi nga 5 dhjetori 1912 deri më 24 janar 1914, ku dha ndihmesën e tij për miradministrimin e këtij sektori të rëndësishëm. Në dhjetor 1918 u zgjodh delegat i Elbasanit në Kongresin e Durrësit (25–27 dhjetor 1918) dhe u përfshi në qeverinë prej 14 anëtarësh të dalë prej tij. Në vitet 1818–1919 ishte një nga drejtuesit e së përkohshmes "Kopështi letrar", që botohej në Elbasan. Anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën

e Paqes në Paris (1919–1920). Në ato vite Lef Nosi kishte letërkëmbim me mjaft personalitetet të shquara brenda e jashtë vendit, veçanërisht ne Norbert Joklin. Një kontribut të rëndësishëm dha në mbledhjen e dokumenteve historike, të objekteve antike e etnokulturore dhe një material të pasur gjuhësor. Falë punës së tij largpamëse për grumbullimin e dokumenteve historike e dorëshkrimeve të vjetra, që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror (rreth 12000 faqe), sot mund të ndriçohen shumë aspekte të historisë sonë. Mblodhi kënga nga cikli i kreshnikëve dhe këngë legjendare. La një fond të pasur me materiale etnofolkorike, që ruhen në arkivin e Institutit të Kulturës Popullore. Më 1924 botoi një seri broshurash me titull "Dokumente historike", ku përfshiu gjithë dokumentet e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe të shpalljes së Pavarësisë. Në vitin 1937, me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, ai botoi një fletëpalosje me Dokumentin e Pavarësisë të 28 nëntorit 1912, që mbetet dokumenti më autentik i kësaj ngjarjeje madhore. Në zgjedhjet e 1 tetorit 1943 u zgjodh deputet i Elbasanit dhe për disa ditë (18 tetor–25 tetor 1943) ishte kryetar i Kuvendit Kombëtar. Gjatë pushtimit gjerman u bë anëtar i Këshillit të Lartë të Regjencës (25 tetor 1943–25 tetor 1944), një organ kolegjal me kompetencat e kryetarit të shtetit (drejtimin e Komandës së Përgjithshme të Fuqive të Armatosura, emërimin e nëpunësve të lartë të shtetit, dekretimin e ligjeve, traktateve etj.), që zëvendësonte mbretin për sa kohë ai nuk ndodhej në Shqipëri. Edhe pse nuk u përfshi në veprimtari të drejtpërdrejtë represive në mbështetje të pushtueseve, pjesëmarrja në Regjencë u bë shkak që në vitin 1945 të arrestohej si kolaboracionist dhe të dënohej me vdekje. U pushkatua më 13 shkurt 1946. Më 17 dhjetor të vitit 2007 u dekorua nga Presidenti i Republikës me Urdhrin "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" me motivacionin: "Në shenjë vlerësimi të lartë si një ndër veprimtarët më të shquar të Lëvizjes Kombëtare, firmëtar i Aktit të shpalljes së Pavarësisë dhe një ndër krijuesit e shtetit shqiptar", ndërsa me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012. Gjithashtu mban titullin "Qytetar Nderi" i Elbasanit.

18. LUIGJ GURAKUQI (1879–1925)

Hartues dhe nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, diplomat, deputet, poet, publicist dhe gjuhëtar, Mësues i Popullit, Hero i Popullit, një njeri energjik dhe guximtar. Është një nga figurat kryesore të lëvizjes sonë atdhetare, arsimore e kulturore në fund të Rilindjes Kombëtare dhe në fillimet e Pavarësisë, që përjetoj ngjarjet më kulmore të jetës së vendit në çerekun e parë të shekullit tonë, në shumicën e të cilave, në mos organizator, qe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë.

Lindi në Shkodër më 19 shkurt 1879 në një familje të njohur tregtare. Me edukimin e tij u mor kryesisht i ati, Pjetër Gurakuqi. Mësimet e para i mori në Kolegjin Saverian, më pas vijoi arsimin e mesëm në kolegjin "Shën Adriani" në fshatin arbëresh Shënmitër-Koronë të Kalabrisë, një institucion i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit dhe kultivimin e vlerave shpirtërore, kulturore dhe etnike të arbëreshëve, ku pati mësues Jeronim de Radën, që do ta frymëzonte gjatë gjithë jetës. Në vitin 1901 nisi studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë në Napoli (Itali), por i ndërpreu ato pas tre vjetësh dhe vazhdoi në degën e shkencave të natyrës (biologji). Në Napoli njohu poetin, gjuhëtarin dhe publicistin e shquar arbëresh Zef Skiroi. Gjatë viteve të studimit, por dhe më pas, u mor me letërsi, kryesisht me prozën e shkurtër dhe poezi lirike. Në vitin 1906 botoi veprën "*Vargënimi n'gjuhë shqype me nji fjalorth shqyp-frangjisht n'marim*", ku bëri përpjekjen e parë për kodifikimin e metrikës shqipe. Po atë vit botoi në Bukuresht librin "*Abetar i vogël shqyp mas abeve t'Bashkimit e t'Stambollit me tregime n't'dy dhialektet*" dhe në Napoli "*Fjalorth shqyp-frangjisht e frangjisht-shqyp i fjalëve t'reja*". Pas vitit 1906 iu kushtua tërësisht veprimtarisë politike, kulturore dhe arsimore. Botoi mjaft artikuj në organet më të rëndësishme të shtypit shqiptar, herë me emrin e vet e herë me pseudonimet "Jakim Shkodra" e "Lekë Gruda". Botoi edhe librin "*Kndime t'para për msojtore filltare t'Shqypnisë*". Në verën e vitit 1907 bashkëpunoi më Bajo Topullin dhe komitetin e fshehtë të Manastirit për organizimin e kryengritjes kundërosmane. Mori pjesë në



Kongresin e Manastirit (14–22 nëntor 1908) si përfaqësues i Shkodrës dhe i arbëreshëve të Italisë. U zgjodh nënkryetar dhe anëtar i komisionit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në dhjetor 1909 u emërua drejtor i Normales së Elbasanit, ku dha kontributin e tij për vënien e arsimit mbi baza kombëtare. Ishte një nga udhëheqësit kryesorë të kryengritjes së Mbishkodrës në prill të vitit 1911. Së bashku me Ismail Qemalin hartoi Memorandumin e Greçës të qershorit 1911. Gjatë vitit 1912 zhvilloi një veprimtari të gjerë për organizimin e kryengritjes së përgjithshme. Në fund të shtatorit 1912 ishte në Stamboll bashkë me Ismail Qemalin, të cilin e shoqëroi në udhëtimin e tij historik në nëntor të atij viti për në Bukuresht, ku u takua me koloninë shqiptare të atjeshme, pastaj në Vjenë për të marrë mbështetjen e autoriteteve austro-hungareze dhe të diplomatëve të Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare, nga Vjena në Trieste, në Durrës e gjer në Vlorë. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i Shkodrës. Mendohet se Deklarata e Pavarësisë është formuluar nga Ismail Qemali dhe është shkruar nga Luigj Gurakuqi, të cilën ai e firmosi me siglën "Luz Gurakuqi". Kuvendi Kombëtar e zgjodhi ministër të Arsimit, ku dha një kontribut të rëndësishëm jo vetëm në organizimin e arsimit kombëtar, por në tërë veprimtarinë e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Mori pjesë në Konferencën e Londrës (1912–1913) së bashku me Ismail Qemalin e Isa Boletinin. Në qeverinë e Princ Vidit (1914) u ngarkua me detyrën e zëvendësministrit të Arsimit. Në janar 1915 së bashku me Aqif pashë Elbasanin u vendosën në Shkodër, ku vazhduan veprimtarinë kombëtare. Mori pjesë në organizimin e klubit "Lidhja Kombëtare". Me fillimin e Luftës së Parë Botërore Shkodra u pushtua nga ushtria malazeze dhe Luigj Gurakuqi u arrestua e u internua në Podgoricë. Në shtator 1916 ishte një nga themeluesit e *Komisisë Letrare Shqipe* në Shkodër. Në qeverinë e dalë nga Kongresi i Durrësit

(25–27 dhjetor 1918), ku mori pjesë si përfaqësues i Shkodrës dhe Mirditës, u emërua zëvendës i dr. Mihal Turtullit në Ministrinë e Arsimit. Ishte një nga anëtarët e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919–1920). Në vitet 1921–1924 ishte deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar, ku luftoi për demokratizimin e jetës së vendit. Bashkëpunoi ngushtë me Fan Nolin, Avni Rustemin e Bajram Currin. Si anëtar aktiv i shoqërisë “Bashkimi”, mori

pjesë gjallërisht në lëvizjen demokratike të qershorit 1924 dhe në qeverinë e kryesuar nga Fali Noli u zgjodh ministër i Financave. Pas ardhjes në pushtet të Ahmet Zogut në dhjetor 1924 mërgoi në Itali. U vra pabesisht në Bari më 2 mars 1925. Në nëntor 1957 eshtrat e tij u sollën në atdhe dhe u rivarrosën në Shkodër. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekret nr. 7574, datë 26.06.2012

19. MITHAT FRASHËRI (1880–1949)

Veprimtar politik, shkrimtar, publicist, albanolog, dhe përkthyes. Ka lindur në Janinë më 25 mars 1880. U arsimua në Stamboll. Ishte i biri i atdhetarit të shquar Abdyl Frashëri. Pas vdekjes së të atit (1892) për arsimitimin e tij u kujdesën Naim e Sami Frashëri. Nën ndikimin e tyre fitoi një kulturë të gjerë dhe mësoi disa gjuhë të huaja, çka i dha mundësi që pas mbarimit të studimeve, deri në vitin 1905, të shërbente në administratën turke e më pas në administratën shtetërore në Selanik. Nisi të aktivizohej në politikën shqiptare që në fund të shekullit XIX dhe ishte një nga figurat më të spikatura në gjysmën e parë të shekullit XX. Kishte korrespondencë me mjaft personalitete të kulturës shqiptare në diasporë. Shkroi disa artikuj në revistën “Albania” të Faik Konicës. Në vitin 1908 themeloi gazetën “Liria” në Selanik. Gjatë kësaj periudhe bashkëpunoi ngushtë me Kristo Luarasin, që drejtonte shtypshkronjën “Mbrothësia”, ku në vitet 1897–1928 botoi me disa ndërprerje revistën “Kalendari kombiar”. Në vitin 1909 themeloi revistën “Diturija”, që në fillim doli në Selanik, më 1916 në Konstancë dhe më 1926 në Tiranë. Me dokumentet dhe shkrimet që botuan për çështje të historisë, të folklorit, të gjuhës dhe traditave të popullit shqiptar, këto dy revista luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare e kulturore në vend. Në vitin 1908 mori pjesë në Kongresin e Manastirit (14–22 nëntor), ku u zgjodh kryetar i Kongresit dhe nënkryetar i komisionit për hartimin e alfabetit (kryetar u zgjodh Gjergj Fishta). Ishte një nga pjesëmarrësit me peshën më të madhe në Kongresin e Elbasanit (2–10 shtator 1909), ku



mori pjesë si delegat i Shkupit, Selanikut dhe Çamërisë. Dihet tashmë rëndësia historike e këtij Kongresi, që hodhi bazat e arsimit kombëtar shqiptar. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i Elbasanit dhe Ipekut (Pejë) dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë

me siglën “Mid’hat Frashëri”. Qeveria e Ismail Qemalit e zgjodhi ministër të Punëve Botore, ku dha ndihmesën e tij për organizimin e shtetit të ri shqiptar. Më 30 mars 1913 dha dorëheqjen nga kjo detyrë. Më 7 mars 1914 mirëpriti ardhjen e Princ Vidit në Shqipëri dhe mori pjesë në qeverinë e tij në detyrën e ministrit të Punëve Botore dhe Postë-Telegrafave. Pas shpërthimit të kryengritjes së Shqipërisë së Mesme më 17 maj 1914 kundër regjimit të Princ Vidit u largua nga Shqipëria e deri në vitin 1918 jetoi në Itali, Zvicër dhe Bullgari. Kthehet në Shqipëri dhe merr pjesë në qeverinë e dytë të Turhan pashë Përmetit (28 dhjetor 1918–28 janar 1920) si ministër pa portofol.

Qe anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919 si përfaqësues i federatës “Vatra”. Në vitin 1920 u vendos në SHBA. Përfaqësoi përsëri Shqipërinë në Konferencën e Paqes dhe në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë. U kthye në Shqipëri më 1922. Në janar 1923 mori detyrën e ministrit fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Athinë, ku zhvilloi një veprimtari të gjerë diplomatike në shërbim të çështjes kombëtare. Dha dorëheqjen nga kjo detyrë në dhjetor 1925 në shenjë

proteste kundër marrëveshjes që i dha Jugosllavisë Shën-Naumin. Në vitin 1926 çeli në Tiranë librarinë "Lumo Skëndo", që e mbajti deri në vitin 1939. Pas pushtimit të vendit nga Italia fashiste vendosi t'i kthehej përsëri aktivitetit politik. Në vitin 1941 ishte ideatori kryesor dhe një nga themeluesit e organizatës nacionaliste "Balli Kombëtar" dhe autor i programit politik të kësaj organizate, i njohur me emrin "Dekalogu". Mori pjesë në Konferencën e Mukjes në gusht 1943. Ishte kundërshtar i Partisë Komuniste. Në nëntor 1944 u largua nga Shqipëria. Në fillim u vendos në Itali e më pas në Paris, ku më 7 korrik 1949 së bashku me Hasan Dostin, Abas Kupin e Nuçi Kotën (djali i ish-kryeministrit Koço Kota) themeloi Komitetin Kombëtar "Shqipëria e Lirë"⁷ dhe u zgjodh kryetar i tij. Më 16 gusht 1949, i ftuar në një studio të radios "BBC" në Londër për të njoftuar krijimin e Komitetit "Shqipëria e Lirë", ai flet për të keqen që e kishte gjetur Shqipërinë nga komunistët. Gjatë jetës së tij Mithat Frashëri zhvilloi një veprimtari të gjerë letrare, kulturore e politike. Përveç punës në organet e shtypit që drejtoi, botoi një sërë artikujsh publicistikë e broshurash politike në shtypin europian, ku mbrojti të drejtat e shqiptarëve dhe integritetin territorial të Shqipërisë nga synimet e fqinjëve. Shkroi disa artikuj shkencorë për politikën, ekonominë,

historinë, udhëpërshkrime dhe ese. Botoi monografinë "*Naim be Frashëri*" (Sofje 1901, Tiranë 1923, 1941), që përbën një nga burimet kryesore të informacionit për jetën dhe veprimtarinë e poetit, "*Bëj mirë pa hidhe në det*" (1902), "*Dhe tregonjë*" (1902), "*Shkurtabiqi i verdhë*" (1914), "*Hi dhe shpuzë*" (1915), vepra letrare e tij më e njohur, ku shfaqen tiparet e një proze të mirëfilltë artistike, "*Letra mbi një udhëtim në Zvicër*" (1915), "*Një re e zezë për Shqipërinë*" (1918), "*Rilindja e Shqipërisë*" (1918), "*Mosmarrëveshjet shqiptaro-serbe*" (1921), "*Plagët tona*" (1924) etj. Në shkrimet e tij përdori pseudonimet "Lumo Skëndo" dhe "Mali Kokojka". Gjithashtu botoi disa vepra në frëngjisht. U mor edhe me përkthime nga letërsia botërore dhe me mbledhjen e fjalëve të urta të popullit tonë. Pas çlirimit të Shqipërisë me vendim të organeve ekzekutive u sekuestrua pasuria. Një nga objektet e sekuestruara ishte biblioteka personale e tij. Rreth 40 mijë libra të kësaj biblioteke janë pjesë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Vdiq në moshën 69-vjeçare më 3 tetor 1949 gjatë një udhëtimi për në Nju-Jork (SHBA) si pasojë e një ataku kardiak. Është dekoruar me Urdhrin "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" dhe me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë me Urdhrin "Nderi i Kombit".

20. MURAT TOPTANI

(1867–1918)

Lindi më 14 mars 1867 në Aka të Turqisë, ku ishte internuar i ati, Said Toptani, për veprimtarinë e tij atdhetare. Në vitin 1878 u regjistrua në shkollën "Madam Fyres" të Stambollit. Gjatë viteve të shkollës qëndroi në familjen e Naim Frashërit, meqenëse babai i tij ishte mik i familjes Frashëri. Vëllezërit Frashëri do të luanin një rol të rëndësishëm në edukimin e tij kulturor e patriotik. Më pas ai do të martohej me vajzën e Sherif Frashërit (vëllai i Abdylit, Samiut dhe Naimit).

Në vitin 1881 u kthye në Tiranë, ku pa nga afër përpjekjet e babait të tij dhe të atdhetarëve të tjerë për zbatimin e vendimeve të Lidhjes së Prizrenit. Në vitin 1884 shkoi përsëri në Stamboll, ku ndoqi studimet e larta. Nëpërmjet Naim



Frashërit ai u njoh me mjaft personalitete të shquara të kulturës e të lëvizjes kombëtare, mes të cilëve përmendim Shahin Kolonjën dhe Hasan Tahsinin. Me përfundimin e studimeve të larta, kur nuk ishte më shumë se njëzet e shtatë vjeç, Murat Toptani ishte njeri me formim kulturor të shkëlqyer jo vetëm

⁷ Një organizatë politike e mërgatës shqiptare në vendet perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore, që synonte organizimin e mërgatës dhe bashkëpunimin me fuqitë perëndimore për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri.

për kohën e tij, një nga intelektualët e brumosur më së miri, për të cilët Shqipëria kishte nevojë të jashtëzakonshme. Ai zotëronte mirë frëngjishten, gjermanishten, italishten, turqishten, arabishten e persishten. Më 1895 u vendos në Tiranë dhe iu përkushtua çështjes kombëtare. E gjejmë mësues të gjuhës shqipe gjithandej nëpër Shqipëri, si në Malësinë e Shkodrës, në Durrës, në Elbasan, në Pogradec e kudo që të ishte e nevojshme. Murat Toptani njihet si një ndër atdhetarët më të shquar që dhanë ndihmesë në futjen e gjuhës shqipe nëpër shkollat turke.

Nga fundi i vitit 1897 qeveria turke ndërmoi masa të rrepta ndëshkimore ndaj të gjithë atdhetarëve, veprimtarëve e intelektualëve shqiptarë që kishin shkaktuar e shkaktinin lëvizjet antiosmane në Kosovë. Mes tyre ishte edhe emri i Murat Toptanit, i cili u arrestua nga autoritetet osmane. Në vitin 1898 arriti të arratiset nga burgu dhe të shkonte në Brindizi. Këtu ai bashkëpunoi me gazetën "La nazione albanese", ku botoi shkrimin-kushtrim "Shqipëria e shqiptarëve" dhe poezi me tematikë atdhetare, si "Vllaznia", "Shpata e Skënderbeut" etj. Në të njëjtën kohë ai bashkëpunoi edhe me gazetën "Shqipëria" të Bukureshtit, ku botoi mjaft artikuj, mes të cilëve vlen të përmendet artikulli me titull "Shqipëria dhe shqiptarët", i cili pati jehonë të gjerë në rrethet intelektuale e atdhetare. Nga fundi i vitit 1898 ai udhëtoi në Napoli, Bari e Romë, ku organizoi disa takime me shqiptarët


që banonin në ato vende, me qëllim përhapjen e ideve kombëtare. Për disa kohë ndenji në Bruksel, ku bashkëpunoi me Faik Konicën, me të cilin shkoi më pas në Bukuresht.

Në nëntor të vitit 1912 shkoi në Durrës, ku priti Ismail Qemalin dhe delegatët e tjerë. Në Kuvendin e Vlorës mori pjesë si përfaqësues i Tiranës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Murad Toptani". U zgjodh anëtar i Pleqësisë. Më pas ndihmoi shumë në organizimin e administratës së shtetit të ri shqiptar. Duke qenë se ishte në konflikt të hapur e të papajtuashëm me kushëririn e tij Esad pashë Toptani, ky i fundit në vitin 1914 i dogji shtëpinë dhe një pjesë të madhe të pasurisë së tij, përfshirë edhe librat. I detyruar, emigroi në Vjenë.

Murat Toptani ishte një artist i shquar, piktor e skulptor. Busti i Skënderbeut që ai punoi në vitin 1899 në Napoli është një nga krijimet e para të skulpturës në artin tonë të Rilindjes. Ka bërë edhe disa vepra të tjera në skulpturë e pikturë dhe karikatura me temë patriotike. Në Galerinë e Arteve ruhet një bust i Skënderbeut i punuar në bronz në vitin 1917 dhe karikatura "Premtimet e Anglisë" (akuarel). Një pjesë e poezive të tij janë përmbledhur në librin "Vjershat e Murat Toptanit" (Tiranë, 1924). Vdiq në Tiranë më 20 shkurt 1918, një vit pasi u kthye në atdhe. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

21. MUSTAFA MERLIKA (KRUIJA) (1887–1958)

Veprimtar politik, studiues, protagonist i ngjarjeve më kulmore të Shqipërisë nga viti 1912 deri më 1944, një intelektual me profil të lartë dhe me formim solid kulturor. Lindi në Krujë më 15 mars 1887. Pasi mbaroi gjimnazin "Zosimea" të Janinës, u diplomua për shkenca politike-administrative në Shkollën Civile të Administratës Mbretërore "Mykije" në Stamboll, prej së cilës dilnin elitat e Perandorisë Osmane (1910). Gjatë viteve të studimeve shkroi disa artikuj në gazetën e Stambollit dhe të Kajros me pseudonimin "Asim Xhenan". Pas mbarimit të studimeve u emërua mësues matematike në



Durrës, ku u lidh dhe bashkëpunoi me dom Nikollë Kaçorin dhe Abdi Toptanin për organizimin e çetave kryengritëse. Ishte një nga organizatorët e kryengritjes antiosmane në malësitë e Krujës dhe të Mirditës më 1912. Shpallja e Pavarësisë e gjen në

Vlorë, në krah të Ismail Qemalit e Luigj Gurakuqit, në cilësinë e delegatit të popullit të Krujës. Mori pjesë në mbledhjet e Kuvendit Kombëtar dhe në shkroi deklaratën e Pavarësisë



me siglën “Mustafa Asim Kruja”. U zgjodh anëtar i Pletqesisë. Qeveria e Përkohshme e ngarkoi me detyrën e nënprefektit të Vlorës e më pas për disa muaj shërbeu si sekretar pranë Ismail Qemalit. Në vitin 1913 emërohet drejtor i arsimit në Elbasan. Më 1914 përkrahu Princ Vidin dhe u emërua këshilltar në Ministrinë e Arsimit. Kundërshtoi kryengritjen e Haxhi Qamilit në Shqipërinë e Mesme. Një vit më vonë u arrestua nga Esat pashë Toptani, pasi i doli kundër, dhe u burgos në Durrës, për të përfunduar në burgun e Barit (Itali), ku i dërgoi të gjithë të burgosurit e burgut të Durrësit ushtria austriake, që pushtoi Shqipërinë, e mandej në ishullin Favinjana të Sicilisë. U lirua më 1917 dhe u vendos në Romë, ku punoi si kryeredaktor i gazetës “Kuvendi”. Mori pjesë në Kongresin e Durrësit (dhjetor 1918) si delegat i Durrësit. Ministër i Postë-Telegrafës në qeverinë e Turhan pashë Përmetit të dalë nga Kongresi (dhjetor 1918–janar 1920), sekretar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris më 1919, deputet i Kosovës në zgjedhjet e para parlamentare më 1921, anëtar i federatës “Atdheu” të Avni Rustemit. Iu hoq

mandati i deputetit pas lëvizjes së marsit 1922. Gjatë muajve të qeverisë së Nolit ishte prefekt i Shkodrës. Pas kthimit në pushtet të Ahmet Zogut, në dhjetor 1924, u largua nga vendi. U vendos në Zarë të Dalmacisë (që në atë kohë i përkiste Italisë). Atje u mor edhe me studime gjuhësore. Në mars 1925 mori pjesë në themelimin e Komitetit Nacional Revolucionar (KONARE) në Vjenë, por nuk pajtohet me orientimin e majtë dhe krijon “Grupin e Zarës”. Në vitet 1937–1940 qëndroi në Gjenevë. U kthye në Tiranë dhe u mor me punë shkencore. Anëtar i Institutit të Studimeve Shqiptare dhe kryetar i Këshillit Shkencor të tij. Nga fundi i vitit 1941, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga Italia, pranon detyrën e kryeministrit. Dha dorëheqje në janar 1943. Në tetor 1944 u largua nga Shqipëria, fillimisht vendoset në Itali e prej andej shkon në Egjipt, ku u takua me Ahmet Zogun, kundërshtari i tij politik. Më pas disa vjet qëndroi në Francë, pastaj u largua në Amerikë, ku vdiq më 27 dhjetor 1958. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” me dekret të Presidentit të Republikës nr. 7574, datë 26.06.2012.

22. MYRTEZA ALI STRUGA (DIBRA) (1878–1937)

Dr. Myrteza Ali Struga, i njohur edhe si Myrteza Dibra, lindi në vitin 1878 në Strugë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Në vitin 1903 nisi studimet e larta për teologji në Stamboll dhe pas përfundimit të tyre vijoi studimet në Universitetin francez të Mjekësisë të Stambollit. Gjatë viteve të studimeve, bashkë me atdhetarë të tjerë, u aktivizua në klubin “Bashkimi” dhe shoqërinë “Burimi”, në programin e të cilave ishte jo vetëm arsimiti në gjuhën shqipe me alfabet latin, por dhe të bëheshin të gjitha përpjekjet për të siguruar autonominë e Shqipërisë. Pas diplomimit në Stamboll kthehet në vendlindjen e tij, në Strugë, ku përveçse ushtron profesionin e mjekut hap edhe një farmaci, në të cilën përgatiste barna për të sëmurët. Krahas punës si mjek ai nuk i reshti asnjëherë përpjekjet për përhapjen e gjuhës shqipe, sidomos të fëmijëve e familjeve të varfra. Në nëntor të vitit 1912 u zgjodh delegat i Ohrit dhe Strugës për në



Kuvendin Kombëtar të Vlorës, ku merr pjesë në të gjitha mbledhjet, që u zhvilluan nga data 28 nëntor deri më 7 dhjetor 1912. Nënshkroi Deklaratën e pavarësisë me siglën “Dr. H. Myrteza” (shkronja “H” nënkupton titullin “hafëz” që kishte marrë në Stamboll pas mbarimit të shkollës teologjike). Si patriot i orëve të para, e priti me urrejtje pushtimin e Ohrit dhe të Strugës nga ushtria serbe në fund të nëntorit të vitit 1912. Ai rreshtohet përkrah çetave atdhetare që krijohen si reagim ndaj pushtimit dhe nuk e kursen mbështetjen financiare të tyre gjatë viteve 1912–1916, gjë për të cilën autoritetet serbe e internuan për një vit. Në vitin 1920 mori pjesë në Kongresin e Lushnjës, përsëri si delegat i Ohrit dhe Strugës. Në fund të vitit 1930 transferohet nga Struga në Peshkopi dhe emërohet drejtor i

spitalit të këtij qyteti. Në vitin 1934 e transferojnë në disa qytete të tjera, fillimisht e dërgojnë të punojë në Kavajë, më pas në Lushnjë, Elbasan, Lezhë e në vitin 1935 në Tiranë. Në dhjetor të vitit 1937, vetëm një muaj pas 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, vdiq nga një sëmundje e rëndë. Pas çlirimit të Shqipërisë, për veprimtari

në shërbim të çështjes shqiptare, Kuvendi Popullor i dha titullin “Patriot”, ndërsa gruas së tij iu akordua pensioni patriotik për të shoqin. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” me dekret të Presidentit të Republikës nr. 7574, datë 26.06.2012.

23. NEBI SEFA (1861–1942)

Lindi në Lushnjë në vitin 1861 në një familje me tradita kombëtare. Mësimet e para i mori në Lushnjë dhe Berat. Në mënyrë autodidakte mësoi persishten, turqishten dhe frëngjishten. Babai i tij, Ismail bej Sefa, përveçse pronar tokash, merrej edhe me tregti në Rumani, Sofje, Selanik e Janinë, ku ra në kontakt me mjaft atdhetarë, me të cilët bashkëpunoi për çështjen kombëtare. Përpjekjet e të atit për të futur librat shqip në atdhe me qëllim mësimin e gjuhës amtare ndikuan dukshëm te Nebiu, i cili do ta kishte gjuhën shqipe një prioritet gjatë veprimtarisë patriotike. Gjatë udhëtimeve që bënte me të atin në Sofje e Rumani u njoh me atdhetarë të kolonive shqiptare të atjeshme dhe shpejt u bë një prej përhapësve të shquar të ideve të Rilindjes Kombëtare në Lushnjë dhe rrethinat e saj. Në vitin 1908 mbështeti Kongresin e Manastirit dhe propagandoi vendimet e tij për lëvizjen kombëtare dhe shkrimin e gjuhës shqipe me alfabetin latin. Një vit më vonë ai ishte i ftuar në ceremoninë e hapjes së Normales së Elbasanit (1 dhjetor 1909), e cila u bë themeli i arsimit shqip. Vitet 1911–1912 shënojnë kulmin në veprimtarinë patriotike të Nebi Sefës. Ai përfshihet në kryengritjet kundër administratës osmane të këtyre viteve, organizon takimeve me grupe patriotësh lushnjarë në përkrahje të Memorandumit të Greçës si dhe nënshkruan një sërë peticionesh në përkrahje të autonomisë së Shqipërisë. Në nëntor 1912 ai priti në Kavajë Ismail Qemalin dhe delegatët që udhëtonin drejt Vlorës dhe falë njohjeve që kishte në xhandarmërinë e Lushnjës bëri të mundur shmangien e kurtheve të administratës osmane, që kishte urdhëruar arrestimin e Ismail Qemalit. Në Kuvendin e Vlorës ai u zgjodh delegat i Lushnjës



së bashku me Qemal Mullain dhe Ferid Vokopolën dhe më 28 nëntor nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Nebi Sefa Lushja”. Qeveria e Përkohshme e Vlorës e ngarkoi me detyrën e organizimit të ushtrisë në zonën e Lushnjës, Fierit dhe Mallakastrës.

Ngjarjet e trazuara të vitit 1913 e gjejnë patriotin Nebi Sefa në krye të mbrojtjes së qytetit të Lushnjës nga sulmet e forcave të udhëhequra nga Esat pashë Toptani, të cilat synonin rrëzimin e qeverisë së Vlorës. Mbrojtja e pavarësisë së vendit mbeti qëllimi kryesor i jetës së tij edhe në vitet e Luftës Ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore. Shumë shpejt ai u shndërrua në figurën më me autoritet në tërë krahinën e Myzeqesë. Për shkak të aktivitetit të tij patriotik në mbështetje të pavarësisë së vendit, në vitin 1914 forcat rebele të Haxhi Qamilit i dogjën shtëpinë, një pjesë të pronave dhe e dënuan me vdekje. Kongresi i Lushnjës mbetet një tjetër ngjarje e shënuar në jetën e Nebi Sefës. Ai drejtoi komisionin nismëtar për mbajtjen e tij. Gjatë zhvillimit të Kongresit u kujdes për mbarëvajtjen e punimeve të tij dhe për strehimin e delegatëve. Mund të thuhet se të gjitha shpenzimet e mbajtjes së Kongresit u përballuan nga financat private të këtij patrioti. Pas kësaj ngjarjeje ai u tërhoq në jetën private dhe u mor me bizneset e familjes. Në vitin 1924 përkrahu lëvizjen demokratike dhe qeverinë e Fan Nolit. Vdiq në vitin 1942 në qytetin e Lushnjës. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” me dekret të Presidentit të Republikës nr. 7574, datë 26.06.2012.



24. NURI SOJLIU (BAKALLI) (1870-1940)

Veprimtar i lëvizjeve për çlirim kombëtar. Lindi në Strugë rreth vitit 1872 në një familje të njohur për traditat patriotike. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas kreu shkollën e mesme për financë në Stamboll. Shumë shpejt hyri në lidhje me rrethet patriotike të shqiptarëve të atjeshëm, nga të cilët ushqehet me ndjenja atdhetare. Pas përfundimit të shkollës u kthye në vendlindje dhe në vitin 1905 u punësua në administratën turke të Shkupit, ndërsa në vitin 1908 në Starovë. Në ato vite shtëpia e babait të tij, Murat Bakalli (Sojliu), ishte qendra e lëvizjes për çlirim kombëtar dhe Nuri ishte shumë aktiv në përhapjen e ideve patriotike. Ai kishte lidhje me klubin e Manastirit, të Shkupit dhe Bukureshtit, prej nga merrte libra në gjuhën shqipe. Veprimtaria e tij kombëtare ra në sy të autoriteteve osmane dhe u pushua nga puna. U ngarkua me detyrën e arkëtarit dhe të sekretarit të shoqërisë "Bashkimi" (kryetar u zgjodh i ati, Murat Sojliu), që u krijua në Strugë pak vjet më vonë me nismën e vëllait të tij Ibrahim Sojliu, i njohur gjerësisht si Ibrahim Temo. Ai zhvilloi një veprimtari të gjerë në mbështetje të kandidaturës së Dervish Himës për deputet në parlamentin turk. Me përpjekjet e tij shoqëria "Bashkimi" hapi shkollën shqipe në Strugë. Mbështeti Kongresin e Manastirit dhe alfabetin latin të gjuhës shqipe, mësimi i së cilës ishte një çështje e rëndësishme për të gjithë patriotët



shqiptarë. Ishte i ftuar në Kongresin e Elbasanit (1909), ndërsa vëllai i tij, Abdullah Efendiu, ka qenë delegat i Strugës në këtë Kongres. Me hapjen e Normales së Elbasanit, ai u bë nismëtar për dërgimin e nxënësve të Strugës në këtë shkollë. Në

nëntor 1912 u zgjodh delegat i Strugës për në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, ku mori pjesë në të gjitha mbledhjet. Nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Nuri". Mirëpriti Princ Vidin dhe mbështeti qeverinë e tij me shpresën se kishte ardhur koha të merrnin fund masakrat e serbëve ndaj shqiptarëve. Thuhet se pas letrës që ai i dërgon vëllait të tij, dr. Ibrahim Temo, në Rumani, ky i fundit në maj 1914 mbërrin në Durrës dhe qëndron pranë Princ Vedit deri në shtator. Mbështeti lëvizjet politike me frymë demokratike të viteve 1920. Në vitin 1924, në krye të një përfaqësie të Strugës, mbërrin në Tiranë dhe takohet me Fan Nolin dhe Luigj Gurakuqin. Në vitin 1937 ishte i ftuar në ceremoninë përkujtimore të 25-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së bashku me vëllain e tij, dr. Ibrahim Temon. Vdiq në Strugë në vitin 1947. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" me dekret të Presidentit të Republikës nr. 7574, datë 26.06.2012.

25. PANDELI CALE (1879-1923)

Veprimtar i Rilindjes Kombëtare dhe i periudhës së Pavarësisë. Lindi më 28 mars 1874 në Korçë, ku mori mësimet e para. Studimet e larta i ndoqi në liceun francez të Aleksandrisë në Egjipt. Atje u përfshi në veprimtarinë patriotike të kolonisë shqiptare. Pasi përfundoi studimet u kthye në vendlindje dhe u përfshi në lëvizjen kombëtare. Në vitin 1900 shkon në Bukuresht, ku u aktivizohet në veprimtarinë patriotike të kolonisë shqiptare të atjeshme. Më 1904 kthehet në Shqipëri dhe angazhohet përkrah patriotëve të shumtë korçarë. U shqua në organizimin e



klubeve dhe shoqërive atdhetare, si dhe bëri përpjekje për çeljen e shkollave shqipe. Me nismën e tij në tetor 1908 u krijua shoqëria "Banda e Lirisë", që e zgjodhi kryetar të saj. Kjo shoqëri pati bandën e saj muzikore, ku bënin pjesë shumë të rinj të pasionuar. Po atë vit ai


mori pjesë në komitetin me emrin "Shoqëri e Zezë për Shpëtim", që u krijua me iniciativën e Themistokli Gërmenjit. Ndonëse në pamje të

parë dukej si një shoqëri rebele, në programin e saj ajo kishte çlirimin e popullit shqiptar nga sundimi shumëshekullor osman përmes luftës së armatosur. Një vit më vonë, në shkurt të vitit 1909, Pandeli Cale mori pjesë në krijimin e shoqërisë "Lidhje Orthodoksish ndë Korçë" dhe zgjidhet sekretar i saj. Ishte një nga propaganduesit dhe organizatorët e kryengritjes së përgjithshme në vitet 1911–1912, gjatë së cilës drejtoi çetat e zonës së Korçës. Më 5 nëntor 1912 mori pjesë në mbledhjen që Ismail Qemali organizoi me koloninë shqiptare të Bukureshtit dhe iu bashkua grupit që e shoqëroi atë për në Shqipëri e më pas deri në Vlorë. Më 28 nëntor 1912 Sali Gjuka propozoi të quheshin delegatë të Korçës Pandeli Cale, Thanas Floqi dhe Spiro Iloja, gjë që u pranua. Firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Pandeli Cale". Qeveria e Vlorës e zgjodhi ministër të Bujqësisë, Industrisë dhe Tregtisë, ku dha kontributin e tij në ngritjen e administratës në këtë institucion. Iu bashkua grupit të Ismail Qemalit, Isa Boletinit, Luigj Gurakuqit e Mehmet Konicës në misionin diplomatik pranë kancelarive evropiane për njohjen e shtetit të ri shqiptar. Me këtë mision në fillim të prillit 1913 shkoi në Zvicër. Pas këtij shërbimi diplomatik ai u kthye në atdhe dhe përsëri së bashku me mikun e tij Mihal Grameno, në zbatim të detyrave të kreu detyra në të mirë të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Në vitet e Luftës së Parë Botërore emigroi në Zvicër, Ukrainë, Bullgari dhe Francë, ku vazhdoi përpjekjet për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë. Për pak kohë u internua nga qeveria rumune,

bashkë me Pandeli Evangjelin, më vonë kaloi në një burg të Bukureshtit. Pasi u lirua shkoi me mision diplomatik në Paris. Që andej u hodh në Zvicër, ku bashkë me disa shqiptarë të tjerë boton një gazetë në frëngjisht për çështjen shqiptare. Më 1919 u kthye në atdhe. Mori pjesë në lëvizjen që çoi në organizimin e Kongresit të Lushnjës në janar 1920. Në vitin 1920 ishte prefekt i Korçës. Ishte një nga hartuesit dhe firmëtarët e protokollit shqiptaro-grek, një marrëveshje për mënjanimin e një lufte të armatosur midis Shqipërisë dhe Greqisë, që u nënshkrua më 28 maj 1920 në fshatin kufitar Kapshticë në kushtet kur qeveria greke me pëlqimin e qeverisë së Parisit kishte bërë gati në kufi ushtrinë e saj për t'i zënë vendin ushtrisë franceze që po largohej nga Korça. Një vit më vonë, në shkurt 1921, Pandeli Cale u zgjodh deputet i parlamentit të parë shqiptar. Pas pak kohësh qeveria shqiptare e dërgoi përfaqësues të saj pranë Lidhjes së Kombeve. Vdiq i sëmurë në një spital të Selanikut, ku po mjekohej, më 5 gusht 1923. Eshtrat e tij u kthyen në atdhe në vitin 1926. Në vitin 1962, me rastin e 50-vjetorit të Pavarësisë, Pandeli Cale u dekorua me Urdhrin "Për Veprimtari Patriotike" të Klasit të Dytë, në vitin 1992, me rastin e 80-vjetorit të Pavarësisë, u dekorua me Urdhrin "Për Veprimtari Patriotike" të Klasit të Parë, ndërsa në vitin 2012, në 100-vjetorin e Pavarësisë, u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekret nr. 7574, datë 26.06.2012, së bashku me firmëtarët e tjerë të Deklaratës së Pavarësisë. Një shkollë 9-vjeçare dhe një rrugë në qytetin e Korçës mbajnë sot emrin e Pandeli Cales.

26. QAZIM KOKOSHI (1882–1945)

Lindi në Vlorë më 12 shtator të vitit 1882. Mësimet e para i mori në shkollën turke të qytetit dhe më pas shkoi në Janinë, ku mbaroi gjimnazin "Zosimea". Rreth fillimit të viteve 1900 u kthye në vendlindje dhe iu vu punës për përhapjen dhe mësimin e gjuhës shqipe në krahinat e Vlorës dhe të Mallakastrës. Në vitin 1908 ishte një ndër themeluesit e klubit patriotik "Labëria". Në shtator të këtij viti ai priti Ismail Qemalin dhe e shoqëroi atë në takimet me popullin e



Mesaplikut e të Dukatit, duke u bërë kështu një nga bashkëpunëtorët e ngushtë dhe mbështetësit e tij kryesorë në rrugën e vështirë të shpalljes së pavarësisë kombëtare. Autoritetet turke e përndoqën dhe deshën ta arrestonin për shkak të veprimtarisë së tij atdhetare, kështu që ai u detyrua të arratisë, fillimisht në




Korfuz e mandej në Itali. Më 28 nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin e Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë si delegat i qytetit të Vlorës. Në gusht të vitit 1913 Qeveria e Përkohshme e Vlorës e ngarkoi me detyrën e nënprefektit të Lushnjës, detyrë të cilën e kryen me përkushtim. Pasi punoi afro shtatë muaj në atë detyrë, në shkurt 1914 u emërua me detyrën e kryesekretarit të prefekturës së Vlorës. Në korrik të vitit 1914 Qazim Kokoshi ishte një nga organizatorët e Kuvendit të Vlorës, që kishte si qëllim krijimin e Komitetit të Shpëtimit Publik. Pas rënies së Qeverisë së Vlorës, u caktua anëtar i delegacionit që do të takohej me Princ Vidin. Më 1918–1920 së bashku me atdhetarë të tjerë vlonjatë nënshkroi memorandumet kundër pushtimit të vendit prej Italisë. Shtëpia e tij u shndërrua në bazën ku bëheshin mbledhjet e komitetit “Mbrojtja Kombëtare”. Ai ishte një ndër organizatorët kryesorë të Kuvendit të Barçallasë më 29 maj të vitit 1920, cili vendosi fillimin e luftës kundër pushtuesve italianë. Konkuroi në zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në vitin 1921 ku dhe u zgjodh deputet i Parlamentit të

parë shqiptar. Pas tre vjetësh, në Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924, u bashkua me grupin opozitar që udhëhiqej nga Fan Noli e Luigj Gurakuqi. Pas rënies së qeverisë së Nolit emigroi në Itali e më pas në Austri. Më 1928 u kthye në atdhe pas amnistisë së mbretit, por në vitin 1932 u arrestua për pjesëmarrje në të ashtuquajturën “Lëvizja e Vlorës” bashkë me Hasan Dostin, Skënder Muçon etj. dhe u burgos, për të dalë sërish më 1936. Pas vrasjes së dhëndrit të tij, dëshmorit Reshit Çollaku, Qazim Kokoshi u arrestua nga GESTAPO-ja dhe u internua në Bergamo (Itali). Kur kthehet në Vlorë më 1945, ai zhgënjehet nga realiteti i zyrtë politik dhe jo vetëm që nuk pranon të bëhet palë me komunistët, por i akuzon haptazi për masakrat që kishin bërë. Në prill të vitit 1946 e arrestojnë dhe dy vjet më vonë, më 1947, pas një jete të tërë përkushtimi e sakrificash të pandalshme në shërbim të kombit, Qazim Kokoshi vdiq në burg nga torturat. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

27. QEMAL KARAOSMANI (ELBASANI) (1875–1949)

Lindi në Elbasan në maj të vitit 1875 në familjen e njohur të Karaosmanëve. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, shkollën e mesme dhe studimet e larta i përfundoi në Stamboll për shkencat politike dhe administratë civile. Në Stamboll u njoh me mjaft atdhetarë të njohur të kohës dhe u përfshi në Lëvizjen Kombëtare. Pas përfundimit të studimeve u emërua me punë në prefekturën e Janinës, por nuk qëndroi shumë gjatë, pasi u transferua në qytetin e Beratit, ku u emërua drejtor i kadastrës. Në Berat bashkëpunoi ngushtë me Babë Dudë Karbunarën, Aziz pashë Vrionin dhe Iliaz Vrionin për përhapjen e ndjenjave kombëtare dhe të gjuhës shqipe. Ishte delegat në Kongresin e Manastirit (14–22 nëntor 1908) dhe mbrojti alfabetin e gjuhës shqipe. Një ndikim të madh në jetën e tij luajti patrioti Aqif pashë Elbasani (kushëriri i tij), me të cilin bashkëpunoi në organizimin e Kongresit të Elbasanit në vitin 1909 dhe për çeljen e Shkollës Normale në këtë qytet.



Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Elbasanit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Qemal Elbasani”. Kuvendi Kombëtar e ngarkoi me detyrën e kryesekretarit të Qeverisë së Përkohshme dhe në fund të nëntorit të vitit 1913 u emërua ministër i Bujqësisë. Mbështeti qeverinë e Sulejman Delvinës të dalë nga Kongresi i Lushnjës (1920) dhe për disa vjet ishte deputet në Këshillin Kombëtar dhe Kuvendin Kushtetues. Ai u zgjodh deputet i Beratit në zgjedhjet e 27 dhjetorit të vitit 1923 dhe në zgjedhjet e 17 majit 1925. Gjithashtu ishte anëtarë i Dhomës së Deputetëve si përfaqësues i prefekturës së Beratit, pasi zëvendësoi në fund të vitit 1925 deputetin e dorëhequr Qemal Vrioni.

Pas pushtimit fashist të Shqipërisë u tërhoq nga jeta politike. Rrethanat e krijuara pas çlirimit


të vendit e vendosën në Kavajë, ku jetoi deri në fund të jetës së tij. Vdiq në vjeshtën e vitit 1949. Gjatë periudhën së regjimit komunist figura e Qemal Karaosmanit u la në harresë. Në vitin 1962, në prag të 50-vjetorit të Pavarësisë, familja Karaosmani i dorëzoi Arkivit të Shtetit dokumentet dhe penën me të cilën u nënshkrua

Deklarata e Pavarësisë më 28 nëntor 1912, të cilën e patën ruajtur në shtëpinë e tyre. Në nëntor 2008 Bashkia e Elbasanit i dha titullin "Qytetar Nderi". Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekret nr. 7574.

28. QEMAL MULLAI

(1881–1966)

Lindi në qytetin e Beratit në vitin 1881. Mësimet e para i mori në vendlindje, studimet e larta i përfundoi në Stamboll në degën astronomi-gjeografi. Në vitin 1909 u kthye në atdhe dhe u vendos në fshatin Bubullimë të Lushnjës, ku kishte pronat e tij. Përshëndeti Kongresin e Elbasanit dhe vendimet e tij. Në vitet 1910–1912 së bashku me Ferid dhe Emin Vokopolën, Nebi Sefën e Qemal Karaosmanin propaganduan idetë përparimtare të kohës për gjallërimin e ndjenjave kombëtare në këtë trevë. Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Lushnjës në Kongresin Kombëtar të Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Qem. Mullaj". Në shtator 1913 mori pjesë në protestat që u organizuan në qytetin e Vlorës kundër shovinistëve grekë dhe serbë, që dogjën dhe shkatërruan viset shqiptare. Në vitet 1914–1915 doli kundër politikës së Esat Toptanit dhe për këtë shkak emigroi në Itali. U kthye më 1916. Në vitet e zisë së bukës (1918–1919) u shpërndau fshatarëve drithë falas. Ishte një ndër atdhetarët më aktivë për



organizimin e Kongresit të Lushnjës në janar 1920 dhe doli hapur kundër qeverisë së Durrësit, e cila bëri të gjitha përpjekjet për të penguar zhvillimin e tij. Deputet në parlamentin e parë shqiptar (21 prill 1921–30 shtator 1923). Mori pjesë në varrimin e Avni Rustemit në

Vlorë më 1 maj 1924 dhe mbështeti forcat kryengritëse një muaj më pas. Pas rrëzimit të qeverisë së Nolit emigroi në Itali. Në vitet e Luftës së dytë Botërore zhvilloi një veprimtari të gjerë kundër nazifashizmit. Deri në vitin 1952 jetoi në Bubullimë, vitet e fundit të jetës i kaloi në Tiranë, i pashqetësuar nga regjimi i kohës. Vdiq në vitin 1966. Në 75-vjetorin e Kongresit të Lushnjës u dekorua me Udhrrin "Për Veprimtari Patriotike të Klasit të Parë". Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

29. REXHEP MITROVICA

(1888–1960)

Veprimtar i lëvizjes kombëtare për pavarësi, nëpunës, ministër dhe kryeministër i Shqipërisë. Lindi më 18 janar 1888 në Mitrovicë. Mësimet e para i mori në gjuhën turke në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në gjimnazin e Shkupit. Nisi studimet e larta në Paris, por i ndërpreu pas dy vjetësh për shkak të vdekjes së të atit. Emërohet drejtor i shkollës industriale të Shkupit. Në vitin 1908 së bashku me Bedri Pejani dhe Sali Gjukën ndërmoren një fushatë propagandistike në



mbështetje të Kongresit të Manastirit, të cilin e shihte jo thjesht si një tubim gjuhëtarësh, por si një akt shumë të rëndësishëm në përpjekjet për forcimin e unitetit mes shqiptarëve dhe rritjen e vetëdijes së tyre kombëtare. Mori pjesë në tubimet e organizuara në mbrojtje të gjuhës shqipe dhe të idesë së përdorimit të



alfabetit latin. Në prill të vitit 1910 mori pjesë në Kongresin e Dytë të Manastirit. Shkroi disa artikuj në shtypin e kohës në mbështetje të kryengritjeve kundërosmane të viteve 1911–1912 në Kosovë e në vise të tjera shqiptare, bashkëpunoi me Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Bedri Pejanin dhe Mehmet pashë Dërrallën për gjallërimin e lëvizjes për çlirim kombëtar. Në tetor 1912 mori pjesë në kuvendin e Shkupit, që e zgjodhi delegat të Gjakovës, Pejës e Gucisë për në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Rexhep”. Pas shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dha ndihmesën e tij në organizimin e shtetit shqiptar. Më 7 mars 1914 mori pjesë në pritjen që iu bë Princ Vidit në Durrës. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore u largua në Austri. Në vitin 1916 u vendos në Vjenë, ku për katër vjet ndoqi studimet e larta në shkencat pedagogjike. Pas përfundimit të studimeve u kthye në Shqipëri. Në vitet 1920–1924 ishte deputet i Kosovës në parlamentin shqiptar. Në periudhën 24 dhjetor 1921–25 shkurt 1924 ishte ministër i Arsimit dhe dha një kontribut të vyer për zhvillimin e tij. Përkrahu organizimin e Kongresit të Arsimtarëve të Tiranës (22 korrik–3 gusht 1922), të cilin e përshëndeti si ministër i Arsimit. Duke njohur vendimet e Kongresit Arsimor të Lushnjës (gusht 1920) për sistemin arsimor, filloi menjëherë punën për kombëtarizimin dhe demokratizimin e sistemit arsimor shqiptar, për ngritjen e nivelit profesional të shkollës, unifikimin e programeve mësimore dhe hartimin e teksteve shkollore. Me propozimin e tij u miratuan disa projektligje për

sanksionimin e drejtimeve kryesore të arsimit në shtetin e ri shqiptar. Gjithashtu ai hodhi idenë e hapjes së një biblioteke kombëtare në Tiranë, ndikoi në hapjen e Shkollës Teknike Shqiptaro-Amerikane në prill të vitit 1922 dhe bashkëpunoi ngushtë me drejtuesit e kësaj shkolle (Harri Fulc e Çarls Holingshed). Me përkrahjen e tij u themeluan organizatat profesionale të mësuesve të Shqipërisë, si: *Lidhja e Mësuesve të Prefekturës së Durrësit* (8 janar 1922), *Lidhja e Mësuesve të Prefekturës së Shkodrës* (18 qershor 1922), *Lidhja Shoqërore e Arsimtarëve të Korçës* (23 mars 1923) etj., që çuan në krijimin në Tiranë të *Lidhjes së Përgjithshme të Arsimtarëve të Shqipërisë* (gusht 1924) dhe botimin e revistës “Arsimtari”. Përkrahu Revolucionin Demokratik të qershorit 1924. Pas rënies së qeverisë së Fan Nolit u kthye në Mitrovicë. Në vitet 1925–1939 veprroi në Kosovë e mandej në emigracion. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte anëtar i Këshillit të Shtetit Shqiptar (1941–1942) dhe komandant i forcave vullnetare shqiptare në Kosovë (1942–1943). Për veprimtarinë e tij antifashiste u arrestua nga pushtuesit italianë dhe u burgos në Porto-Romano (Durrës), prej nga lirohet më 1943. Në Lidhjen e Dytë të Prizrenit, që u mbajt më 16 shtator 1943, u zgjodh kryetar i saj. Më 5 nëntor 1943 Këshilli i Lartë i Regjencës e emëroi kryeministër dhe ministër të Kulturës Popullore në qeverinë që gjermanët ngritën në Tiranë. Në korrik 1944 ai jep dorëheqjen nga këto detyra dhe kthehet në Kosovë. Më pas emigroi në Turqi. Vdiq në moshën 80-vjeçare në Stamboll më 21 maj 1967. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

30. SALI GJUKA (1876–1925)

Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, publicist, Mësues i Popullit. Është i njohur edhe me pseudonimin “Gjukë (Xhukë) Dukagjini”. Lindi në Pejë më 11 prill 1876. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmet në Shkup, ku ishte vendosur familja për shkak të përndjekjeve nga autoritetet osmane. Më pas kreu studimet e larta për drejtësi në Selanik dhe u specializua më



tej për gjuhësi në Stamboll dhe Paris. Pas mbarimit të studimeve nisi punën në gjykatën e Selanikut.

Në vitet e para të punës si mësues dhe inspektor arsimit në Manastir e Shkup (1905–1908) u bë një ndër veprimtarët më

aktivë të klubeve patriotike shqiptare “Bashkimi” të këtyre qyteteve. Më pas kryesoi shoqërinë patriotike “Lahut’ e Malësisë” dhe bashkëpunoi ngushtë me patriotin Fehim Zavalani për botimin e gazetës “*Bashkim i kombit*” (1909–1910). Në vitin 1909 punoi pa u lodhur për çeljen e shkollës shqipe në Pejë, ndërsa në vitin 1910, me përkrahjen e Bajram Currit e Hasan Prishtinës etj. u bë mësuesi i parë i shqipes në shkollën normale dhe gjimnazin e Shkupit. Ishte një nga organizatorët e Kongresit të Dytë të Manastirit (1910) dhe të çetës së studentëve shqiptarë të Selanikut, e njohur si “Çeta e Selanikut” (1911–1912). Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Pejës, Gjakovës, Plavës dhe Gucisë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Salih Gjuka”. U zgjodh anëtar i Pleqësisë. Gjatë kohës së qëndrimit në Vlorë ishte ndihmës i Luigj Gurakuqit për problemet e arsimit, çka e dëshmojnë edhe artikujt e botuar në gazetën “Përlindja e Shqipniës”. Në vitin 1913 Qeveria e Përkohshme e emëroi drejtor të arsimit në qarkun e Beratit, ku çeli mjaft shkolla në gjuhën shqipe. Qeveria e Durrësit (1919) e emëroi inspektor të arsimit në qarkun e Dibrës. Megjithëse shërbeu në arsim,

nuk u shkëput asnjëherë nga ngjarjet politike e shoqërore të kohës. Ishte ndër organizatorët e Kongresit të Lushnjës (1920). Në vijim të përndjekjeve të mëparshme, në vitin 1920 e akuzuan për pjesëmarrje në vrasjen e Abdyl Ypit (figurë politike e kohës) dhe e dënuan me 10 vjet burg. Në vitin 1924 fitoi pafajësinë dhe e liruan nga burgu. Punoi për pak kohë drejtor i shkollës plotore të Beratit. Me ardhjen në pushtet të Fan Nolit në qershor 1924, Bajram Curri e propozoi për ministër të Arsimit, detyrë të cilën nuk e ushtroi për shkak të rënies së qeverisë së Nolit. U njoh edhe si gjuhëtar, publicist dhe etnograf. Në vitin 1910 botoi në Manastir monografinë “*Shkrolaria e shqipes*”, ribotuar në Kosovë më 1991, dhe “*Gramatikë turqisht-shqip*”. Si bashkëpunëtor me Sali Nivicën e Muço Qullin në botimin e gazetës “Populli” në Shkodër (1915–1919), trajtoi tema patriotike, sociale e arsimore, shpesh me tone polemizuese. Vdiq i sëmurë nga tuberkulozi më 25 tetor 1925 në Berat. Është dekoruar me Urdhrin e Flamurit. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

31. SPIRIDON ILO (1876–1950)

Vepërtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në qytetin e Korçës më 30 shtator 1876. Pasi përfundoi gjimnazin grek në qytetin e lindjes, emigroi në Bukuresht (Rumani), qytet ku shqiptarët e vendosur atje kishin ngritur shoqëritë më të forta patriotike në mërgim. Në vitin 1905 shkoi në Amerikë, ku u përfshi në qarqet politike e patriotike të kolonisë së korçarëve emigrantë në Boston dhe mbështeti financiarisht botimet në gjuhën shqipe. Më 1 janar 1906 ishte ndër themeluesit e shoqërisë patriotike “Malli i Mëmëdheut” e më pas të shoqërisë “Besa-Besë”. Më 1907 bashkë me patriotët Sotir Peci e Kristo Kirka ishte pjesë e delegacionit të shqiptarëve të Bostonit në ceremoninë e shukurimit prift të Fan Nolit në Nju-Jork, çka e pohon vetë Noli në kujtimet e tij. Në vitin 1909 u kthye në Korçë dhe shpejt u angazhua me grupet patriotike të qytetit. U



anëtarësua në shoqëritë patriotike “Dituria Shqip” dhe “Përparimi”, u aktivizua me grupet teatrore të qytetit të Korçës (sipas shtypit të kohës, ka luajtur një nga rolet kryesore të dramës “Besa” të Sami Frashërit), shkroi dhe kompozoi këngë patriotike e lirike për

bandën muzikore “Liria” dhe ishte anëtar i pleqësisë së saj. Në mbrojtje të Kongresit të Manastirit dhe të gjuhës shqipe, më 14 shkurt 1910 ishte ndër më aktivët në mitingun e organizuar nga shoqëria “Dituria Shqip”, që në histori njihet si “mitingu për mbrojtjen e shkronjave shqipe”. Në prill 1910, mbase i mësuar me një jetë ndryshe nga ajo që i ofronte qyteti i tij i lindjes, shkon në Manastir e më pas përsëri në Bukuresht, ku hapi një punishte




shtypshkrimesh dhe mban kontakte me figurat e shquara të kolonisë së shqiptarëve. Ishte një nga pjesëmarrësit në mbledhjen e organizuar më 5 nëntor 1912 në hotelin "Kontinental" nga Ismail Qemali dhe iu bashkua delegacionit të kolonisë së shqiptarëve të Rumanisë në ngritjen e flamurit, por si përfaqësues i Korçës, që në atë periudhë ishte nën pushtimin grek. Thuhet se kishte sjellë me vete disa flamuj të kuq me shqiponjën e zezë në mes, stampuar në punishten e tij. Deklaratën e Pavarësisë më 28 nëntor 1912 e ka nënshkruar me siglën "Spiro T. Ilo". Në prill të vitit 1914 u përfshi në çetën e Themistokli Gërmenjit në luftimet kundër shovinistëve grekë në Korçë. I zhgënjyer nga situata politike që po kalonte vendi, u kthye sërish në Rumani e prej andej në Amerikë. Në vitin 1916 hapi në Nju-Jork një kafene të vogël, e cila shumë shpejt u bë një nga qendrat e veprimtarisë kombëtare, ndërsa në vitin 1923 themeloi shoqërinë diskografike shqiptare *Albanian Phonograph Records*, që luajti rol në zhvillimin e kulturës shqiptare gjatë viteve 1920–1940. Në vitin 1916 botoi përmbledhjen me

këngë shqiptare "*Dëshirat e zemrës*" (që e ribotoi më 1918) dhe dramën "*Vërtet ëndërr*", dedikuar atdhetarit Sotir Peci "për veprat atdhesore dhe për karakterin e tij të patundur". Bashkëpunoi me tenorin e njohur arbëresh Xhuzeppe Mauro (*Giuseppe Mauro*), të cilin e kishte njohur në Bukuresht dhe së bashku më 1918 regjistruan në kompaninë "Columbia" të Çikagos një sërë këngësh patriotike dhe lirike shqiptare, ndër të cilat përmendim "*Himni mbretëror*", "*Betimi mbi flamur*", "*Rrofsh ti, o flamur*" dhe "*Pranvera*". Në veprimtarinë e tij u mor edhe me pikturë, kryesisht me stampim gravurash me tema patriotike. Ndër punimet e tij më të njohura janë "*Flamuri kombëtar*", "*Luftëtari kombëtar*", "*Luftëtarja kombëtare*", "*Malësori me pushkë*", "*Skënderbeu*", "*Kujtim për ditën e lirisë 1912*" etj. Në mars të vitit 1926 u kthye në vendlindje. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore u përfshi në Lëvizjen Antifashiste. Vdiq në Korçë më 7 nëntor 1950. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

32. SHEFQET DAJIU

(1882–1946)

Lindi në Elbasan në vitin 1882. Mësimet e para i mori në shkollën turke të qytetit, ndërsa studimet e larta i përfundoi në Stamboll në degën e shkencave politiko-juridike. Në vitet 1900–1905 u lidh me rrethet patriotike të kohës dhe u përfshi në Lëvizjen Kombëtare. Pas përfundimit të studimeve u kthye në atdhe dhe u emërua prefekt e nënprefekt në Skrapar, Pogradec dhe Starovë. Përshëndeti Kongresin e Elbasanit dhe hapjen e Shkollës Normale dhe dha ndihmesën e tij për gjallërimin e jetës kulturore, patriotike e arsimore të vendit. Në vitet 1911–1912 punoi mësues në Dibër. Atje bashkëpunoi me Vehbi Dibrën e atdhetarë të tjerë për propagandimin e ideve kombëtare dhe përhapjen fshehtas të librave në gjuhën shqipe që dërgonin shoqëritë patriotike jashtë atdheut. Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Elbasanit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe mori pjesë që në mbledhjen e parë të tij. Nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën



"Shefqet Dajiu". U zgjodh anëtar i Pleqësisë. Në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës fillimisht shërbeu si ndihmës i ministrit të Arsimit Luigj Gurakuqi, detyrë në të cilën punoi me përkushtim për organizimin e administratës shtetërore. Në shtator 1913 u ngarkua

me detyrën e nënprefektit të Fierit, ku u shqua për organizimin e administratës dhe vendosjen e rregullit e të qetësisë. Në vitet 1915–1919 punoi si avokat në Elbasan, ku ndihmoi për përhapjen e arsimit kombëtar në këtë qytet. Në vitin 1919 botoi "*Abetare e re për shkollat fillore t'ultra djemsh e vajzash*", një tekst shumë i rëndësishëm për nevojat e atëhershme të arsimit shqiptar. Në vitet 1920–1923 ishte deputet i Elbasanit në parlamentin shqiptar. Në këto vite ai bashkëpunoi me Aleksandër Xhuvanin në shoqërinë kulturore

“Kopshti Letrar” si dhe në revistën e përkohshme të kësaj shoqërie me të njëjtin titull, në të cilën botoi mjaft artikuj e studime. Në vitin 1938 përktheu librin “Ç’është Kurani”. Në vitet e pushtimit fashist mbështeti Shefqet Vërlacin dhe qeverinë e tij, ndërsa në prill 1940 u zgjodh anëtar i Këshillit të Epërm Fashist

Korporativ. Ndoshta këto qenë arsytet që në vitin 1945 u arrestua si kolaboracionist dhe u burgos. Vdiq në burg në vitin 1946. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” me dekret të Presidentit të Republikës nr. 7574, datë 26.06.2012.

33. THANAS FLOQI

(1884–1945)

Veprimtar i lëvizjes për shpalljen e pavarësisë kombëtare, jurist, publicist, gjuhëtar, përkthyes. Lindi në Korçë më 14 janar 1884. U arsimua në Greqi, ku emigroi familja e tij. Studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Athinës, ku u diplomua për drejtësi. Në vitin 2005 u kthye në Korçë bashkë me familjen e pas pak kohësh emigroi në Amerikë, ku u përfshi në lëvizjen patriotike. Në janar 1906 ishte një nga themeluesit e shoqërisë “Malli i Mëmëdheut”, që më vonë u përfshi në federatën “Vatra”. Atje u njoh me Sotir Pecin, Fan Nolin e Kristo Dakon. Në vitin 1908 u kthye në atdhe, në fillim në Vlorë. Në shtator të atij viti u takua me Ismail Qemalin dhe mbështeti kandidaturën e tij për deputet në parlamentin turk. Ishte një nga themeluesit e klubit patriotik “Labëria” (tetor 1908). Disa kohë punoi mësues në Vlorë e më pas në shkollën shqipe që hapën vëllezërit Hajredin e Bektash Cakrani në shtëpinë e tyre në Cakran. Në vitin 1909 u thirr në Korçë dhe u emërua drejtor i shkollës shqipe të klubit “Dituria”. U lidh me shoqëritë patriotike që vepronin në qytetin e Korçës dhe bashkëpunoi me Mihal Gramenon, Themistokli Gërmenjin, Hilë Mosin, Spiridon Ilon e të tjerë në mbrojtje të shkollës shqipe dhe alfabetit të saj, kundër propagandës xhonturke. Botoi veprën “Gramatikë e gjuhës shqipe”. Pas mbylljes së shkollës së klubit “Dituria” nga administrata turke shkoi përsëri në shkollën shqipe të Cakranit. Në korrik 1911 mori pjesë në Kuvendin e Drashovicës, i cili u organizua në mbështetje




të Memorandumit të Greçës, dhe në bashkëpunim me figura të tjera të njohura të kësaj periudhe zhvilloi një veprimtari të gjerë për organizimin e kryengritjes së armatosur kundër xhonturqve në vitin 1912. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar

të Vlorës si përfaqësues i Korçës dhe nënkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Thanas V. Floqi”. Pas shpalljes së Pavarësisë punoi jurist në administratën shtetërore në Vlorë, përkthyes pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve në Shkodër dhe që andej sekretar i prefektit Aqif pashë Biçakçiu (Elbasani) në Elbasan. Në qeverinë e Princ Vidit u emërua kryesekretar në Ministrinë e Drejtësisë (mars 1914). Pas largimit të Vidit u kthye në Elbasan, ku qëndroi deri në fund të jetës. Për disa kohë dha mësim në Normalen e qytetit, ndërsa në qershor 1918 ngriti grupin teatror “Shoqëria Teatrorë e Elbasanit” dhe kontribuoi në zhvillimin e teatrit të këtij qyteti. Pas vitit 1930 u mor me përkthime, kryesisht nga italishtja dhe frëngjishtja. Përktheu letërsi artistike dhe literaturë juridike. Për disa vjet punoi avokat. Ishte anëtar i Asamblesë Kushtetuese të periudhës së Viktor Emanuelit III (12 prill 1939–3 prill 1940) si përfaqësues i Elbasanit. Vdiq më 8 shkurt 1945. Në nëntor 2008 Bashkia e Elbasanit i dha titullin “Qytetar Nderi”. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.



34. VEHBI AGOLLI (DIBRA) (1867–1937)

Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, klerik i lartë mysliman. Lindi në Dibër të Madhe më 24 mars të vitit 1867 në familjen e Agollëve, një familje me tradita të njohura fetare e atdhetare, që gëzonte respektin e të gjithëve. Gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit kishte parë të vinin në shtëpinë e tij atdhetarë të shquar, si Abdyl Frashëri, Iliaz pashë Dibra etj., gjë që ndihmoi në rritjen e tij me frymën e dashurisë kombëtare. Duke qenë bir i myftiut të Dibrës së Madhe, ai ndoqi udhën e të atit dhe pasi mbaroi medresenë në vendlindje, shkoi për të kryer studimet e larta në Stamboll, ku u diplomua për teologji islame dhe u specializua në fushën e filozofisë, logjikës e shkencave juridike islame. Gjatë kohës së qëndrimit në Stamboll pati fatin të njihej dhe të bashkëpunonte me Sami Frashërin, Naim Frashërin, Shahin Kolonjën, Murat Toptanin e me mjaft atdhetarë të tjerë, që ndikuan edhe më tepër në formësimin përfundimtar të vizionit të tij kombëtar. Pas diplomimit u kthye në Shqipëri dhe u emërua myfti i Dibrës në vend të të atit, detyrë në të cilën qëndroi deri në vitin 1912. Ishte i pajisur me një kulturë të gjerë dhe zotëronte disa gjuhë të huaja, si: arabisht, persisht, turqisht e frëngjisht. Por gjuha që ai donte me gjithë shpirt e për të cilën dha kontribut me sa munda ishte gjuha shqipe, për të cilën thoshte se është ndër gjuhët më të vjetra të Europës e me rrënjët tek ilirishtja. Ndonëse veprimtaria e tij atdhetare fillon mjaft kohë më parë, për t'u dendësuar mandej gjatë kryengritjeve të mëdha kundërosmane për mbrojtjen e territoreve shqiptare e për pavarësinë, disa nga ngjarjet më të rëndësishme ku emri i tij spikat më së miri janë: Kongresi i Manastirit i vitit 1908, në të cilin ai luajti një rol të rëndësishëm e ku së bashku me Nikollë Kaçorrin e Dervish Himën mbrojti tezën e krijimit të një alfabeti të gjuhës shqipe me shkronja latine; Kongresi i Dibrës, që u mbajt në vitin 1909 e në të cilin u zgjodh edhe kryetar; Kongresi i Dytë i Manastirit (2–3 prill 1910); Kuvendi Kombëtar i Vlorës më 28 nëntor 1912. Në Kuvendin historik të Vlorës Vehbi Dibra mori pjesë si përfaqësues i Dibrës dhe dha një ndihmesë të vyer. Firmosi Deklaratën e



Pavarësisë në turqisht me siglën "Vehbi Dibra". Pas Ismail Qemalit ai ishte ndër të parët që e valëviti flamurin e pavarësisë më 28 nëntor 1912, duke e bekuar me dorën e tij prej atdhetari të nderuar e kleriku të devotshëm. Pas shpalljes së Pavarësisë, më 4 dhjetor të

vitit 1912, Kuvendi i Vlorës e zgjodhi kryetar të Pleqësisë, një organ konsultativ i krijuar për t'i ardhur në ndihmë Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, fakt që dëshmon respektin dhe nderimin që atdhetarët e tjerë ushqenin për të. Duke qenë një personalitet i shquar dhe me ndikim të gjerë, ai dha ndihmesën e tij në ngritjen e flamurit në qytete të tjera, si në Lushnjë, Elbasan, Fier, Dibër etj., dhe punoi shumë për organizimin e administratës së Qeverisë së Përkohshme. Duke qenë teolog i spikatur, personalitet i pajisur me frymë tolerante dhe atdhetar i paepur, Kuvendi i Vlorës e emëroi myfti të përgjithshëm të Shqipërisë, detyrë në të cilën dha një kontribut të rëndësishëm në krijimin e një klime tolerante në marrëdhëniet midis feve. Megjithatë, ai nuk u shkëput asnjëherë nga pjesëmarrja aktive në çështje që lidheshin drejtpërdrejt me mbrojtjen e identitetit shqiptar dhe të integritetit tokësor. Ai luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e kryengritjes shqiptare të shtatorit 1913 kundër pushtuesve serbë në zonën e Dibrës. Se sa i madh ka qenë ndikimi i tij te kryengritësit e dëshmon fakti që qeveria serbe e dënoi me vdekje. Në vitin 1914 ishte anëtar i delegacionit shqiptar që shkoi në Gjermani për t'i shprehur Princ Vidit pëlqimin e shqiptarëve për ta pasur në krye të fronit. Për disa vjet ai emigroi në Sofje e në Bukuresht, ku ra në kontakt me atdhetarë tjerë të shquar, si Mihal Grameno, Themistokli Gërmenji, Hoxha Kadriu (Kadri Prishtina) etj. Në Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar, që u mbledh në shkurt 1923, Vehbi Dibra u zgjodh kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Nën drejtimin e tij Komuniteti Mysliman fitoi njohjen juridike dhe arriti ta shkëpuste përfundimisht islamin shqiptar nga varësia prej Stambollit. Me iniciativën e tij në vitin 1923 u hap medreseja e

pare shqiptare dhe filloi të botohej revista e përmuajshme "Zani i naltë". Me veprimtarinë e tij në krye të Komunitetit ai fitoi respektin e klerit mysliman dhe qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 1929. Më pas u tërhoq në jetën e tij private. Vdiq në moshën 70-vjeçare më 24 mars të vitit 1937, pas një jete të përkushtuar në dobi të

çështjeve të mëdha të pavarësisë, të përparimit të vendit e lartësimit të vlerave shpirtërore, duke mbetur në kujtesën e kombit si një nga personalitetet e nderuara të botës shqiptare. Është dekoruar me Urdhrin e Flamurit dhe në 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë edhe me Urdhrin "Nderi i Kombit".

35. VELI HARXHI

(1850–1914)

Lindi në Gjirokastrë. Studimet i përfundoi në Stamboll në degën e administrimit dhe ekonomisë. Pas studimeve punoi në Stamboll, ku u lidh me veprimtarë të çështjes shqiptare që ndodheshin aty. Nga fillimi i shekullit që lamë pas u kthye në Shqipëri si i emëruar i Portës së Lartë në nënprefekturën e Vlorës. Përfaqësoi Gjirokastrën në Kuvendin e Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Veli Harçi". Vdiq nga një atak kardiak në Vlorë,



26.06.2012.

ku kishte edhe familjen, zhvendosur nga Gjirokastra që në kohën kur u emërua me detyrë zyrtare në këtë qytet. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë

36. XHELAL KOPRËNCKA

(1876–1919)

Veprimtar i luftës për çlirim kombëtar në zonën e Skraparit. Lindi në Koprëncë (Skrapar) në një familje me tradita të njohura kombëtare. Pasi mori mësimet e para në qytetin e Korçës, vijoi të mesmen në Stamboll, ku në vitet 1901–1904 vazhdoi studimet në shkollën e lartë ushtarake. Pas përfundimit të studimeve u emërua në repartet ushtarake të Selanikut. Në vitin 1908 ndihmoi në hapjen e shkollave shqipe në Koprëncë, Çorovodë e Gostëncë dhe të kurseve të mbrëmjes për t'u mësuar të rriturve shkrim e këndim në gjuhën shqipe. Përkrahu vendimet e Kongresit të Dytë të Manastirit (1910). Së bashku me Ali Koprëncën, një afërm i tij, ishte anëtar i komitetit të fshehtë "Për Lirinë e Shqipërisë" dhe e ushtronin veprimtarinë e tyre patriotike në Korçë dhe Manastir. Anëtar i shoqërive patriotike jashtë vendit. Në vitin 1911 u emërua qarkkomandant i xhandarmërisë në Janinë. Më 28 nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i




Skraparit dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën "Xhelal Ko.". Për veprimtarinë e tij patriotike u zgjodh anëtar i Pleqësisë. Qeveria e Përkohshme e ngarkoi me detyrën e organizimit të frontit të luftës kundër shovinistëve grekë në viset e Jugut. Ndihmoi ministrin e Luftës, Mehmet pashë Dërrallën, në organizimin e ushtrisë kombëtare. Në vitet 1913–1914 ishte në udhëheqje të popullit të Skraparit kundër masakrave të andartëve grekë në Shqipërinë e Jugut. Në dhjetor 1915 mori pjesë në kryengritjen që çliroi zonat nga Skrapari në Kozarë të Beratit nga forcat esadiste. Ishte delegat i Skraparit në Kongresin e Durrësit (dhjetor 1925). U vra pabesisht nga elementë antikombëtarë më 21 tetor 1919. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.



37. XHEMAL DELIALLISI

(1880–1941)

Veprimtar shoqëror dhe politik i lëvizjeve për çlirim kombëtar. Lindi në vitin 1880 në Shijak në një familje atdhetare të njohur (thuhet se babai i tij, Sali bej Delliallisi, njihet si themeluesi i qytetit të Shijakut⁸). Mësimet e para i mori në mejtepin e këtij qyteti e më pas vijoi shkollën rushdiye. Me këmbënguljen e tij arriti të mësonte persishten, osmanishten dhe italishten. Në vitin 1903 filloi punë në administratën e nënprefekturës së Shijakut, ku punoi për disa vjet. Nën ndikimin e dom Nikollë Kaçorrit, Murat e Said Toptanit, por dhe të atdhetarëve në Selanik, Bukuresht e Stamboll me të cilët kishte korrespondencë, u përfshi në lëvizjen kombëtare. Janë të njohura përpjekjet e tij për përhapjen e gjuhës shqipe në zonën e Shijakut. Në vitet 1908–1910 doli hapur kundër politikave të reja të xhonturqve për centralizimin e pushtetit, ndërsa në vjeshtën e vitit 1912 ishte një nga organizatorët e luftëtarëve vullnetarë të Shijakut për mbrojtjen e Shkodrës nga pushtimi serb. Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Shijakut në Kuvendin historik të shpalljes së pavarësisë dhe së bashku me




kushëririn e tij Ymer Deliallisi shoqëroi Ismail Qemalin nga Durrësi për në qytetin e Vlorës pas mbërritjes nga Triestia. Nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën osmanisht “Xhemmalyddin bej”. Qeveria e Përkohshme e Vlorës për disa kohë e ngarkoi me detyrën e

ndihmësit të Lef Nosit në Ministrinë e Postë-Telegrafës. Mirëpriti ardhjen e Princ Vidit dhe shërbeu në administratën e tij në Durrës. Më 1924 përkrahu kryengritjen e Fan Nolit dhe u bë mbështetje e fuqishme e qeverisë së tij. Pas rënies së qeverisë së Nolit emigroi në Itali, ku qëndroi deri në vitin 1927, kur u kthye në vendlindje dhe më pas u vendos në Tiranë. Megjithëse i moshuar, ndiqte me interes zhvillimet politiko-shoqërore të vendit. Vdiq në vitin 1940. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

38. YMER DELIALLISI

(1873–1944)

Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në Shijak në vitin 1872. Pasi mori mësimet e para në mejtepin e qytetit, vijoi mësimet në një shkollë të mesme në Stamboll. Shkrimin e gjuhës shqipe e mësoi fshehurazi me ndihmën e Murat Toptanit dhe dom Nikollë Kaçorrit. Qysh në vitin 1900 u lidh me atdhetarë të njohur në kolonitë shqiptare në Egjipt dhe Bukuresht, prej nga mernte libra dhe gazeta në gjuhën shqipe. Në vitin 1908 mori pjesë aktive në përhapjen e ideve kombëtare, duke bërë pjesë të saj dhe familjarët e tij⁹. Në dokumentet e kohës emri i Ymer Deliallisit përmendet shpesh si protagonist i organizimit të kryengritjeve kundër pushtuesit dhe si drejtues i protestave popullore në Shqipërinë e Mesme. Në vjeshtën e vitit 1912 mori pjesë në kryengritjen e Krujës dhe Mirditës kundër pushtuesve osmanë. Më 22 nëntor 1912, siç e dëshmon në kujtimet e tij, priti në Durrës



Ismail Qemalin dhe delegacionin që e shoqëronte në udhëtimin historik nga Bukureshti dhe së bashku me kushëririn e tij Xhemal Deliallisi iu bashkuan grupit që mori përsipër sigurimin e karvanit të plakut të Vlorës për në qytetin e Pavarësisë. Mori pjesë

në Kuvendin Kombëtar si delegat i Shijakut dhe nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Ymer”. Në vitin 1914 mbështeti Princ Vidin dhe qeverinë e tij. Delegat i nënprefekturës së Shijakut në Kongresin e Durrësit (dhjetor 1918) dhe në Kongresin e Lushnjës (janar 1920), që e zgjodhi senator. Në periudhën e mbretërisë

⁸. Teki Selenica, “Shqipnia në vitin 1927”.

⁹. Hafiz Ibrahim Dalliu, “Patriotizma në Tiranë”, 1930.

kreu detyra të rëndësishme shtetërore, si: kryetar bashkie në Shijak, nënprefekt në Lushnjë, në Peqin etj. Në vitet 1930–1940 u mor me tregti. Vdiq në vitin 1944, duke lënë pas emrin e një atdhetari të shquar dhe një

figure të respektuar nga bashkëkombësit e tij. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

39. ZIHNI ABAS KANINA (HAMZARAJ) (1885–1957)

Ka lindur në Kaninë (Vlorë) më 18 janar 1885 në një familje çifligare me tradita të njohura atdhetare. Mësimet e para i mori në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmen dhe të lartën në Stamboll. Në vitin 1906, pas përfundimit të studimeve, u emërua nëpunës në konsullatën turke të Greqisë, pastaj të Maltës, Bejrutit dhe Tbilisit. Që në ato vite, meqë zotëronte mirë disa gjuhë të huaja (turqishten, arabishten, persishten, frëngjishten, italishten dhe greqishten), u mor me përkthimin e autorëve të shquar persianë, francezë e grekë. Në vitet 1908–1909 u lidh me kolonitë shqiptare në Egjipt, Selanik, Bukuresht dhe Stamboll, prej nga merre libra dhe gazeta në gjuhën shqipe dhe i shpërndante në zonën e Vlorës. U burgos nga autoritet turke dhe më pas u internua në Çanakala. Në pranverë të vitit 1911 u kthye në vendlindje dhe u përfshi në lëvizjen për pavarësi. Mori pjesë në kuvendin e Drashovicës (korrik 1911) në mbështetje të Memorandumit të Greçës. Në nëntor 1912 ishte anëtar i komisionit organizator për shpalljen e pavarësisë kombëtare. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Zihni Abbas Kanina”. Qeveria e Përkohshme e ngarkoi me detyrën e sekretarit të ministrit të Jashtëm, detyrë gjatë së cilës



bashkëpunoi me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin dhe Abdi Toptanin. Në qeverinë e Princ Vidit (7 mars–3 shtator 1914) u emërua sekretar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Këshillin Ministror. Në vitet 1918–1919 u rreshtua përkrah atdhetarëve të tjerë dhe

protestoi kundër synimeve shoviniste të shteteve fqinje ndaj vendit tonë. Ishte një nga themeluesit e Shkollës së Mesme Tregtare të Vlorës më 1919. Në vitin 1925 u emërua sekretar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë. Në vitet 1927–1928 ishte mësues i gjuhës frënge në Shkollën e Mesme Tregtare, ndërsa në vitet 1918–1929 drejtor i kësaj shkolle. Në shtator 1929 pushohet nga puna për motive politike nga administrata zogiste. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore u bë pjesë e Ballit Kombëtar përkrah mikut të tij të vjetër Mithat Frashëri. Kjo nuk u pëlqeu komunistëve, të cilët në vitin 1951 e arrestuan dhe e burgosën. Vdiq në vitin 1956 i lënë në harresë nga regjimi i kohës. Me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u dekorua me Urdhrin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7574, datë 26.06.2012.

40. ZYHDI OHRI (1870–1931)

Atdhetar e veprimtar i lëvizjes kombëtare në Ohër dhe Dibër. Lindi në qytetin e vogël piktoresk të Ohrit në vitin 1870. Prej familjes trashëgoi një pasuri të madhe në toka, por mbi të gjitha dashurinë e pakufishme për atdheun, që vuante nën sundimin e Portës së Lartë. Pasi mori mësimet e para në qytetin e lindjes në gjuhën turke, shkoi në Stamboll, ku mbaroi disa



klasë në një shkollë qytetëse, më pas (1882–1887) vijoi arsimimin e mëtejshëm në “Robert College”. Pas mbarimit të kolegjit kërkon të punojë në administratën osmane, por të shërbente në vilajetet shqiptare. Në verën e vitit 1897 u kthye në



vendlindje dhe iu vu punës për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Duke parandier rreziqet që i vinin Shqipërisë, u përpoq të mblidhte rreth vetes dhjetëra bashkëmoshatarë, kryesisht nga dyert e mëdha të Ohrit, Veleshtës dhe Strugës, të cilët mund të ndikonin në zgjimin e vetëdijes kombëtare. Së bashku me Murat Sojliu dhe Hamdi Ohrin punoi për ngritjen e komiteteve të fshehta, detyra e të cilëve ishte të nxitnin te shqiptarët ndjenjën e bashkimit për të kundërshtuar urdhrat që vinin nga Porta e Lartë. Ishte ithtar i autonomisë së Shqipërisë dhe mori pjesë në Kuvendin e Pejës (23–29 janar 1899), që nën shembullin e Lidhjes së Prizrenit të vitit 1878 shpalli themelimin e lidhjes së re shqiptare, e cila u quajt *Lidhja e Pejës* ose *Lidhja "Besa-Besë"*. Falë gjykimit të thellë për situatën politike dhe oratorisë që e karakterizonte, ai fitoi admirimin e pjesëmarrësve. Në vitin 1899 veprimtaria e tij u përqendrua kryesisht në zonën e Dibrës, ku u bë promotor i zhvillimit të ideve dhe vendimeve të Lidhjes së Pejës. Së bashku me patriotët Hamdi Ohri, Nurçe Pustina organizoi disa takime të fshehta në krejt Dibrën për përzgjedhjen e delegatëve në Kuvendin e Dibrës të vitit 1899 (27 shkurt–mësi i marsit 1899), që shpalli formimin e Lidhjes së Dibrës, që në dokumentet e kohës njihet si "Besëlidhja e Dibrës" ose "Itifaku i Madh". Veprimtaria atdhetare e tij do të zgjerohej më tej në vitet 1900–1907, kur prirja autonomiste po zinte vend gjithnjë e më tepër në zemrat e shqiptarëve. Një vlerë e spikatur e Zyhdit Ohrit është ndihmesa e çmuar që dha në mbarëvajtjen e Kongresit të Mnastirit (1908).

Edhe në këtë rast shtëpia e tij u kthye në çerdhe të patriotizmit. Në vitet 1908–1910 ai bashkëpunoi me Sali Gjukën dhe Fehim Zavallanin për shtypjen e abetareve të para me alfabetin latin, me Gjergj dhe Parashqevi Qiriazin për çeljen e shkollave shqipe në Ohër, Strugë, Manastir dhe Korçë. Mori pjesë në Kongresin e Dibrës (23–29 korrik 1909) dhe mbështeti programin e tij. Në verën dhe vjeshtën e vitit 1912, në bashkëpunim me Hamdi Ohrin, Nuri Sojliu, Sali Gjukën etj., u përpoq të organizonte çetat kryengritëse në Ohër, Strugë, Manastir e deri në Kërçovë, Gostivar e Tetovë kundër reaksionit serbo-bullgaro-maqedonas. Në nëntor 1912 u zgjodh delegat në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Burimet arkivore provojnë se ai mori pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë si përfaqësues i Ohrit me siglën "Zuhdi Ohria". Qeveria e Përkohshme e Vlorës e ngarkoi me detyrën e këshilltarit pranë kryetarit të Pleqësisë, detyrë të cilën do ta pranonte me entuziazëm, për më tepër që me myfti Vehbi Dibrën njihej prej kohësh. Në shtator 1913 me urdhër të Ismail Qemalit shkoi në Elbasan me detyrën e këshilltarit pranë prefektit Aqif pashë Biçakçiu (Elbasani), ku dha ndihmesën e vet në organizimin e administratës. Mori pjesë në Kongresin e Lushnjës (1920) dhe mbështeti qeverinë e Sulejman Delvinës. Vdiq në Ohër në vitin 1931. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë u dekorua me Urdhrin "Nderi i Kombit" me dekret të Presidentit të Republikës nr. 7574, datë 26.06.2012.

VITI 1914



Vilhelm Vidi (*Wilhelm Friedrich Heinrich Prinz zu Wied*) lindi më 26 mars 1876 në Neuwied (Gjermani) dhe vdiq më 18 prill 1954 në Predeal (Rumani). Sundoi në Shqipëri për 6 muaj (7 mars–3 shtator 1914). Regjimi i tij u sanksionua nga Statuti Organik i Shqipërisë (ligji i parë themelor i shtetit shqiptar), i cili u përgadit nga Komisioni Ndërkombëtar i Kufirit dhe bazohej kryesisht në vendimet e marra nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 29 korrik 1913. Sipas nenit 1 të Statutit, Shqipëria shpallej “principatë kushtetuese e pavarur dhe e trashëgueshme” nën garancinë e Fuqive të Mëdha. Me nenin 2 Fuqitë e Mëdha garantonin tërësinë dhe paprekshmërinë e tokave të Shqipërisë në kufijtë që kishin caktuar ato. Me nenin 3 shteti shqiptar do të ishte asnjëherë, dhe kjo asnjëherë garantohej po nga Fuqitë e Mëdha. Sipas nenit 7 në fronin e Shqipërisë njihej me të drejta sovraane Princi Vilhelm Vid, i cili ishte kryetar i administratës civile e ushtarake dhe kishte të drejtë të emronte Këshillin e Ministrave. Organi legjislativ i Shqipërisë ishte Asambleja Kombëtare. Gjuhë zyrtare dhe e detyruar në shkollë ishte shqipja. Nga ana administrative Shqipëria ndahej në 7 sanxhaqe (prefektura), të cilat ndaheshin në kaza (nënprefektura) dhe kazatë në nahije (komuna). Statuti Organik i Shqipërisë caktoi institucionet e larta të shtetit, përbërjen e forcave të armatosura, të administratës, të financave, të drejtësisë, të

ASAMBLEJA KOMBËTARE me fuqi ligjvënëse në Shqipëri



PRINC VID I
(1876–1945)

arsimit dhe garantonte ushtrimin e lirë të veprimtarisë ekonomike, shoqërore e politike. Normat e Statutit Organik në shumë aspekte pasqyronin praktikën kushtetuese të vendeve parlamentare, por pavarësisht nga sanksionimi i këtyre parimeve në Statut jeta parlamentare ishte shumë e kufizuar për shkak të pushteteve shumë të gjëra që kishte Princi. Duke i parë në tërësi kompetencat e saj, mund të themi se Asambleja Kombëtare nuk ishte as organ i lartë dhe as një organ me të vërtetë përfaqësues, por thjesht një organ legjislativ, madje me kompetenca të kufizuara¹⁰, pasi të gjitha vendimet e saj në fushën legjislative duhej të miratoheshin nga Princi, i cili kishte të drejtën e vetos pezulluese. Vendimi i Fuqive të Mëdha për të krijuar një parlament të ri të përbërë nga 36 anëtarë (5 të kooptuar për shkak të funksionit, 10 të emëruar nga Princi dhe 21 të zgjedhur) nuk u zbatua asnjëherë, prandaj në këtë periudhë nuk mund të flitet për veprimtari parlamentare.

Një parlament i përkohshëm u zgjodh në Kongresin e Durrësit, që u thirr më 25 dhjetor 1918. Në të morën pjesë 53 delegatë nga krahina të ndryshme të vendit. Vendimi për formimin e Pleqësisë (Senatit) si organ këshillimor i qeverisë nuk funksionoi, pasi Pleqësia as nuk arriti të

¹⁰. Ylli Bufi, “Tempulli i demokracisë”, Tiranë, “Ombra GVG”, 2010, f. 150.



konstituohet. Organet e zgjedhura nuk arritën të vepronin dhe të fitonin autoritetin e duhur për shkak të ndarjeve të thella, konflikteve krahinore dhe rolit përçarës të ushtrive të huaja të

pranishme në vend¹¹. Parlamenti i parë funksional shqiptar u konstituua vetëm pas Kongresit të Lushnjës (janar 1920), që u quajt “Këshilli Kombëtar”.



¹¹. Ylli Bufi, “Tempulli i demokracisë”, Tiranë, 2010, “Ombra GVG, f. 151–152.

VITI 1920

KËSHILLI KOMBËTAR (SENATI)

27 mars–20 dhjetor 1920

Zgjedhjet u mbajtën më 31 janar 1920



Kongresi i Lushnjës hodhi bazat kushtetuese të organizimit të shtetit shqiptar. Ai krijoi Senatin si organ legjislativ, që përbëhej nga 37 anëtarë të zgjedhur nga vetë delegatët. Në këtë periudhë u afirmuan për herë të parë parimet e parlamentarizmit: emërimi dhe shkarkimi i qeverisë nga Senati si dhe ushtrimi i kontrollit parlamentar ndaj saj. Megjithëse Këshilli

Kombëtar (Senati) e ushtroi veprimtarinë e tij legjislative për një periudhë të shkurtër, ai arriti të miratonte disa ligje të rëndësishme. Akti më i rëndësishëm ishte Statuti i Lushnjës, që përbënte një ligj kushtetues. Veprimtaria legjislative e Senatit mori fund në dhjetor të vitit 1920, kur ai u shpërnda për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të para në Shqipëri (mars–prill 1921).

Kryesia e Këshillit Kombëtar e zgjedhur më 29 mars 1920:

XHEMAT NAIPI – kryetar
SPIRO JORGO KOLEKA – nënkryetar
DHIMITËR KACIMBRA¹² – nënkryetar
HILË MOSI – sekretar

Kryesia e Këshillit Kombëtar e zgjedhur më 25 shtator 1920:

DHIMITËR KACIMBRA – kryetar
QAZIM KOCULI – nënkryetar
HILË MOSI¹³ – sekretar
RAMIZ DACI – kujdestar

Komisionet e përhershme të Këshillit Kombëtar¹⁴:

1. Komisioni i Rregullores
2. Komisioni për Punë Administrative të Brendshme e Ushtarake
3. Komisioni për Punë të Financave e Postë-Telegrafave
4. Komisioni për Arsim e Punë Botore
5. Komisioni për Drejtësi, Politikë e Ankime

¹². Zëvendëson Spiro Kolekën më 27 maj 1920.

¹³. Më 6 nëntor 1920 zëvendësohet nga Kolë Thaçi.

¹⁴. “Bisedime parlamentare”, 1920, f. 54.



**Kryesia e Këshillit Kombëtar
e zgjedhur më 29 mars 1920:**

XHEMAL NAPI – kryetar
SPIRO JORGO KOLEKA – nënkryetar
DHIMITËR KACIMBRA¹⁵ – nënkryetar
HILË MOSI – sekretar

**Kryesia e Këshillit Kombëtar
e zgjedhur më 25 shtator 1920:**

DHIMITËR KACIMBRA – kryetar
QAZIM KOCULI – nënkryetar
HILË MOSI¹⁶ – sekretar
RAMIZ DACI – kujdestar

**Komisionet e përhershme të Këshillit
Kombëtar¹⁷:**

1. Komisioni i Rregullores
2. Komisioni për Punë Administrative të Brendshme e Ushtarake
3. Komisioni për Punë të Financave e Postë-Telegrafave
4. Komisioni për Arsim e Punë Botore
5. Komisioni për Drejtësi, Politikë e Ankime

¹⁵. Zëvendëson Spiro Kolekën më 27 maj 1920.

¹⁶. Më 6 nëntor 1920 zëvendësohet nga Kolë Thaçi.

¹⁷. “Bisedime parlamentare”, 1920, f. 54.

Kryetar i Këshillit Kombëtar. Personalitet i shquar mysliman, kadi, kryetar i Komisionit. Lindi në qytetin e Shkodrës në vitin 1887. Arsimin fillor dhe të mesëm e mori në vendlindje, kurse studimet e larta i përfundoi në Stamboll në dy degë: në teologji dhe në jurisprudencë. Jeta studentore i dha mundësi të binte në kontakt me shoqëritë atdhetare e kulturore shqiptare të mërgimit dhe me kulturën e Lindjes e të Perëndimit, që së bashku ndikuan në formimin e tij të përgjithshëm. Pas përfundimit të studimeve u kthye në atdhe dhe kreu disa detyra të rëndësishme fetare e shtetërore. Ai ka qenë kadi, myfti, kryetar i Komisionit të Arsimit për Shkodrën, senator, deputet, aktivist në shoqata kulturore etj. Me krijimin e Drejtorisë së Vakëfeve u vu në krye të saj dhe dha një kontribut të dukshëm edhe për arsimin: bëri të mundur grumbullimin e fondeve të përshtatshme për ndërtimin e godinës së re të Medresesë së Përgjithshme të Tiranës; më 1922 qe ndër përkrahësit më aktivë për hapjen e Gjimnazit të Shtetit në Shkodër; më 1925 me ndërhyrjen e tij dy medresetë e Shkodrës u bashkuan në një të vetme, u reformuan planet dhe programet mësimore dhe u përzgjedh kuadri arsimor. Në detyrën e myftiut në Shkodër së bashku me kuadrot fetarë që kishte në vartësi ai punoi për sigurimin e një atmosfere mirëkuptimi ndër fetar, të një tolerance e bashkëpunimi të natyrshëm, për nderimin e ndërsjellë, për krijimin e forcimit e një miqësie të sigurtë mes drejtuesve e besimtarëve të të tria besimeve që bashkëjetonin në këtë qytet. Po kaq e larmishme është dhe veprimtaria atdhetare e tij. Me krijimin në Shkodër të komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” më 7 nëntor 1918, ai nuk hezitoi ta vinte popullaritetin e tij dhe gjithçka munda në shërbim të çështjes së Kosovës. Mori pjesë në Kongresin e Lushnjës dhe ishte një nga delegatët më aktivë. Në një nga mbledhjet u vendos që Shkodra të përfaqësohej me katër senatorë në Këshillin Kombëtar (Senat) dhe një ndër ta ishte



XHEMAL NAIPI
(1887–1955)

Kryetar
i Këshillit Kombëtar
(29 mars–25 shtator 1920)


Xhemal Naipi. Në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar, që u mbajt më 27 mars 1920 në Tiranë, u zgjodh në komisionin prej pesë vetash për drejtimin e tij. Në mbledhjen e dytë, më 29 mars 1920, u zgjodh kryetar i Këshillit Kombëtar, detyrë në të cilën qëndroi deri më 25 shtator 1920, kur në vend të tij u zgjodh Dhimitër Kacimbra. Bashkëpunoi ngushtë me Hilë Mosin, që ishte sekretar i Këshillit Kombëtar, për mbarëvajtjen e punimeve të legjislaturës së parë. Ata luajtën një rol të rëndësishëm për funksionimin e këtij organi legjislativ. Kundërshtoi pushtimin fashist më 7 prill 1939 dhe si deputet i parlamentit mbajti anën e popullit. Burime të shumta arkivore dëshmojnë se nuk mori pjesë në Asambleenë Kushtetuese që krijoi qeverinë e re dhe vendosi që kurorën e Shqipërisë t’ia ofronte Viktor Emanuelit III. Për këtë ai u burgos e më pas së bashku me shumë atdhetarë të tjerë antifashistë u internua në Itali, ku qëndroi deri në vitin 1942. Gjendja në vend ishte e rëndë dhe ai u aktivizua me çetat legaliste. Në nëntor 1943 u zgjodh kryetar i Lëvizjes së Legalitetit. Qëndroi i fshehur deri në vitin 1946. Gjatë viteve 1945–1946 iu konfiskua pasuria dhe familjen ia internuan në Berat për çështje politike. Pas amnistisë u dorëzua dhe iu nënshtrua gjyqit. U dënua me vdekje, por më vonë dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm. Kështu filloi për të vargu i pafund i vuajtjeve të papërshkrueshme. Njohu tërë kompetet e punës



së detyruar në të gjithë vendin dhe përfundoi në burgun famëkeq të Burrelit. Nuk pati asnjë zbritje dënimi për të, sepse ishte “i pakorrigjueshëm”. Vdiq në vitin 1955 në moshën 77-vjeçare dhe u varros pa dijeninë e familjes.

Lindi në Përmet më 1875. U diplomua për drejtësi në Universitetin e Athinës. Punoj disa kohë si avokat në Përmet. Në kohën e Luftës së Parë Botërore ishte nënprefekt i Përmetit. Mori pjesë në Kongresin e Lushnjës (janar 1920) dhe atë të Durrësit (dhjetor 1918). Deputet i prefekturës së Gjirokastrës në vitet 1920–1923 dhe 1932–1944. Më 27 maj 1920 zëvendëson Spiro Jorgo Kolekën në detyrën e nënkryetarit të Këshillit Kombëtar, ndërsa nga 25 shtatori deri më 20 dhjetor 1920 ishte kryetar i Këshillit Kombëtar (Senatit) në vend të Xhemal Naipit. Ministër i Drejtësisë në qeverinë e dytë të Iliaz Vrionit më 1921. Mori pjesë në kongresin e dytë të Kishës Ortodokse Shqiptare në Korçë në vitin 1939. Me dekretin e 18 prillit 1942 të Mëkëmbësisë së Përgjithshme u emërua anëtar i Këshillit Qendror të Ekonomisë Korporative. Vdiq rreth viteve '50 të shek. XX.

Me rastin e 75-vjetorit të Kongresit të Lushnjës u dekorua me Urdhrin “Për Veprimtari Patriotike të Klasit të Parë”, ndërsa me rastin e dekorimit të një grupi klerikësh patriotë u dekorua me medaljen “Pishtar i Demokracisë”.



DHIMITËR KACIMBRA¹⁸
(1875–1950)

Kryetar
i Këshillit Kombëtar
(25 shtator–20 dhjetor 1920)

¹⁸. Kastriot Dervishi, “Historia e shtetit shqiptar 1912–2005”, Tiranë, 2006.

D Këshilli Kombëtar (Senati) i emëruar nga Kongresi i Lushnjës:

- | | | |
|-------------------------------|------------------------|---------------------------|
| 1. Abdurahman MATI (KROSI) | 15. Hilë MOSI | 29. Ramiz DACI |
| 2. Adem GJINISHI | 16. Hysein VRIONI | 30. Rexhep MITROVICA |
| 3. Adem PEQINI | 17. Irfan bej OHRITI | 31. Sadullah bej TEPELENA |
| 4. Ahmet RESULI | 18. Kiço KOÇI | 32. Sejfi VLLAMASI |
| 5. Bajram bej CURRI | 19. Kolë THAÇI | 33. Spiro Jorgo KOLEKA |
| 6. Bektash CAKRANI | 20. Kostaq (Koço) KOTA | 34. Spiro (Pilo) PAPA |
| 7. Beqir bej RUSI | 21. Llambi GOXHOMANI | 35. Shefqet VËRLACI |
| 8. Dine bej DIBRA (MAQELLARA) | 22. Myqerem HAMZARAJ | 36. Thanas ÇIKOZI |
| 9. Dine DEMA | 23. Mytesim KËLLIÇI | 37. Veli bej KRUJA |
| 10. Dhimitër KACIMBRA | 24. Neki RULI | 38. Visarion XHUVANI |
| 11. Fazlli FRASHËRI | 25. Osman LIKA | 39. Xhemal SHKODRA |
| 12. Gjergj KOLECI | 26. Qani DISHNICA | 40. Xhemal NAIPI |
| 13. Halim bej ÇELA | 27. Qazim DURMISHI | 41. Ymer bej SHIJAKU |
| 14. Hafiz Sabri bej | 28. Qazim KOCULI | |

Senatorët sipas prefekturave

Prefektura e Beratit:

1. Ahmet RESULI
2. Bektash CAKRANI
3. Hysein VRIONI
4. Llambi GOXHOMANI
5. Spiro (Pilo) PAPA

Prefektura e Dibrës:

1. Abdurahman MATI (KROSI)¹⁹
2. Dine DEMA
3. Dine bej DIBRA (MAQELLARA)
4. Halim bej ÇELA²⁰
5. Ramiz DACI

Prefektura e Elbasanit:

1. Adem GJINISHI
2. Qazim DURMISHI²¹
3. Shefqet VËRLACI
4. Visarion XHUVANI

Prefektura e Gjirokastrës:

1. Beqir RUSI
2. Dhimitër KACIMBRA
3. Kiço KOÇI
4. Neki RULI

Prefektura e Korçës:

1. Fazlli FRASHËRI²²
2. Kostaq (Koço) KOTA
3. Qani DISHNICA
4. Sejfi VLLAMASI
5. Thanas ÇIKOZI

Prefektura e Kosovës Has e Krasniqe:

1. Bajram CURRI
2. Rexhep MITROVICA²³

Krahina e Lumës:

Osman LITA²⁴

Prefektura Shkodër–Lezhë:

1. Gjergj KOLECI
2. Hilë MOSI
3. Hafiz SABRI bej
4. Kolë THAÇI²⁵
5. Xhemal SHKODRA
6. Xhemal NAIPI

Prefektura e Vlorës:

1. Myqerem HAMZARAJ²⁶
2. Qazim KOCULI
3. Sadullah TEPELENA
4. Spiro Jorgo KOLEKA

¹⁹. Abdurahman Sali Krosi është thirrur “Abdurahman Mati” (Robert Elsie, A Biographical Dictionary of Albanian History, London; New York: I.B Tauris & Co Ltd., 2012. f. 258.) Te “Bisedimet parlamentare” të vitit 1920”, f. 23, është “Abdurahman Krosi”, ndërsa te “Bisedimet parlamentare” të vitit 1928, f. 20, është “Abdurrahim Sali”.

²⁰. Betuar më 4 maj 1920.

²¹. Betuar më 23 shtator 1920.

²². Më 31 mars 1920

²³. Më 30 tetor 1920.

²⁴. Betuar më 18 maj 1920.

²⁵. Betuar më 23 shtator 1920.

²⁶. Zgjedhur në Vlorë.



010 18. 1912
Duke Maribai

Shteti Shqiptar

Shteti e prandaj asnjë përgjegjësi
civile të shkaktoime
prej shërbimit telegrafik.

Marrësi i kësaj llogare në rimborsim detyrohet
në ditën kur shlyhet detyra e kësaj, të pagojë me parë
shtetit përgjegjësi për asnjë shtet.

Për	Prej	N. treg.	Fjale	Data	Ora	Shënime të qortashme
	Fieri	434	28	1/11	10	

La jemin gazmore per zgjedhjen e
prefetarit republikës populli i Fierit
e priti me brokhor të madhe me ju
dron

Komiseri bashkisë
L. Xoxa

VITI 1921
KËSHILLI KOMBËTAR

(Një dhomë)

21 prill 1921–30 shtator 1923

Zgjedhjet përfunduan më 5 prill 1921.



Këshilli i ri Kombëtar i dalë nga këto zgjedhje përbëhej nga 78 deputetë, që përfaqësonin dy partitë politike parlamentare: Partinë Popullore, që kryesohej nga Fan Noli, dhe Partinë Përparimtare, që kryesohej nga Hoxhë Kadriu. Si parlamenti i parë shqiptar i zgjedhur nga vota popullore, Këshilli Kombëtar miratoi ligje financiare, administrative, penale etj., por rëndësi të veçantë kishte ligji për organizimin e gjyqësorit, që sanksiononte pavarësinë e

gjykatave. Zgjerimi i Statutit të Lushnjës në dhjetor 1922, e shndërroi këtë akt ligjor në kushtetutë të mirëfilltë dhe sanksionoi plotfuqinë parlamentare. Këshilli Kombëtar në legjislaturën e ardhshme do të quhej *Parlament*, që do të përbëhej nga një dhomë e vetme dhe do të mbledhej dy herë në vit në sesione të rregullta tremujore. Statuti i Zgjeruar përcaktonte edhe statusin e deputetit dhe imunitetin e tij.



Kryesitë e zgjedhura:

Sesioni i parë (9 maj 1921):

PANDELI EVANGJELI²⁷ – kryetar
HOXHA KADRI (Kadri PRISHTINA)²⁸
– nënkryetar
GJERGJ FISHTA²⁹ – nënkryetar
MILTO TUTULANI – sekretar
HAXHI JUSUF BANKA – kujdestar

Sesioni i dytë (2 janar 1922):

ESHREF FRASHËRI – kryetar
LEONIDHA KOJA³⁰ – nënkryetar
MILTO TUTULANI – sekretar
HAXHI JUSUF BANKA – kujdestar

Sesioni i dytë (30 dhjetor 1922):

ESHREF FRASHËRI – kryetar
HILË MOSI – nënkryetar
MILTO TUTULANI – sekretar
HAXHI JUSUF BANKA – kujdestar

Sesioni i tretë (3 mars 1923):

ESHREF FRASHËRI – kryetar
LEONIDHA KOJA – nënkryetar
MILTO TUTULANI – sekretar
MAZAR KËLLIÇI – kujdestar

Sesioni i katërt (15 shtator 1923):

ESHREF FRASHËRI – kryetar
LEONIDHA KOJA – nënkryetar
PATUK SARAÇI – sekretar
MAZAR KËLLIÇI – kujdestar

Komisionet e përhershme të Këshillit Kombëtar³¹:

1. Komisioni për Punët e Drejtësisë, Ankime dhe Parashtrësia Gjithfarësh
2. Komisioni për Punët e Arsimit, Botore dhe Bujqësi
3. Komisioni për Punët e Administratës dhe Ushtri
4. Komisioni për Punët e Financave dhe Postë-Telegrafave

²⁷. Më 16 korrik 1921 zëvendësohet nga Eshref Frashëri.

²⁸. Deri më 18 korrik 1921.

²⁹. Zgjidhet më 25 korrik 1921.

³⁰. Më 21 tetor 1922 zëvendësohet nga Hilë Mosi.

³¹. “Bisedime parlamentare”, 1921, f. 39–40.

Veprimtar i Rilindjes Kombëtare dhe mendimtar i saj, kryeministër dhe funksionar i lartë i shtetit gjatë periudhës së Pavarësisë. Si atdhetar i palëkundur dhe burrë shteti, si njeri me vizion të gjerë për të ardhmen e Shqipërisë, jetën dhe veprimtarinë e tij patriotike e lidhi ngushtë me fatet e atdheut dhe të popullit dhe iu përkushtua me mish e me shpirt çështjes së çlirimit kombëtar, mbrojtjes së atdheut nga rreziku i copëtimit, shpalljes së pavarësisë dhe konsolidimit të shtetit shqiptar. Për këtë njeri me cilësi e virtyte të larta kishin respekt dhe ia vlerësonin mençurinë dhe aftësinë figura të mëdha të kombit, si Naim e Sami Frashëri, Ismail Qemali, Fan Noli, Eqerem bej Vlora, Mithat Frashëri, Faik Konica, Luigj Gurakuqi, Themistokli Gërmenji etj. Lindi në vitin 1859 në Korçë, ku kreu dhe shkollën e mesme. Në vitin 1878, në moshën 19-vjeçare, emigroi në Rumani dhe shumë shpejt u përfshi në lëvizjen patriotike të emigracionit shqiptar në Bukuresht, u bë anëtar i shoqërisë "Dituria" dhe iu përkushtua me entuziazëm çështjes kombëtare. Në janar 1895 u zgjodh kryetar i shoqërisë "Dituria" dhe me themelimin e shoqërisë "Bashkimi" në dhjetor 1906 u zgjodh nënkryetar i saj. Më 1907 bashkë me atdhetarë të tjerë krijoi në Bukuresht komitetin "Për Lirinë e Shqipërisë". Me ardhjen në fuqi të turqve të rinj u krijua mundësia për hapjen e shkollave shqipe në të gjithë vendin dhe Evangjeli punoi pa pushim për të plotësuar kërkesat e shumta të tyre për libra. Në nëntor 1912 kolonia e shqiptarëve të Bukureshtit zgjodhi delegatët për në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe një prej të zgjedhurve ishte Pandeli Evangjeli, por për arsye shëndetësore ai nuk mundi të merrte pjesë. Përfaqësoi koloninë shqiptare të Bukureshtit në Kongresin e Triestes në mars 1913. Më 1914 u kthye në Shqipëri dhe po atë vit u emërua prefekt i Korçës. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore shkoi përsëri në Bukuresht, ku vijoi veprimtarinë e tij atdhetare. Më 1919 kryesoi përfaqësinë e kolonisë shqiptare të Rumanisë në Konferencën



PANDELI EVANGJELI
(1859–1949)

Kryetar
i Këshillit Kombëtar
(9 maj–16 korrik 1921)
Kryetar i Senatit
(1925–1928)
Kryeministër
(1921, 1930–1935)

e Paqes në Paris dhe më 1920 u caktua anëtar i delegacionit qeveritar shqiptar pranë asaj Konference. Nga mesi i prillit 1920 ai u kthye përfundimisht në Shqipëri, i mirëpritur nga populli i Korçës dhe nga rrethet patriotike shqiptare. Ndër 12 deputetët e prefekturës së Korçës në zgjedhjet e 5 prillit 1921 ishte edhe Pandeli Evangjeli. Në parlamentin që doli nga këto zgjedhje ai u zgjodh kryetar (9 maj–16 korrik 1921), duke u bërë kështu kryetari i parlamentit të parë pluralist shqiptar. Në vitin 1921 për një periudhë dymujore (6 tetor–6 dhjetor 1921) ishte kryeministër. Më 1924 u dekorua nga Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare për kontributin që dha për krijimin e saj. Pas dorëheqjes së Eshref Frashërit në shtator 1925 zëvendësoi këtë të fundit në detyrën e kryetarit të Senatit, detyrë që e mbajti deri në fund të legjislaturës (7 qershor 1928). Deputet i Korçës më 1928–1932, 1932–1936 dhe 1937–1939. Kryetar i Asamblesë Konstituente nga 25 gushti 1928 deri më 5 mars 1930. Më 1937 zëvendësoi Koço Kotën në detyrën e kryetarit të Parlamentit, detyrë që e mbajti deri në vitin 1939. Në vitet 1930–1935 ishte përsëri kryeministër (kryesoi tri qeveri: 6 mars 1930–11 prill 1931; 20 prill 1931–7 dhjetor 1932; 11 janar 1933–16 tetor 1935). Gjatë viteve të pushtimit italian dhe gjerman nuk u mor me veprimtari politike. Vdiq në Korçë 14 shtator 1949, në moshën 90-vjeçare. Është dekoruar me Urdhrin "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu".



Veprimtar politik. Lindi në Korçë më 15 tetor 1874. Përfundoi studimet e larta për inxhinieri ndërtimi në Stamboll. Prej vitit 1914 mori pjesë në komitetin patriotik shqiptar të atjeshëm. U bë anëtar i komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Ishte një nga organizatorët e Kongresit Kombëtar të Lushnjës (janar 1920), ku u zgjodh zëvendëskryeministër dhe drejtor i përgjithshëm i Punëve Publike. Në maj të vitit 1920 qeveria e Tiranës e dërgoi me mision në Korçë që të ndërhynte pranë ushtrisë franceze që ajo t’ia dorëzonte qytetin qeverisë shqiptare dhe jo ushtrisë greke, që ndodhej pranë kufirit. Ai organizoi një takim të madh në qytet, shpalli unifikimin e Republikës Autonome Shqiptare të Korçës me pjesën tjetër të Shqipërisë dhe filloi mbledhjen e vullnetarëve nga zonat përreth qytetit për të përgatitur një milici, në rast se grekët do të përpiqeshin të kapnin qytetin. Protokollin e Kapshticës, që pasoi, e la Korçën përfundimisht në anën shqiptare. Ishte një nga deputetët e prefekturës së Korçës në zgjedhjet e 5 prillit 1921. Më 16 korrik të atij viti zëvendësoi Pandeli Evangjelin në detyrën e kryetarit të Këshillit Kombëtar (Senatit). E ushtroi këtë detyrë deri në fund të legjislaturës (30 shtator 1923). Në zgjedhjet e 27 dhjetorit 1923 për Kuvendin Kushtetues u zgjodh përsëri deputet i prefekturës së Korçës dhe ishte një nga 101 deputetët e regjistruar më 21 janar 1924. U zgjodh kryetar i Kuvendit Kushtetues, që më pas u zëvendësua nga Petro Poga. Në Legjislaturën I të Republikës Shqiptare (1 qershor 1925–7



ESHREF FRASHËRI
(1874–1938)

Kryetar
i Këshillit Kombëtar
(1922–1923)
Kryetar i Senatit
(1925)

qershor 1928) ishte një nga 20 senatorët e zgjedhur dhe në shtator të atij viti u dekretuar kryetar i Senatit. U dyshua se kishte marrë pjesë në veprimtari të fshehta të bejlerëve të Jugut bashkë me Myfit Libohovën kundër Ahmet Zogut dhe më 24 shtator 1925 dha dorëheqjen. Përsëri deputet i Korçës në Asamblenë Konstituente (25 gusht 1928–1 dhjetor 1928), në Legjislaturën I të Mbretërisë Shqiptare (10.12.1928–11.05.1932), në Legjislaturën II të Mbretërisë (21 nëntor 1932–16 nëntor 1936), në Legjislaturën III të Mbretërisë (10 shkurt 1937–6 prill 1939), deputet i Durrësit dhe Tiranës në Asamblenë Kushtetuese (12 prill 1939–3 prill 1940). Në vitet 1921–1934 ishte anëtar i Partisë Popullore të Ahmet Zogut. Në gusht të vitit 1938 u zgjodh në kryesinë e Shoqërisë Industriale Tregtare Shqiptare (SITA). Në prill 1940 u zgjodh anëtar i Këshillit të Epërm Fashist Korporativ. Vdiq në moshën 64-vjeçare më 3 tetor 1938. U varros në varrezat bektashiane të kryeqytetit.

D Këshilli Kombëtar i dalë nga zgjedhjet e 5 prillit 1921:

(Lista pasqyron edhe ndryshimet e bëra gjatë legjislaturës.)

- | | | |
|-----------------------------------|------------------------|------------------------|
| 1. Abdyl SULA | 33. Iliaz VRIONI | 66. Qazim DANI |
| 2. Agathokli Xhitomi | 34. Irfan OHRI | 67. Qazim KOCULI |
| 3. Ahmet HASTOPALLI | 35. Kapllan DELIALLISI | 68. Qazim KOKOSHI |
| 4. Ahmet RESULI | 36. Koço TASI | 69. Qemal MULLAI |
| 5. Ahmet ZOGU | 37. Kolë RODHE | 70. Qemal VRIONI |
| 6. Ali KËLCYRA | 38. Kolë THAÇI | 71. Ramiz DACI |
| 7. Ali KOPRËNCKA | 39. Kristo DAKO | 72. Rasim BABAMETO |
| 8. Anton BEÇA | 40. Kristo FLOQI | 73. Refik TOPTANI |
| 9. At Gjergj FISHTA | 41. Kristo KIRKA | 74. Rexhep MATI |
| 10. Avni GJILANI | 42. Leonidha FRASHËRI | 75. Rexhep MITROVICA |
| 11. Bahri OMARI | 43. Leonidha KOJA | 76. Riza DANI |
| 12. Bajram FEVZI | 44. Loni KRISTO | 77. Salih VUÇITERNI |
| 13. Banush HAMDUI | 45. Luigj GURAKUQI | 78. Said TOPTANI |
| 14. Bedri PEJA | 46. Llambi GOXHOMANI | 79. Sejfi VLAMASI |
| 15. Behxhet HYTI | 47. Maliq BUSHATI | 80. Selahydin SHKOZA |
| 16. Bektash ÇAKRANI | 48. Mazar KËLLIÇI | 81. Skënder POJANI |
| 17. Dhimitër KACIMBRA | 49. Mehdi FRASHËRI | 82. Sotir PEÇI |
| 18. Eshref FRASHËRI | 50. Mehmet PENGILI | 83. Spiro Jorgo KOLEKA |
| 19. Fan NOLI | 51. Mehmet PILKU | 84. Spiro (Pilo) PAPA |
| 20. Fazlli FRASHËRI ³² | 52. Mithat FRASHËRI | 85. Stavro VINJAU |
| 21. Fiqri RUSI | 53. Milto TUTULANI | 86. Sulejman DELVINA |
| 22. Gani STRAZIMIRI | 54. Mustafa KRUIJA | 87. Syrja POJANI |
| 23. Halid RROJI | 55. Mustafa MAKSUTI | 88. Shefqet DAJIU |
| 24. Halim GOSTIVARI | 56. Ndoc PISTULLI | 89. Shefqet VËRLACI |
| 25. Hasan PRISHTINA | 57. Ndre MJEDA | 90. Shuk GURAKUQI |
| 26. Haxhi Jusuf BANKA | 58. Nikolla IVANAJ | 91. Shyqyri MUFTIU |
| 27. Hilë MOSI | 59. Osman HAXHI | 92. Taqi BUDA |
| 28. Hoxha KADRI (Kadri PRISHTINA) | 60. Osman MYDERRIZI | 93. Tefik MBORJA |
| 29. Hysein VRIONI | 61. Pandeli CALE | 94. Tefik PANARITI |
| 30. Hysen MUSHQETA | 62. Pandeli EVANGJELI | 95. Visarion XHUVANI |
| 31. Ibrahim JAKOVA | 63. Patuk SARAÇI | 96. Xhemal BUSHATI |
| 32. Ibrahim XHINDI | 64. Petro HARITO | 97. Zija TOPTANI |
| | 65. Qamil BALA | |

³². Betuar më 23 tetor 1923.



Deputetët sipas prefekturave

Prefektura e Beratit:

1. Ahmet RESULI
2. Ali KOPRËNCKA
3. Bektash CAKRANI
4. Hysein VRIONI
5. Llambi GOXHOMANI
6. Milto TUTULANI
7. Qemal MULLAI
8. Qemal VRIONI
9. Spiro (Pilo) PAPA

Prefektura e Dibrës:

1. Abdyl SULA³³
2. Avni GJILANI
3. Fazlli FRASHËRI³⁴
4. Fiqiri RUSI³⁵
5. Gani STRAZIMIRI
6. Hasan PRISHTINA
7. Hoxha KADRI (Kadri PRISHTINA)
8. Iliaz VRIONI
9. Irfan OHRI
10. Kristo FLOQI
11. Kristo DAKO
12. Ramiz DACI
13. Rexhep MATI³⁶
14. Salih VUÇITERNI³⁷
15. Selahyidin SHKOZA

Prefektura e Durrësit:

1. Haxhi Jusuf BANKA
2. Hysen MUSHQETA
3. Kapllan DELIALLISI
4. Leonidha KOJA
5. Mazar KËLLIÇI
6. Mehmet PENGILI
7. Osman MYDERRIZI³⁸
8. Refik TOPTANI
9. Rexhep Jella³⁹
10. Said TOPTANI⁴⁰
11. Shahsivar ALLTUNI⁴¹
12. Visarion XHUVANI⁴²

13. Xhaferr YPI⁴³

14. Zija TOPTANI

Prefektura e Elbasanit:

1. Ahmet HASTOPALLI
2. Anton BEÇA
3. Behxhet HYTI
4. Mehdi FRASHËRI
5. Shefqet DAJIU
6. Shefqet VËRLACI
7. Shyqyri MUFTIU
8. Taqi BUDA

Prefektura e Gjirokastrës:

1. Agathokli Xhitomi
2. Ali KËLCYRA
3. Bahri OMARI
4. Dhimitër KACIMBRA
5. Koço TASI
6. Leonidha FRASHËRI
7. Mithat FRASHËRI
8. Mustafa MAKSUTI
9. Petro HARITO
10. Rasim BABAMETO⁴⁴
11. Stavro VINJAU
12. Sulejman DELVINA

Prefektura e Korçës:

1. Banush HAMDUI
2. Eshref FRASHËRI
3. Kolë RODHE⁴⁵
4. Kristo KIRKA
5. Loni KRISTO
6. Pandeli EVANGJELI
7. Pandeli CALE⁴⁶
8. Sejfi VLAMASI
9. Skënder POJANI⁴⁷
10. Sotir PEÇI
11. Tefik MBORJA
12. Tefik PANARITI

Prefektura e Kosovës:

1. Bedri PEJA⁴⁸
2. Halim GOSTIVARI⁴⁹
3. Ibrahim JAKOVA⁵⁰
4. Mustafa KRUIJA
5. Qamil BALA⁵¹
6. Qazim DANI⁵²
7. Rexhep MITROVICA

Prefektura e Matit:

1. Ahmet ZOGU
2. Bajram FEVZI
3. Syrja POJANI

³³. Betuar më 12 shtator 1922.

³⁴. Betuar më 23 tetor 1922.

³⁵. Betuar më 12 shtator 1922.

³⁶. Betuar më 12 shtator 1922.

³⁷. Betuar më 5 shtator 1925.

³⁸. Më 18 shtator 1922.

³⁹. Betuar më 5 shtator 1922.

⁴⁰. Betuar më 5 shtator 1922.

⁴¹. Betuar 18 shtator 1922.

⁴². Betuar më 18 shtator 1922.

⁴³. Më 18 shtator 1922.

⁴⁴. Betuar më 4 shtator 1922.

⁴⁵. Betuar më 4 shtator 1922.

⁴⁶. Vdekur më 5 gusht 1923.

⁴⁷. Betuar më 12 shtator 1922.

⁴⁸. Shtuar më 22 dhjetor 1922.

⁴⁹. Shtuar më 22 dhjetor 1922.

⁵⁰. Shtuar më 22 dhjetor 1922.

⁵¹. Betuar më 12 shtator 1922.

⁵². Betuar më 18 nëntor 1922.

**Prefektura e Shkodrës:**

1. At Gjergj FISHTA
2. Halid RROJI
3. Hilë MOSI
4. Kolë THAÇI
5. Luigj GURAKUQI
6. Maliq BUSHATI
7. Ndoc PISTULLI
8. Ndre MJEDA
9. Nikolla IVANAJ⁵³
10. Patuk SARAÇI
11. Riza DANI
12. Shuk GURAKUQI
13. Xhemal BUSHATI

Prefektura e Vlorës:

1. Ibrahim XHINDI
2. Osman HAXHIU
3. Qazim KOKOSHI
4. Qazim KOCULI⁵⁴
5. Spiro Jorgo KOLEKA

Shoqëria "Vatra" e Amerikës:

1. Fan S. NOLI

Zëvendësime në përbërjen e Këshillit Kombtar

1. Mithat FRASHËRI

Prefektura e Gjirokastrës
Zëvendësuar nga Rasim Babameto më 4 shtator 1922.

2. Mustafa KRUIJA

Prefektura e Kosovës
Zëvendësuar nga Qamil Bala më 12 shtator 1922.

3. Pandeli CALE

Prefektura e Korçës
Zëvendësuar nga Kristo Kirka.

4. Ramiz DACI

Prefektura e Dibrës
Zëvendësuar⁵⁵ më 1922.

5. Kristo DAKO

Prefektura e Durrësit
Zëvendësuar më 1922.

6. Kristo FLOQI

Prefektura e Dibrës
Zëvendësuar më 1922.

7. Fazlli FRASHËRI

Prefektura e Dibrës,
zëvendësues.

8. Avni GJILANI

Prefektura e Dibrës
Zëvendësuar më 1922

9. Halim GOSTIVARI

Prefektura e Kosovës
Shtuar më 22.12.1922

10. Ibrahim JAKOVA

Prefektura e Kosovës
Shtuar më 22.12.1922

11. Hoxha KADRI (Kadri PRISHTINA)

Prefektura e Dibrës
Zëvendësuar më 1922.

12. Leonidha KOJA

Prefektura e Durrësit
Zëvendësuar nga Visarion Xhuvani më 18 shtator 1922.

13. Qazim KOKOSHI

Prefektura e Vlorës
Zëvendësuar nga Qazim Koculi më 2 tetor 1922.

14. Rexhep MATI

Prefektura e Dibrës,
zëvendësues

15. Hysen MUSHQETA

Prefektura e Durrësit
Zëvendësuar nga Osman Myderrizi më 18 shtator 1922.

16. Irfan OHRI

Prefektura e Dibrës
Zëvendësuar më 1922

17. Sotir PEÇI

Prefektura e Korçës
Zëvendësuar nga Kolë Rodhe më 4 shtator 1922.

18. Bedri PEJA

Prefektura e Kosovës
Shtuar më 22.12.1922

19. Mehmet PILKU

Prefektura e Dibrës,
zëvendësues

⁵³. Betuar më 29 mars 1922.

⁵⁴. Betuar më 2 tetor 1922.

⁵⁵. Këtu "zëvendësuar" do të thotë se më 22.12.1922, pasi u lirua Dibra, u rrëzuan dhe në vend të tyre u zgjodhën të tjerë, që gjenden me "zëvendësues" ("Shqipënija më 1937", vëll. I, f. 51.



20. Tefik MBORJA
Prefektura e e Korçës
Zëvendësuar nga Skënder
Pojani më 12 shtator 1922.

21. Hasan PRISHTINA
Prefektura e e Dibrës
Zëvendësuar më 1922

22. Fiqri RUSI
Prefektura e e Dibrës,
zëvendësues

23. Selahyidin SHKOZA
Prefektura e e Dibrës
Zëvendësuar më 1922

24. Gani STRAZIMIRI
Prefektura e e Dibrës
Zëvendësuar më 1922

25. ABDYL SULA
Prefektura e e Dibrës,
zëvendësues

26. Refik TOPTANI
Prefektura e e Durrësit
Zëvendësuar nga Said Toptani
më 5 shtator 1923.

27. ILIAZ VRIONI
Prefektura e e Dibrës
Zëvendësuar më 1922

28. Salih VUÇITERNI
Prefektura e e Dibrës,
zëvendësues

6. Said TOPTANI
Prefektura e e Dibrës,
zëvendësues

13

Ora _____

N. Renduër _____

Nënsb. i Nëpunsit _____

TELEGRAM

Ora _____

Prej _____

Nënsb. i nëpunsit *Jan*

23/4 ' 6

Shtati s' pranon asnjë përgjegjësi të shkakut nga shërbimi telegrafik

Nga *Ator* Per _____

Num.	Fjalë	Grup	Data e dorëzimit	Ruga	Shënime të qëllueshme	Shënime shtatore
51	36		21 1/4/2		21	<i>Jo</i>

Kryetarit parlamentit

Evriane

Kam ndërrim të udhës celjen

historike të parlamentit staps

shërbimi telegrafik të shtetit

VITI 1924

KUVENDI KUSHTETUES

(Një dhomë)

Periudha e parë: 21 janar–2 qershor 1924

Periudha e dytë: 17 janar–2 mars 1925

Zgjedhjet u mbajtën më 27 dhjetor 1923.

Kuvendi Kushtetues përbëhej nga 101 deputetë dhe e ushtroi veprimtarinë e tij në dy periudha: 21 janar–2 qershor 1924 dhe 17 janar–2 mars 1925. Detyra kryesore e tij ishte hartimi dhe miratimi i një kushtetute të shtetit shqiptar, ku të sanksionohej forma e qeverisjes. Objektivi nuk u arrit në periudhën e parë të veprimtarisë së tij për shkak të acarimit të situatës politike në vend pas vrasjes së Avni Rustemit dhe atentatit që iu bë kryeministrit të asaj kohe Ahmet Zogu. Më 2 qershor të vitit 1924 Kuvendi mbylli punimet e periudhës së parë. Pas shpërbërjes


së qeverisë Ahmet Zogu u largua nga Shqipëria dhe qëndroi në ilegalitet deri në dhjetor të atij viti. Gjatë kësaj periudhe erdhi në pushtet qeveria e Fan Nolit, e cila pati një jetë të shkurtër (16 qershor–24 dhjetor 1924). Me kthimin e Ahmet Zogut në pushtet, që shënoi në histori të ashtuquajturin “triumf të legalitetit”, rifilloi punimet Kuvendi Kushtetues (17 janar 1925). Ai arriti të përmbushte detyrën për të cilën ishte krijuar: miratimin e Statutit Themeltar të Shtetit dhe përcaktimin e formës së tij.

Kryesia e Kuvendit Kushtetues:

ESHREF FRASHËRI⁵⁶ – kryetar
KOSTAQ PAFTALI – nënkryetar
NUSH BUSHATI – sekretar
JASHAR EREBARA – kujdestar

Komisionet e përhershme të Kuvendit Kushtetues⁵⁷:

1. Komisioni i Statutit
2. Komisioni i Buxhetit
3. Komisioni i Administratës (civile dhe shëndetësi)



⁵⁶. Më 17 prill 1924 zëvendësohet nga Petro Poga.


⁵⁷. Kastriot Dervishi, “Historia e shtetit shqiptar (1922 – 1925)





ESHREF FRASHËRI
(1874–1938)

Kryetar
i Kuvendit Kushtetues
(21 janar–17 prill 1924)



PETRO POGA
(1850–1944)

Kryetar
i Kuvendit Kushtetues
(17 prill–2 qershor 1924
dhe 17 janar–2 mars 1925)



Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, deputet, ministër. Lindi në Erind të Lunxhërisë (Gjirokastrër) në vitin 1850. Pasi përfundoi gjimnazin “Zosimea” të Janinës, studioi për drejtësi në Universitetin e Stambollit, ku u njoh dhe bashkëpunoi me Abdyl e Naim Frashërin, Ismail Qemalin, Hoxha Tahsinin, Shahin Kolonjën e Pandeli Sotirin. Fillimisht punoi në Stamboll dhe në vitin 1883 ishte një nga themeluesit e gazetës “Drita”. Bashkëpunoi me shoqëritë patriotike shqiptare të Egjiptit, Bukureshtit, Sofjes e SHBA-ve për propagandimin e ideve kombëtare. Në vitin 1906 u kthye në Gjirokastrër dhe ndihmoi për themelimin e klubit patriotik “Drita” (1908). Përfaqësoi Gjirokastrën në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912. Në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës u zgjodh ministër i Drejtësisë dhe më 1913–1914 ishte kryetar i Gjykatës së Lartë. Në dhjetor 1913 themeloi në Vlorë shoqërinë e avokatëve “Drita”. Së bashku me Dhimitraq Tutulanin, Fehmi Mezhgoranin e avokatë të tjerë të zotë dhanë ndihmesën e tyre për hartimin e akteve juridike të shtetit shqiptar. Dokumente të rëndësishme janë “Kanuni i dëmeve” dhe “Kanuni i Zhurisë”, që u paraqitën në emër të Qeverisë së Përkohshme me firmën e Petro Pogës. Në dhjetor 1918 përfaqësoi Gjirokastrën në Kongresin e Durrësit dhe u zgjodh ministër i Drejtësisë (1918–1920) në qeverinë e dalë nga Kongresi. Deputet



i prefekturës së Gjirokastrës në Kuvendin Kushtetues të periudhës 21 janar 1924–2 qershor 1924 dhe kryetar i këtij Kuvendi më (17 prill–2 qershor 1924 dhe 17 janar–2 mars 1925) në vend të Eshref Frashërit. Deputet i Gjirokastrës në të gjitha legjislaturat nga viti

1925 deri më 1939, ministër i Drejtësisë në periudhën 1 shkurt–23 shtator 1925 dhe 12 shkurt–20 tetor 1927. Më 1939, pas pushtimit të vendit nga Italia fashiste, u tërhoq nga jeta politike dhe u kthye në vendlindje. Vdiq në shtator të vitit 1944.

Kuvendi Kushtetues i dalë nga zgjedhjet e 27 dhjetorit 1923:

(Lista pasqyron edhe ndryshimet e bëra gjatë legjislaturës.)

- | | | |
|----------------------------------|----------------------|--------------------------|
| 1. Abdurahman DIBRA | 35. Ibrahim XHINDI | 70. Qemal VRIONI |
| 2. Abdyl KUÇI | 36. Ilija MUZINA | 71. Qemal KARAOSMANI |
| 3. Ahmet HASTOPALLI | 37. Iliaz VRIONI | 72. Rasim BABAMETO |
| 4. Ahmet RESULI | 38. Iliaz MUKA | 73. Rauf FICO |
| 5. Ahmet ZOGU | 39. Ismail TATZATI | 74. Rexhep JELLA |
| 6. Ali BEGEJA | 40. Isuf GJINALI | 75. Rexhep MATI |
| 7. Ali KËLCYRA | 41. Izet DIBRA | 76. Salih BABANI |
| 8. Ambroz MARLASKAJ | 42. Jani PAPANOPULLI | 77. Salih VUÇITERNI |
| 9. Anton BEÇA | 43. Jashar EREBARA | 78. Sami KOPRËNCKA |
| 10. Aqif ELBASANI | 44. Josif KEDHI | 79. Sami VRIONI |
| 11. Avni RUSTEMI | 45. Kolë TROMARA | 80. Said TOPTANI |
| 12. Bahri OMARI | 46. Kostaq KOTA | 81. Seit VRIONI |
| 13. Behxhet HYTI | 47. Kostaq PAFTALI | 82. Sejfi VLLAMASI |
| 14. Bektash ÇORUSHI
(CAKRANI) | 48. Kristaq KOSTURI | 83. Selahydin BLOSHMI |
| 15. Dervish MITROVICA | 49. Lon LLOGORI | 84. Selim LUNIKU |
| 16. Dimosten HAXHOLLI | 50. Dr. Loni GJINI | 85. Skënder POJANI |
| 17. Eqrem VLORA | 51. Luigj GURAKUQI | 86. Spiro Jorgo KOLEKA |
| 18. Eshref FRASHËRI | 52. Luigj KOLIQI | 87. Spiro (Pilo) PAPA |
| 19. Fahri RASHIT | 53. Llambi GOXHOMANI | 88. Sulejman DELVINA |
| 20. Faik KONICA | 54. Mehmet PENGILI | 89. Sulejman LUZATI |
| 21. Fan NOLI | 55. Mihal KASO | 90. Sulejman STAROVA |
| 22. Fazlli FRASHËRI | 56. Milto TUTULANI | 91. Syrja POJANI |
| 23. Ferid VOKOPOLA | 57. Mustafa TRAJAZI | 92. Shahsivar ALLTUNI |
| 24. Fiqri RUSI | 58. Ndre MJEDA | 93. Shefqet DAJIU |
| 25. Hafiz Ibrahim REPISHTI | 59. Niko LEZO | 94. Shefqet FISHTA |
| 26. Hafiz Ismet SHEHI | 60. Nikollaq ZOI | 95. Shefqet VËRLACI |
| 27. Hafiz Xhemal HOXHA | 61. Numan FERIZI | 96. Shuk GURAKUQI |
| 28. Dr. Haki MBORJA | 62. Nush BUSHATI | 97. Taqi BUDA |
| 29. Halid RROJI | 63. Osman MYDERRIZI | 98. Telemak LABOVITIADHI |
| 30. Hamid MYFTIU | 64. Petro HARITO | 99. Terenc TOÇI |
| 31. Hasan BIÇAKÇIU | 65. Petro POGA | 100. Vangjel GOXHOMANI |
| 32. Hilë MOSI | 66. Pjetër BUMÇI | 101. Xhelal ZOGU |
| 33. Hoxha KADRI | 67. Qani DISHNICA | 102. Xhemal BUSHATI |
| 34. Ibrahim GJYZEZI | 68. Qazim DURMISHI | 103. Zija TOPTANI |
| | 69. Qazim KOCULI | |

Deputetët sipas prefekturave

Prefektura e Beratit:

1. Ahmet RESULI
2. Bektash ÇORUSHI (CAKRANI)
3. Ferid VOKOPOLA
4. Hamid MYFTIU
5. Iliaz VRIONI
6. Loni GJINI
7. Llambi GOXHOMANI
8. Milto TUTULANI
9. Qemal VRIONI
10. Qemal KARAOSMANI
11. Sami KOPRËNCKA
12. Sami VRIONI
13. Seit VRIONI
14. Spiro (Pilo) PAPA
15. Vangjel GOXHOMANI

Prefektura e Dibrës:

1. Abdurahman DIBRA
2. Ahmet ZOGU⁵⁸
3. Fiqri RUSI
4. Hafiz Ismet SHEHI
5. Hafiz Xhemal HOXHA
6. Izet DIBRA
7. Jashar EREBARA
8. Rexhep MATI
9. Salih VUÇITERNI
10. Syrja POJANI
11. Shefqet FISHTA
12. Terenc TOÇI
13. Xhelal ZOGU⁵⁹

Prefektura e Durrësit:

1. Ahmet ZOGU
2. Ali BEGEJA
3. Isuf GJINALI
4. Kostaq PAFTALI
5. Mehmet PENGILI
6. Osman MYDERRIZI
7. Rauf FICO
8. Rexhep JELLA
9. Said TOPTANI
10. Shahsivar ALLTUNI
11. Zija TOPTANI

Prefektura e Elbasanit:

1. Ahmet HASTOPALLI
2. Anton BEÇA
3. Behxhet HYTI
4. Hasan BIÇAKÇIU
5. Qazim DURMISHI
6. Selahyidin BLOSHMI
7. Selim LUNIKU
8. Shefqet DAJIU
9. Shefqet VËRLACI
10. Taqi BUDA

